

# HEJZA

**Anissa Markarian, aktore dhe shkrimtare**

***ARTI SI TERAPI***

Nën thjerrë

# PROFESIONALIZMI I KULTURUAR DHE RRJETI KLIENTELIST



**Në Raportin e Komisionit Evropian për Politikën Kulturore theksohet domosdoshmëria e ekzistimit të “institucioneve që nuk varen nga ciklet e pushtetit politik, por që ndërtojnë politika afatgjata nëpërmjet bashkëpunimit të profesionistëve të fushës, publikut dhe sektorit kreativ.”**

**Avni HALIMI**

Në kushte të një normaliteti demokratik, institucioni kulturor nuk është thjesht një hapësirë burokratike për ndarjen e fondeve apo programimin e kalendarëve artistikë. Ai është një enë simbolike, ku një shoqëri përpunon kujtesën, përfytyron të ardhmen dhe vendos vlerat që dëshiron të përçojë brez pas brezi. Brenda kësaj ene, figura e profesionistit të kulturës si, krijues, kurator, studiues, pedagog, kritik apo menaxher, është themelore: ai është përgjegjës për atë që përzgjedh të ruajë, çfarë inkurajon të lindë dhe çfarë refuzon të lejojë të banalizohet. Por, çfarë ndodh kur kjo hapësirë simbolike shndërrohet në një teatër klientelist, ku emërimi nuk ndodh mbi bazën e përgatitjes, as të ndjeshmërisë kulturore, por mbi besnikërinë partiake dhe funksionin elektoral të figurës së emëruar? Atëherë kemi jo thjesht deformim të sistemit administrativ, por shpërbërje të profesionalizmit si koncept. E gjithë struktura që ndërtohet mbi pretendimin e profesionalizmit, nga CV-të zyrtare deri te fjalimet në konferenca, nuk është gjë tjetër veçse një maskë për të legjitimuar një farsë. Edhe kur ndonjë emër me reputacion kombëtar vendoset në krye të një institucioni, roli i tij ngushtohet në një figurë dekorative, nëse ai është i rrethuar nga një administratë e mbushur me militantë, sharlatanë dhe analfabetë funksionalë. Këta nuk e kuptojnë natyrën e punës kulturore dhe as qëllimin e saj emancipues; për ta, kultura është një kalendar aktiviteteesh, një tabelë me statistika, një mjet për të krijuar borxhe klienteliste dhe për të riprodhuar një formë pushteti që e përdor simbolin si fasadë, jo si akt.

**Profesionalizmi nuk është vetëm një kod teknik**

Në këtë klimë, profesionisti i vërtetë, ai që mban brenda vetes etikën e formës dhe përkushtimin për përmbajtjen,

gjendet i izoluar. Në rastin më të mirë, ai tolerohet si “ekspert” për të mbushur boshllëqe kredibiliteti, në rastin më të keq, sabotohet, margjinalizohet, ose më shpesh: largohet vetë, për të mos u kthyer më. Ky degradim nuk është vetëm shqetësim lokal. Në dokumentet dhe standardet e Bashkimit Evropian, profesionalizmi kulturor kuptohet si një ndërlidhje e fuqishme ndërmjet kompetencës, etikës, transparencës dhe autonomisë institucionale. Për shembull, në Raportin e Komisionit Evropian për Politikën Kulturore (European Agenda for Culture) theksohet domosdoshmëria e “institucioneve që nuk varen nga ciklet e pushtetit politik, por që ndërtojnë politika afatgjata nëpërmjet bashkëpunimit të profesionistëve të fushës, publikut dhe sektorit kreativ.” Kjo nënkupton jo vetëm shmangien e ndërhyrjes politike në përzgjedhjen e drejtuesve, por krijimin e mekanizmave për vlerësim të pavarur, meritë dhe integritet profesional. Në disa vende evropiane, për shembull në Gjermani, Francë, ose Suedi, institucionet kulturore udhëhiqen nga bordet përfaqësuese të profesionistëve, dhe drejtuesit kalojnë përmes procesesh përzgjedhjeje ku kërkohen vizione konkrete dhe llogaridhënie. Roli i partive është i kufizuar për të garantuar pluralizmin dhe barazinë e aksesit, jo për të emëruar ushtarë ideologjikë apo për të krijuar stacione punësimi për militantë. Krahastuar me këtë, në shumë vende ku pushteti sheh kulturën si mjet për propagandë ose dekor protokollar, siç ishte kjo në pushtetin njëdekadësh të kryeministrit maqedonas në ekzil, Nikolla Gruevskit, profesionalizmi kthehet në një koncept i vdekur në letra. Më e rrezikshmja është kur kultura perceptohet si një fushë pa pasoja, një “zonë gri” ku mund të ndodhin çdo lloj shkeljeje, sepse mungon presioni publik për standard. Kultura kështu trajtohet si një aneks zbavitës i politikës, jo si thelb formues i qytetarisë dhe ndërgjegjes kritike. Profesionalizmi kulturor nuk mund të ekzistojë në një ambient ku kompetenca

nuk shpërblehet, ku integriteti etik penalizohet dhe ku mendimi kritik shihet si armik. Nëse ai nuk mbështetet nga struktura të qëndrueshme dhe njerëz me autoritet moral real, ai nuk arrin të funksionojë as në nivel mikroskopik. Në këtë klimë, e vetmja mënyrë për ta ringjallur kuptimin e profesionalizmit është përmes vetërefuzimit të farsës: përmes krijimit të rrjeteve të pavarura, platformave që sfidojnë standardin e rremë, dhe ngritjes së vetëdijes publike për atë se çfarë do të thotë në të vërtetë të punosh në shërbim të kulturës, jo të pushtetit. Sepse profesionalizmi nuk është vetëm një kod teknik, ai është një akt shpirtëror, një marrëdhënie me kuptimin, një mënyrë për t’i dhënë botës një formë që i reziston banalitetit. Dhe aty ku ky akt kthehet në shaka, atëherë kemi humbur jo vetëm një profesion, por një dimension të vetë humanitetit.

**Rrugëdalje nga klientelizmi dhe joprofesionalizmi**

Në botën e sotme të institucioneve kulturore, ku shpeshherë drejtimet dhe vendimmarrjet varen më shumë nga lidhjet partiake sesa nga kompetenca reale, profesionalizmi ka humbur shumë nga përmbajtja dhe kuptimi i vet. Kjo është një nga arsyt kryesore që çon në krizën e institucioneve kulturore dhe në shpërbërjen e vlerave që ato kanë për të mbrojtur dhe zhvilluar. Kur kultura shndërrohet në një skenë ku klientelizmi dhe militantizmi partiak janë norma, dhe jo përjashtimi, ajo humbet jo vetëm funksionin e vet, por edhe dinjitetin si fushë e lirë dhe e pavarur e shprehjes dhe mendimit. Në një ambient ku klientelizmi mbizotëron, ku postet ndahen si shpërblim për besnikëri politike dhe ku administratat mbushen me njerëz pa përgatitje dhe pa përkushtim, etika profesionale nuk është vetëm një kërkesë morale, por një domosdoshmëri e papërfillshme. Etika profesionale është ajo që i jep kuptim dhe integritet veprës, që mbron institucionin nga shpërbërja dhe banalizimi, dhe që

garanton se kultura nuk do të jetë kurrë thjesht një vegël politike, por një hapësirë ku zhvillohet mendimi kritik, dialogu dhe krijimi. Etika në profesionin e kulturës kërkon që të veprohet me përgjegjësi ndaj publikut dhe trashëgimisë, me përkushtim ndaj së vërtetës dhe bukurisë, si dhe me guxim për të thënë “jo” kur ato që kërkohen bien ndesh me vlerat themelore. Ky guxim shpesh mungon në sistemet ku interesi personal dhe ai politik janë mbi interesin publik. E vetmja rrugë për të ruajtur dinjitetin e profesionit është një etikë që është edhe rezistencë, një formë e vazhdueshme e përballjes me shkeljet dhe kompromiset që kërkohen. Mendimtarë si Emanuel Levinasi na kujtojnë se përgjegjësia ndaj tjetrit është themeli i çdo marrëdhënieje njerëzore dhe çdo veprimi profesional. Në këtë kuptim, profesionalizmi kulturor nuk është thjesht një nivel teknik apo akademik, por një marrëdhënie etike, ku secili profesionist duhet të jetë i përgjegjshëm për ndikimin e punës së tij mbi shoqërinë dhe brezat që vijnë. Kjo përgjegjësi është një detyrë e vazhdueshme, që kërkon reflektim dhe vetëdije të thellë mbi rolin që kultura luan në formësimin e mendimit dhe identitetit kolektiv. Në nivel institucional, kjo do të thotë që institucionet duhet të ndërtojnë kulturë përgjegjshmërie, ku vendimet merren në bazë të meritës dhe transparencës, dhe ku korrupsioni, nepotizmi apo klientelizmi nuk gjejnë hapësirë. Vetëm kështu mund të krijohet një klimë ku profesionalizmi kulturor bëhet një normë, jo një përjashtim.

**Profesionalizmi si akt shpirtëror e moral**

Një shembull frymëzues për vendet e tjera është mënyra se si disa shtete evropiane kanë inkorporuar mekanizma të qartë dhe të fortë etikë në funksionimin e institucioneve të tyre kulturore. Në vendet si Gjermania, Holanda apo Danimarka, menaxhimi i institucioneve kulturore bëhet nëpërmjet procesesh transparente të përzgjedhjes, ku kandidaturat për poste

drejtuese kalojnë përmes komisioneve të përbëra nga ekspertë të fushës dhe përfaqësues të pavarur të shoqërisë civile. Kjo përzgjedhje meritokratike synon të shmangë ndikimet politike dhe klienteliste që përshkruhen shpesh në kontekstet ku profesionalizmi është i brishtë. Për më tepër, këto institucione janë të detyruara të zbatojnë standarde të larta llogaridhënieje, duke raportuar jo vetëm për përdorimin e burimeve financiare, por edhe për ndikimin kulturor dhe shoqëror të veprimtarisë së tyre. Kjo i bën ata më të përgjegjshëm ndaj komunitetit dhe publikut, duke krijuar një klimë besimi dhe respekti të ndërsjellë. Një tjetër element është investimi në programet e mentorimit dhe trajnimit

të vazhdueshëm, që synojnë të mbajnë standardet profesionale dhe etike në nivel të lartë. Përmes këtyre programeve, brezat e rinj të profesionistëve kulturore nuk marrin vetëm njohuri teknike, por edhe një edukim të thellë etik dhe filozofik, që i ndihmon të rezistojnë ndaj presioneve të klientelizmit apo ndikimeve të tjera joprofesionale. Përtej kësaj, etika profesionale kërkon edhe një përkushtim të vazhdueshëm ndaj vetë-arsimimit dhe rritjes personale, ndaj reflektimit kritik mbi rolin dhe ndikimin e vet. Profesionistët e kulturës duhet të jenë gjithmonë në një proces vetë-përmirësimi, të hapur ndaj kritikës dhe gatshëm për të sfiduar edhe sistemin ku punojnë, kur ai bie në kundërshtim me parimet

etike. Kjo do të thotë që profesionisti nuk mund të jetë vetëm një administrator apo menaxher, por një intelektual kritik, i cili nëpërmjet punës së vet ndikon në ngritjen e nivelit kulturor dhe moral të shoqërisë. Një tjetër aspekt thelbësor është roli i komunitetit profesional dhe i rrjeteve të bashkëpunimit që mundësojnë mbështetje morale dhe praktike për profesionistët e ndershëm. Në kontekstin ku klientelizmi është normë, rrjetet e tilla mund të shërbejnë si një “bunker” i etikës, një hapësirë ku mund të ruhet integriteti dhe të përçohet kultura e përgjegjshmërisë. Në fund, etika profesionale është një rrugëdalje e vetme reale nga klientelizmi dhe joprofesionalizmi. Pa të, kultura

ngurtësohet në një spektakël pa jetë, dhe institucionet humbasin rolin e tyre themelor si vende përkujtimi, reflektimi dhe zhvillimi shpirtëror. Vetëm përmes përkushtimit etik mund të rikthehet dinjiteti i profesionit kulturor dhe të hapet një horizont ku kultura nuk është një mjet politik, por një forcë për emancipim dhe humanizëm. Në këtë sens, profesionalizmi kulturor është më shumë se një status formal apo një set aftësish teknike; ai është një akt shpirtëror dhe moral, një përkushtim i thellë ndaj së bukurës dhe së vërtetës, ndaj komunitetit dhe brezave që do të vijnë. Dhe ky përkushtim kërkon kurajo, durim dhe një dashuri të palëkundur për kulturën si një dimension thelbësor i qenies njerëzore.

# Një udhëtim personal mes filozofisë dhe psikologjisë

# LIRIA E VULLNETIT NË EPOKËN E NEUROSHKENCËS

**Nëse i referohem Sartrit në idenë se ne jemi “të dënuar të jemi të lirë”, atëherë e vendos veten përballë përgjegjësisë reale. Edhe kur më duket sikur nuk kam zgjidhje, duhet të kujtoj se zgjedhja është gjithmonë aty**



### Ervina TOPTANI

Ka momente të vogla gjatë ditës që më bëjnë të ndalem e të mendoj ndonjë herë më thellë nga ç’duket normale. Sot në mëngjes, për shembull, po mendoja: “Të pi kafe apo çaj?” Dhe ndërkohë që zgjedhja dukej pa rëndësi, një mendim edhe më i thellë nisi t’ më intrigojë: A jam vërtet unë që e vendos këtë? Apo truri im e ka bërë zgjedhjen përpara se unë ta mendoj? Kjo pyetje më ka shoqëruar prej vitesh në fakt. E kam ndjerë shpesh që jeta është një seri zgjedhjesh, disa të vogla, të pavëna re e disa që të ndryshojnë dhe qasjen tënde ndaj jetës për sa të forta, të thella e të rëndësishme janë. Por, gjithmonë kam pasur po këtë ndjesi të çuditshme: A jam unë që zgjedh apo jam produkt i diçkaje më të thellë, më të fshehur? Në të endurin tim labirinteve të nënvetëdijes për të dhënë përgjigje, nuk mund të mos ndalesha herë pas here tek

filozofët që më kanë ndriçuar mendjen e më kanë ndihmuar të rritem në kuptimin me të thellë të fjalës: Platoni, Aristoteli, Spinoza, Sartre... Por, siç ndodh shpesh me të vërtetat e mëdha, edhe në këtë pikë nuk gjen dot një përgjigje të vetme e as një përgjigje të saktë. Aristoteli thoshte që njeriu është i lirë kur vepron në përputhje me arsyen. Dhe unë personalisht këtë e ndjej sa herë marr një vendim që është në përputhje me ndershmërinë e arsyes sime, më duket sikur jam më pranë vetvetes. Por, kur i referohem Spinozës, i cili thotë se çdo veprim i ynë është i shkaktuar nga diçka që ka ndodhur më parë, fillojnë e ngatërrohen disi mendimet, sepse edhe kjo mbart një vërtetësi mjaft të madhe brenda vetes. Jemi kaq të ngarkuar me të shkuarën tonë, me përvojat, me dhimbjet e pashprehura, sa s’mund të jemi plotësisht “të lirë”, madje askush nga ne nuk është i lirë siç mund të mendojë.

Nëse i referohem Sartrit në idenë se ne jemi “të dënuar të jemi të lirë”, atëherë

e vendos veten përballë përgjegjësisë reale. Edhe kur më duket sikur nuk kam zgjidhje, duhet të kujtoj se zgjedhja është gjithmonë aty. Kjo është një barrë e rëndë, por njëkohësisht një kënaqësi e madhe për njeriun që jam. Por, sa më thellë hyj në këtë temë, aq më shumë më ngacmon një pyetje tjetër: Çfarë thotë psikologjia në lidhje me këtë? A jemi ne vërtet të ndërgjegjshëm për zgjedhjet tona?

Freud, që më ka shoqëruar që nga vitet e para të studimeve e deri tani që kaloj pothuajse çdo ditë përpara shtëpisë së tij, më mësoi se shumë nga veprimet tona burojnë nga pavetëdija, nga dëshira, frika, nga plagët e brendshme që nuk jemi gjithnjë në gjendje as t’i njohim e as t’i adresojmë drejt. Të gjithëve na ndodh në jetë në momente të veçanta që veprojmë e më pas pyesim veten:“Pse e bëra këtë?” përgjigjja nuk është gjithmonë e qartë, ndiejmë se ka diçka më thellë që vepron për ne. Nga ana tjetër, Skinner më kujton se mjedisi na formëson. Njerëzit përreth

nesh, kultura, mënyra si na janë dhënë shpërblimet apo ndëshkimet që kur ishim fëmijë. A nuk është edhe kjo një mënyrë për të thënë se jemi të programuar në njëfarë mënyre?

Kur lexova për herë të parë për eksperimentin e Libet, ndjeva njëfarë tronditjeje (Eksperimenti i Libet është një eksperiment i famshëm i kryer nga neuroshkencëtari Benjamin Libet në vitet 1980, që kishte për qëllim të kuptonte kur dhe si lind vendimi i vetëdijshëm për të vepruar. Ai zbuloi se truri fillon përgatitjen për lëvizjen rreth 0.3 sekonda PARA se personi të marrë vetëdijshëm vendimin për të vepruar. Ky eksperiment ka ngritur debate të mëdha rreth vullnetit të lirë sepse sugjeron që truri jonë merr vendime para se ne të jemi të vetëdijshëm për to). Si është e mundur që truri aktivizohet për të bërë një veprim para se ne të jemi të vetëdijshëm për vendimin? Nëse kjo është e vërtetë dhe shkenca duket se po e konfirmon dita ditës, çfarë kuptimi ka fjalia “unë vendosa”? A nuk është ky një iluzion?

Por pastaj kur mendoj për zgjedhjet e mëdha që kam bërë në jetë: një lidhje të mrekullueshme dashurie që zgjodha ta konsolidoj në martesë, një rrugë që kam zgjedhur të ndjek, studimet të cilat kam bërë gjatë jetës, një fjalë që kam vendosur të mos e them... Këto nuk janë si të zgjedhësh „kafe apo çaj“. Ato janë të rëndësishme dhe kanë peshë, kanë histori, kanë dhimbje e shpesh kërkojnë guxim, madje edhe guxim të çmendur ndonjëherë. Dhe pikërisht kur mendoj për vendimet e mia, zgjedhjet e mia, këmbënguljen time në disa aspekte të veçanta, unë ndjej se jam e lirë. Jo në mënyrë absolute, por në kuptimin që kam reflektuar, kam marrë vendime dhe kam vepruar me përgjegjësi.

Më pëlqen shumë qasja e filozofit Daniel Dennett. Ai thotë se nuk ka rëndësi nëse truri e nis procesin disa çaste para se ne ta ndiejmë e të ndërgjegjësohemi për këtë. Ajo që ka rëndësi është që kemi kapacitet për të menduar, për të nxjerrë mësim, për të reflektuar dhe për të vepruar ndryshe herën tjetër. Dhe kjo është ajo lloj lirie që mua më mjafton. Sepse në fund, nuk besoj se liria është thjesht një “po” ose “jo”. Mendoj se ajo është një hapësirë që na jepet brenda kufijve tanë, kufij të brendshëm e të jashtëm ku ne mund të ndërgjegjësohemi, të ndalemi, të pyesim veten dhe ndoshta, ndonjëherë, të zgjedhim me vërtetësi edhe duke e ditur se diku - diku po gabojmë, por ka raste kur njeriu duhet të bëjë gabimet e tij pikërisht për të nxjerrë mësim, prej tyre. Për mua, të jetosh me vetëdije është forma më autentike e lirisë. Dhe çdo ditë përpiqem t’i afrohem asaj pak më shumë se dje.

Letër nga diaspora

# KULTURA NËN HIJEN E KRONIKAVE TË ZEZA

**Sot në të gjitha mediat kronikat kriminale mbulojnë hapësirën më të madhe dhe më të rëndësishme të tyre, ndërsa kultura më nuk është as në marginave e ngjarjeve që kanë një dinamikë pothuaj agresive**

**Neviana SHEHI/ Itali**

Shoqëria shqiptare gjithandej po përballet me shumë mungesa, të cilat fatkeqësisht marrin haraçin, duke krijuar një mozaik aspak t favorshëm. Dominimi i kronikave të zeza në media, përkatësisht lajmet e shumta për krime, tragjedi e konflikte, gjithnjë e më shumë zënë vendin e parë, duke lënë sidomos kulturën në hije. Mungesa e hapësirës për kulturën, gjegjësisht për artin, letërsinë, teatrin, muzikën, trashëgiminë e të shumë segmenteve tjera që janë shtyllat kryesore të identitetit tonë, ka kohë që nuk marrin vëmendjen që realisht e meritojnë, sepse kjo kohë është kohë e sensacioneve të kronikave të zeza, të cilat shiten dhe blihen me një lehtësi të çuditshme. Dhe mund ta marrim me mend se cilat janë pasojat kur një shoqëri në vazhdimësi ushqehet vetëm me gjera negative, me dhunë, me krime, me lajme dëshpëruese, mbase edhe të turpshme. Një nga pasojat thelbësore është humbja e ndjeshmërisë estetike, shijes për kulturën dhe për vlerat



shpirtërore. Këtë barrë sidomos e ndjenë dhe e përfetojnë më ndryshe ata (shumica përkohësisht) që jetojnë e veprojnë jashtë atdheut të tyre. Sepse mund ta marrim me mend se si ndjehemi kur dikush e drejton gishtin kah ne, duke na cilësuar si shoqëri

problematiche dhe me shumë të meta. Në të shumtën e rasteve ne vetë vetvetes ia vëmë “lakun” në qafë, duke u bërë burim i informacioneve fatkeqe, të cilat sa mbyll e hap sytë, me një shpejtësi që s’mund të imagjinohet, shpërndahen gjithandej ku

jetojnë e veprojnë shqiptarët. Fatkeqësisht, duket qartë se nuk jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e artit, letërsisë, muzikë dhe traditës së pasur që kemi e që në fakt janë segmente pothuaj të vetme që mund t’i japin shpresë identitetit dhe vizionit tonë historik përballë hijes së errët të kronikave të zeza.

Sot në të gjitha mediat kronikat kriminale mbulojnë hapësirën më të madhe dhe më të rëndësishme të tyre, ndërsa kultura më nuk është as në marginave e ngjarjeve që kanë një dinamikë, do të thoshim, pothuaj agresive. Ndaj, të gjithë faktorët relevant, sidomos pjesa intelektuale, forumet e ndryshme, organizatat joqeveritare, studentët, duhet të bëjnë presion dhe të jenë shembull të një vetëdije të lartë civilizuese dhe kulturën ta nxjerrin nga hija e kronikave të zeza.

Pra, këtë duhet ta bëjmë vetë, sepse rrugë tjetër nuk ka. Shqiptarët jashtë atdheut të tyre, të cilët më ndryshe i ndjejnë lëvizjet negative, kanë nevojë të shohin në horizont një reflektim e jo të jenë vazhdimisht kokulur dhe të dëshpëruar...

*Edicioni i 55-të i Festivalit të Teatrove*

# SHTATË NET NË TEATRIN E FERIZAJT

**Duke filluar nga dramat e fuqishme sociale e politike, deri te komeditë dhe tragjeditë njerëzore, Festivali i 55-të krijoi një pasqyrë të pasur të teatrit bashkëkohor shqiptar**

**Zyrafete SHALA**

Java e parë e shtatorit e ktheu qytetin e Ferizajt në epiqendrën e skenës kulturore shqiptare me Festivalin e Teatrove, një nga ngjarjet më të vjetra dhe më të rëndësishme teatrore në vend. Edicioni i 55-të, krahas shfaqjeve në konkurrencë, solli risi që e pasuruan rrjedhën e festivalit dhe e bënë atë më të afërt me publikun. Veçanërisht vlen të përmendet formati “Youth in the Black Box”, një seksion i dedikuar për të rinjtë, me katër shfaqje të veçanta, të zhvilluara në Galerinë e Arteve, si dhe dy punëtori me artistë ndërkombëtarë. Përfshirja e vullnetarëve të rinj në përgatitjen dhe mbarëvajtjen e festivalit, ishte një tjetër hap i menduar mirë drejt afrimit të brezit të ri me botën e artit dhe të teatrit.Përtej përjetimit skenik, çdo mbrëmje, oborri i Teatrit “Adriana” u shndërrua në një hapësirë të gjallë ku artistë dhe qytetarë u bashkuan në ndeja të shoqëruara nga këngëtarë dhe bende të përzgjedhura, duke krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe relaksuese. Festivali këtë vit u mbështet nga Ministria e Kulturës dhe Komuna e Ferizajt, por organizatorët u përballën sërish me vështirësi të mëdha, kryesisht për shkak të moskoordinimit të alokimit të fondeve me afatet e mbajtjes së ngjarjes, një sfidë kjo e përsëritur prej vitesh. Megjithatë, falë angazhimit maksimal të ekipit organizativ, nën drejtimin e regjisorit Besim Ugzmajli, festivali jo vetëm që u realizua me sukses, por në shumë aspekte arriti të tejkalojë pritshmëritë e publikut dhe të komunitetit artistik. Edicioni i 55-të u hap nga vetë nikoqirët,

Teatri “Adriana”, me një produksion ambicioz, shfaqjen “13”, me regji të Sulejman Rushitit, skenografi të Bekim Korçës dhe kostumografi të Eleonora Gagicës.Trupa, e përbërë nga trembëdhjetë aktorë, solli në skenë një narrativë të shtresëzuar dhe thellësisht reflektuese. Teksti i shfaqjes“13” ku sintetizohen pjesë të zgjedhura nga veprat emblematike të katër autorëve shqiptarë: Ismail Kadare, Gjergj Fishta, Mitrush Kuteli dhe Kristo Floqi, rrëmon në ndërgjegjen historike të shqiptarëve, duke ndërtuar një rrëfim të fragmentuar mbi humbjet, idealet dhe përpjekjet e kombit për t’i bërë ballë fatit të vet. Me një strukturë që lëviz lirshëm ndërmjet dramës, tragjedisë, farsës dhe komedisë, shfaqja ngre pyetje të rëndësishme jo vetëm mbi identitetin dhe kujtesën kolektive, por edhe mbi atë çfarë ne shqiptarët kemi bërë për veten. A kemi qenë të gatshëm të marrim përgjegjësinë në momentet vendimtare të historisë kombëtare, apo kemi zgjedhur të heshtim e të ndërmarrim veprime që na kanë dëmtuar më shumë.Këto dilema, të thëna e të pathëna, përçohen përmes shfaqjes me një intensitet emocional dhe intelektual që e vë publikun përballë vetes dhe historisë.

Nata e dytë e Festivalit të Teatrove solli në skenëshfaqjen “Bëje ose vdis”, me tekst nga Jeton Neziraj dhe regji të Blerta Rrustemi-Nezirajt, një homazh i fuqishëm teatoror për figurën e Ukshin Hotit, njërit prej zërave më të guximshëm të mendimit dhe rezistencës shqiptare. Kjo shfaqje, produksion i Teatrit “Hadi Shehu” të Gjakovës, rikonstrukton përmes skenës përjetime dhe situata nga burgjet serbe, jo vetëm të Ukshin Hotit, por edhe

të aktivistëve të tjerë që ndanë me të kohën e dënimit dhe sakrificës. Loja e aktorëve ndërthuret me rrëfime të vërteta të ish të burgosurve, duke i dhënë shfaqjes një ngjyrim të fortë dokumentar dhe emocional. “Bëje ose vdis” është një akt i kujtesës kolektive dhe një thirrje e heshtur për të mos harruar se liria e sotme është trashëgimi e një qëndrese të patundur që është paguar me çmimin më të lartë. Kompaniateatrore “Anamour”, nën regjinë e Erson Zymberit, solli në festival shfaqjen “Djali”, të autorit francez Florian Zeller, një dramë kjo e ndjeshme dhe tronditëse që flet për zbrazëtinë emocionale që shpesh fshihet pas mureve të heshtura të një familjeje të përçarë. Në qendër të rrëfimit është një adoleshent 17-vjeçar, Nikolasi, i ndarë mes dy prindërve, i cili përpigjet të rigjëjë stabilitetin dhe përkrahjen, por sa më shumë kërkon të afrohet, aq më shumë largohet. Ndërsa lëviz nga një prind te tjetri, ai përballet me mungesën e ndjeshmërisë dhe paaftësinë e të rriturve për të kuptuar dhimbjen e tij të heshtur. Loja e Yzeir Mehës, në rolin e Nikolasit, dhe Kushtrim Qerimit në rolin e babait të tij, e realizuar me mjeshtëri, solli emocione të fuqishme te publiku që ndau skenën, por edhe përjetimet me aktorët. Shfaqja ndërton me kujdes një peizazh të brendshëm ku pamundësia për të komunikuar bëhet vetmia më e madhe, dhe depresioni, si një realitet që nuk shihet, por që dhemb. Epilogu tragjik e kthen dramën në një thirrje të fortë për vëmendje ndaj plagëve të padukshme që gjithnjë e më shumë prekin të rinjtë në shoqëritë moderne. “Djali” është një përjetim emocional që s’të lejon të mbetesh thjesht spektator, por të fton të

reflektosh, si prind, si edukator, si njeri. Në natën e katërt të Festivalit, publiku i Ferizajt u zhyt në një botë të absurdit dhe komikes së errët, përmes shfaqjes “Komedi e zezë” të dramaturgut britanik Peter Shaffer. E sjellë në skenë nga Teatri “Bekim Fehmiu” i Prizrenit, kjo komedi klasike me regji të Ilir Bokshit ndërton një situatë teatrale të jashtëzakonshme, ku funksioni i dritës dhe errësirës përmbysset, kur personazhet ndodhen “në errësirë”, skena është e ndriçuar për publikun, dhe kur ndizet drita në botën e tyre, skena zhytet në terr. Ky truk brilant krijon një koreografi komike që sfidon perceptimin dhe shton tensionin në çdo hyrje e dalje të personazheve.Ritmi i shpejtë i situatave dhe lojërat vizuale me dritën e errësirën e shndërrojnë skenën në një arenë qesharake dhe të orkestruar mirë.Loja e aktorëve si Ernest Malazogu, Liridona Shehu Bytyqi, Hajat Toçilla, Xhevdet Doda,e të tjerë solli energji dhe diskonim te publiku. “Komedi e zezë” është dëshmi se edhe absurdi më i plotë, ndonjëherë mund të bëhet një reflektim i hollë mbi dëshirat, frikërat dhe egoizmin njerëzor. “God Bless America”, e shkruar dhe vënë në skenë nga Fatos Berisha, u prezantua nga Teatri i Qytetit të Gjiilanitnë natën e pestë tëfestivalit.Me një realizim që ndërthur absurditetin me realitetin brutal të jetës bashkëkohore, shfaqja, përmes një humori therës trajton temat e fesë, kapitalizmit dhe hipokrizisë morale. Katër shitës të Biblës që ndodhennë qendër të dramës sollën para publikut një botë të etur për fitim, ku gjithçka është në shitje, madje edhe morali. Udhëtimi i tyre përmes “tokës së mundësive” u vë përpara individë nga shtresa të

ndryshme të shoqërisë amerikane, ndërsa ata vetë lëkunden mes predikimit të vleravedhe jetës së shfrenuar. Ky dualitet është edhe boshti rreth të cilit ndërtohet ironia e shfaqjes që ofron një panoramë groteske të kapitalizmit fetar. Aktorët Avni Shkodra, Kushtrim Qerimi, Aurita Agushi dhe të tjerë, sollën një lojë të gjallë, dukekrijuar imazhin e një bote ku morali zhvishet përballë nevojës për mbijetesë. Në natën e parafundit të Festivalit, publiku u përball me një nga shfaqjet ndoshta më të thella dhe më tronditëse të këtij edicioni. “Prishtina. Vrasja e paralajmëruar e një ëndrrë”, me tekst nga Jeton Neziraj dhe regji të Blerta Nezirajt, është një dramë politike dhe njerëzore, e ndërtuar mbi një histori të vërtetë që ende rëndon në ndërgjegjen kolektive.E prodhuar nga Qendra Multimedia, me skenografi të Alice Vaninit dhe kostume nga Njomza Luci, shfaqja sjell në qendër figurën e arkitektit Rexhep Luci, planifikuesit urban të Prishtinës që u vra në vitin 2000, në përpjekjen e tij për të vënë rend në kaosin ndërtimor që pasoi luftën. Drama ngrihet mbi një realitet të zymtë dhe të dokumentuar me saktësi, një qytet i traumatizuar nga lufta, që në vend se të rindërtohet me kujdes publik, i dorëzohet grykësisë, korrupsionit dhe dhunës së organizuar.Shfaqja zbërthen me mjeshtëri mënyrën se si një ëndërr për një kryeqytet modern e të planifikuar u përmbyt nga etja për përfitim të shpejtë. Prishtina pasqyrohet si një hapësirë në të cilën parqet bëhen kantiere ndërtimi, rrokaqiejt mbijnë mbi rrënojat e shtëpive të vogla, dhe ligji zëvendësohet me kërcënime e vrasje. Në këtë kaos, zëri i vetëm i arsyes dhe vizionit afatgjatë, Rexhep Luci, mbetet i vetmuar dhe, më në fund, i heshtur me plumb. Performancat e aktorëve Armend Smajli, Verona Koxha, Shpëtim Selmani, Kushtrim Qerimi dhe Afrim Muçaj janë të përmbajtura, por të mbushura me tension, duke përçuar qartë absurditetin dhe tragjedinë e një realiteti që vazhdon të lërë pasoja.“Prishtina. Vrasja e paralajmëruar e një ëndrrë” është një kronikë teatrore e një krimi të paralajmëruar, por edhe një homazh për guximin qytetar, për njerëzit që, edhe pse e dinin çmimin, nuk pranuan të heshtnin. Nata e fundit e edicionit të 55-të të Festivalit të Teatrove në Ferizaj u zhvillua jashtë konkurrencës, por me emocionin dhe pritjen që karakterizon çdo mbyllje të madhe artistike. Pas një jave të ngjeshur me shfaqje të larmishme dhe interpretime të paharrueshme, skena e Teatrit “Adriana” mirëpriti ceremoninë solemne të ndarjes së çmimeve.Juria profesionale, e përbërë nga Agon Myftari-regjisor, Zyrafete Shala-kritike letrare dhe Simon Shkreli-aktor, vlerësoi kontributin artistik të dhjetëra aktorëve, regjisorëve dhe



bashkëpunëtorëve skenikë, duke ndarë çmimet më të rëndësishme të festivalit: Kostumografia më e mirë: NjomzaLuci – “Prishtina. Vrasja e Paralajmëruar e një Ëndrrë” Skenografia më e mirë: Bekim Korça – “13” Roli episodik më i mirë: Aurita Agushi – “God Bless America” Aktori më i mirë në rol dytësor: Kushtrim Qerimi – “God Bless America” Aktorja më e mirë në rol dytësor: Hajat Toçilla – “Komedi e Zezë”

Çmimi special:“Prishtina. Vrasja e Paralajmëruar e një Ëndrrë” Çmimi “Yll në ardhje” për një talent të ri: YzeirMeha – “Djali” Aktori më i mirë (çmimi “Ismail Rama”): Avni Shkodra – “God Bless America” Aktorja më e mirë (çmimi “Adriana”):Donika Zeqiri – “13” Çmimi i publikut:“13” Regjia më e mirë: SulejmanRushiti – “13” Shfaqja më e mirë e festivalit:“Djali” – prodhim i grupit Anamour Çmimin e publikut e fitoi shfaqja “13” me

regji të Sulejman Rushitit Ky edicion i festivalit konfirmoi edhe një herë rëndësinë e Ferizajt si një prej qendrave më të gjalla të artit skenik në vend. Duke filluar nga dramat e fuqishme sociale e politike, deri te komeditë dhe tragjeditë njerëzore, Festivali i 55-të krijoi një pasqyrë të pasur të teatrit bashkëkohor shqiptar. Përmes interpretimit, regjisë, skenografisë e reflektimit artistik, ky festival i dhuroi publikut një përvojë të paharrueshme dhe artistëve një skenë të denjë për të performuar.

## Shpërthimi i minierës

# TRE ARTISTË GJENIALË

**Xhojsi, Stravinski, Pikaso janë, në mënyrë të pavullnetshme, tre artistët gjenialë e të çinteresuar që kanë ushqyer konsumin e panjohur deri atëherë e të shitur**

### Zija VUKAJ

Në vitin 1910, në Trieste, Xhejms Xhojsi filloi “Uliksin”. Po në këtë vit, kompozitori dhe dirigjenti ruso- francez Igor Stravinski paraqiti në Paris “L’oiseau de feu”- “Zogu i zjarrtë”. Pak më parë, mes 1903 e 1906, Pablo Pikaso kompozoi piktura si “Zhonglerët”, “Jeta”, “Të varfrit në bregun e detit”, “Pirësja e helmit”, “Çifti”, “Akrobati dhe ekuilibristja e re” etj. Vlen të thuhet se shekulli filloi siç duhej të vazhdonte e siç vazhdoi, me një art të ribërë nga arti, një art jo më në gjuajtje të drejtpërdrejtë të realitetit, por të ndërmjetësuar nga estetizmi, një art të përcjellë nga vetëdija kritike, jashtë stuhive të kreativitetit drejt lagunave të palëvizshme të manierës e pra, më vonë të konsumit. Në të njëjtën kohë ose pak më parë, kishin qenë dhe

vazhdonin të ishin artistë realistë si Marsel Prust, projekti i të cilit, tekefundit, nuk ishte shumë i ndryshëm nga ai i një Balzaku; Vinsent Van Gogu, që kishte ditur të tregonte vërtet “përshkallëzimin” drejt çmendurisë; Riçard Vagner, me iluzionin të errësonte një mit të përjetshëm, kishte shkruar me “Tristanin” një opera të përpjesëtimeve të vogla skalitur e ndërtuar mbi dashurinë borgjeze. Çfarë i bashkonte Xhojsin, Stravinskin dhe Pikason? Që nuk kishin asgjë për të thënë; ose më mirë, nuk donin të thoshin asgjë mbi vetveten e mbi raportin me realitetin, por kishin për të thënë shumë mbi artin dhe raportin e tyre me artin. Indiferentë ndaj botës nga e cila refuzonin çfarëdolloj pjesëmarrjeje që të mos ishte e ndërmjetësuar nga arti, këta tre artistë karakterizoheshin nga një gjenialitet i

llojit të refleksionit, kritikës, teknikës, soditjes. Para shpirtit krijues, kishin syrin e estetit, nuhatjen e njohësit, dorën e imituesit. Ishin tre gjeni të pangopur e të gjithanshëm, që pasi kishin djegur në pak vite karrierën e artistit tradicional të lidhur me paraqitjen e realitetit, do të dinin të tejkalonin kufijtë e një kohe të pakapërcyeshme të shterimit, duke e zhvendosur veprën e tyre nga jeta në kulturë. Për të realizuar një operacion të tillë duhej kurajo, përmes një eksperimentimi të ngritur në sistem, të mohohej vlefshmëria e frymëzimeve të sipërpërmendura. Me fjalë të tjera, të shndërrohej muzeu në botë. Këtë bënë Xhojsi, Stravinski e Pikaso që kanë qenë kujdestarët e një inventari për ta shpëtuar nga qëllimet përvetësuese e plaçkitëse.

Pastaj qe e drejtë të ishte kështu. Duke nisur me konfliktin e parë botëror dhe me rënien në vazhdim të vlerave, gjithë arti i së shkuarës, i goditur nga vdekja e papritur, u bë për një çast muze. Tani, muzeu përse shërbente, në mos për caktimin e ngjashmërive të pagjasa, të afrimeve kufizuese, të katalogëve katastrofikë? Me muzeun zuri fill ideja e relativitetit të stileve, të shumësisë së formave, e të sqimës së shprehjes. Në analizë të fundit, ideja e konsumit kuptuar si shndërrim i krijimit në produkt. Xhojsi, Stravinski, Pikaso janë, në mënyrë të pavullnetshme, tre artistët gjenialë e të çinteresuar që kanë ushqyer konsumin e panjohur deri atëherë e të shitur. Kartat e tyre të fisnikërisë e bënë të shpërthente atë jo më nga kërkesa e tregut, por nga ekzigenca kulturore.

Anissa Markarian, aktore dhe shkrimtar

# ARTI SI TERAPI

**Në pamundësi për të vazhduar rrugën e nisur në kinematografi, iu përkushtova letërsisë. Megjithatë, aktrimi vazhdon të jetë i pranishëm edhe kur shkruaj. Në çdonjërin nga librat, mes morisë së personazheve që krijoj, dy a tri prej tyre i shoh si role të mundshme për t’i interpretuar**

**Avni HALIMI**

Anissa Makarian u lind në Tiranë. Është vajza e një nëne shqiptare dhe e një babai armen, i cili u mbijetoi masakrave të gjenocidit otoman dhe zgjodhi Shqipërinë për atdhe të dytë. Me gjithë prirjet për artin, sidomos për letërsinë e kinematografinë, ajo kreu studimet për mjekësi e punoi si mjekë në Tiranë deri në vitin 1991, kur emigroi në Francë.

Në vitin 1999 boton librin e parë, “Sënduku i kujtimeve”, përmbledhje tregimesh. Romani “15 ditë prilli” është libri i saj i dytë. “Shtëpia tek Selvia” është libri i tretë i autores. Të gjitha këto në botim të Shtëpisë botuese Çabej. Pastaj vijnë edhe “Fshesarja e Republikës” – roman i botuar nga Shtëpia Botuese “Albas”; 2024 dhe “Më përfytyrohesh...” – përmbledhje me tregime botuar nga Shtëpia Botuese “Shtëpia e Librit”;

Disa nga tregimet e saj të para u botuan në vëllimet “Stina e gonxheve” (përzgjedhje me proza nga autorë të rinj, Sh. B. Naim Frasheri, 1989) dhe Jetë tjetër (antologji me krijime nga autorë mjekë, Neraida 2001).

Në vitin 1978 interpretoi rolin e Dhuratës në filmin artistik “Vajzat me kordele të kuqe”, regjisor Gëzim Erebara; në vitin 1980 rolin e Zanës në filmin artistik “Në çdo stinë”, regjisor Viktor Gjika; në vitin 1988 rolin e Irenës në filmin artistik “Pranvera s’erdhi vetëm”, regjisor Piro Milkani;në vitin 1990 rolin e Ketit në filmin artistik “Ngjyrat e moshës”, regjisor Piro Milkani, në vitin 1993 rolin episodik në filmin artistik “Loin des Barbares”, regjisore Liri Begeja, në vitin 1994 rolin episodik në filmin artistik “Lie down with Lions”, regjisor Jim Goddart.

Në vitin 2020 ishte skenariste dhe prezantuese e mbrëmjes “Artistët për Artin” në skenën e Teatrit Kombëtar; në vitin 2020 interpretuese e letrës së Maria Casarës shkruar për të dashurin e saj, Albert Camus, në projektin “Letra e Mbrëmjes”, regjia Driada Dervishi, Teatri “Aleksandër Moisiu” Durrës; në vitin 2021 ishte autore dhe interpretuese e monologut “Njomëza” për projektin “Këpucët e kuqe - 8 gra rrëfejnë 8 histori të vërteta”, regjia Driada Dervishi, Teatri “Aleksandër Moisiu” Durrës; në vitin 2022, “15 ditë prilli” – dramatizim i romanit me të njëjtin titull, regjia Driada Dervishi; në viti 2023 ishte autore e monologut kushtuar historisë së Vilma Dules për projektin “8 aktore/8 histori gruaje”, ideja dhe regjia Driada Dervishi; ishte autore e monodramës “Gruaja me sirtarë”, realizuar në vitin 2024.

Është skenariste e filmave “Pranvera s’erdhi vetëm” (1987); “Ngjyrat e moshës” (1989) dhe “Stina e dytë” (2022).

Në vitin 1981 ishte bashkëprezantuese e Festivalit XX të Këngës në Radio-Televizion, regjisor Osman Mula; në vitin 1988 skenariste dhe bashkëprezantuese e spektaklit “Çmimet e Vitit”, regjisore Vera Grabocka dhe në vitin 1989, skenariste dhe prezantuese e ciklit me emisione mjekësore “Si të mbrojmë shëndetin”, regjisor Flamur Topi.

Anissa është fituese e disa çmimeve dhe pos shqipe, ajo flet dhe e shkruan frëngjishten, italishten, anglishten dhe armenishten.

HEJZA: Në një kohë kur kujtesa kolektive nganjëherë duket sikur po zbehet nën presionin e shpejtësisë së teknologjisë dhe harresës institucionale, njerëz si Ju, që mbani mbi supe dhe në shpirt edhe histori ekzili, bëhen bartës të heshtur të një trashëgimie të rrallë. A është kujtesa



për Ju një vend për t’u rikthyer, apo një vendbanim i dytë, një vend që ju rikthen vetvetiu? Ju thoni se qenka shumë vështirë për të rrënjëzuar në tokë të huaj?

ANISSA MARKARIAN: Vëzhgimi juaj është i drejtë e, njëkohësisht, shqetësues. Fatkeqësisht, kujtesa kolektive po zbehet e varfërohet nga dita në ditë, duke i hapur kështu shteg shtrembërimit të historisë dhe rishkrimit të saj në mënyrë subjektive. S’besoj se e ka fajin vetëm teknologjia dhe institucionet. Përgjegjësia është gjithëpërfshirëse. Fillon tek individi dhe prek të gjitha shtresat e shoqërisë, gjer tek organet më të larta vendimore. Nuk është një fenomen tipik shqiptar. Është një “pandemi” botërore. E ka burimin në sipërfaqshmërinë e vlerave të epokës sonë.

Harrojmë për t’u shpëtuar detyrimeve që lindin nga mirëmbajtja e kujtesës kolektive. Madje, kam përshtypjen se sa më e dhimbshme dhe e turpshme të ketë qenë e shkuara historike e një populli, aq më aktiv është procesi i frikshëm i harresës. E quaj të frikshëm, sepse përmban në vetvete rrezikun që e kaluara të përsëritet. E dëshmon edhe aktualiteti ndërkombëtar. Rastet e shkeljes me të dyja këmbët të të drejtave themelore të njeriut, i kemi përpara syve çdo ditë. Ndërsa popujt përgjumen, demokracitë tkurren e diktatorët shumëfishohen.

Ju më pyesni se ç’përfaqëson kujtesa për mua. Është pjesë e identitetit tim. Mirëmbajtjen dhe përcjelljen e saj e kam amanet nga prindërit. Më mëkuan me dashurinë dhe respektin për rrënjët

familjare dhe domosdoshmërinë për të mos harruar se nga vij. Pak ditë më parë humba tezen time të vogël, Aristea Mima Shvarc – përfaqësuesja e fundit e familjes së gjyshërve nga nëna. Ndonëse ishte 92 vjeç, vazhdonte të hidhte në një fletore kujtimet e vyera të fëmijërisë dhe të rinisë së saj për t’i shpëtuar nga harresa. Uroj që, një ditë, i biri t’i redaktojë e t’i përmbledhë në formë libri, në mënyrë që ky thesar jetësor të ruhet e të përcillet ndër breza në farefisn tonë.

HEJZA: Ndonjëherë kujtimet nuk vijnë si imazhe, por si tinguj. Zhurma e një burimi, një klithmë nga fëmijëria, një këngë e harruar. Kujtesa ka edhe dimensionet e pashpjegueshme, ndonjëherë ajo është heshtje që zgjat për dekada. Në ç’formë

ju rikthehen kujtimet? Janë pamje, janë zëra, janë ndjenja?

ANISSA MARKARIAN: Kur nisa të shkruaj librin autobiografik “Shtëpia te Selvia”, i kam rikthyer kujtimet me të gjitha shqisat. Ekzaktësisht siç kisha bërë për t’i mbajtur mend në kohën kur ndodhnin. Kam bindjen se një kujtim riprodhohet më lehtësisht nëse ngulitjen e tij e shoqërojmë me një ndjesi shqisore. Ja përse ndonjëherë, siç thoni ju, mjafton një tingull, një zë a një melodi për të na ngacmuar kujtesën. Herë të tjera mund të jetë një aromë, një shije, një pamje... Po ju sjell një shembull. Për të rrëfyer besnikërisht çastin kur shkela për herë të parë pragun e shtëpisë sonë te Selvia (isha vetëm 4 vjeç), nisa të përfytyroj një pemë portokalli në lulëzim. Sepse është imazhi i parë që kam ngulitur në kujtesë nga ajo ditë. Si me magji, kujtimet u bënë edhe më të prekshme kur hodha mbi shpinën e dorës 2-3 pika esencë lule portokalli dhe i nuhata fort. Pena shkau vetë pastaj.

HEJZA: Ne, brezi i vjetër dhe ai i mesëm, Ju kujtojmë si aktore filmi e shkëlqyer! Më pas keni punuar në sallat e reanimacionit dhe të urgjencës, dy univurse që trajtojnë në mënyra shumë të ndryshme dramën njerëzore. Trupi i njeriut, në njërën është metaforik, në tjetrën është literal, dhe të dyja kërkojnë një lloj përkushtimi shpirtëror. Çfarë lidhje ka për Ju ndërhyrja në një jetë njerëzore si mjeke dhe ndërhyrja në një personazh si aktore?

ANISSA MARKARIAN: Përpara se t’ju shpjegoj lidhjen, më lejoni të ndalem pak te fjala “ndërhyrje”. Në profesionin e mjekut, termi “ndërhyrje” është emërtimi më i saktë i veprimeve të tij. Për shembull: ndërhyrje e shpejtë mjekësore, ndërhyrje kirurgjikale, etj. Në rastin e aktorit, mendoj se fjala më e përshtatshme do të ishte “hyrje”. Një aktor hyn në jetën dhe karakterin e një personazhi, vesh petkat e tij. Ka aktorë që ndërhyjnë shumë në tekstin e dramës a të filmit, ndryshojnë dialogët dhe monologët. Ndonjëherë kërkojnë një makijazh a një krehje të veçantë, një veshje të re, një rekuizitë specifike, që i përshtatet më mirë personazhit të tyre. Kjo dëshmon se kanë hyrë plotësisht në rol. Në rastin tim, fakti që jam njëkohësisht mjeke dhe artiste përbën një pasurim të trefishtë, njerëzor, profesional e artistik, për të cilin ndihem me shumë fat. Në vitin 1987, kur shkruajta skenarin e filmit “Pranvera s’erdhi vetëm”, isha specializante në anestezi-reanimacion. Përvoja si mjeke më ndihmoi edhe në interpretimin e rolit të Irenës, pacientes me prognozë të keqe, që gjen forcat të mbarojë studimin që ka nisur, edhe pse i ka ditët të numëruara. Temën e përballjes me sëmundjen e pushërueshme e përfshiva gjithashtu edhe në skenarin e filmit “Ngjyrat e moshës”. Ket i, personazhi që interpretoj, shkon të takojë Valin, ish-shoqen e gjimnazit, që është e shtruar në spital. I tregon se do të mblidhen për të festuar 20-vjetorin e maturës dhe e fton të marrë pjesë edhe ajo, çka simbolizon një sfidë ndaj vdekjes. Ndërsa frymëzimi për të shkruar monologun e Ketit, të makijuar si kloun, më lindi një natë gjatë shërbimit të rojës tek kujdesesha për pacientët e reanimacionit. Kjo dëshmon se e kam të pamundur t’i ndaj me thikë artin dhe mjekësinë. Bashkëjetojnë brenda meje dhe “ushqehen” në mënyrë të ndërsjellë. Mjekësia frymëzon krijimtarinë dhe arti shërben ndonjëherë edhe si terapi.

HEJZA: A ka ndonjë moment nga koha Juaj si aktore që e mbani si kujtim të bukur, por që nuk do të donit ta përsërisnit më? Dhe, a e ndjeni se ajo pjesë e jetës Tuaj ishte një lloj “akt i parë”, që Ju përgatiti për gjithë veprën që do të vinte më vonë?

ANISSA MARKARIAN: Nëse bëhet fjalë për kujtime të bukura, mendoj se gjithkush priret nga një dëshirë e natyrshme për t’i përsëritur. Personalisht, gjithë duke e ditur se do të ishte e pamundur, do të bëja çmos për t’i ripërjetuar. Kjo s’do të thotë se jetoj me kokën të kthyer mbrapa. Për sa i përket rrugëtimit tim artistik, preludin e vërtetë e gjej te pjesëmarrja

në konkurset e recitimit dhe në grupin teator të Pallatit të Pionierëve. Ndërsa kontributin në kinematografi, e konsideroj si Universitetin tim të Arteve. Mësova shumë dhe u frymëzova edhe më shumë. Filmi është një vepër komplekse që përmbledh të gjitha artet: letërsinë, muzikën, pikturën, skulpturën, arkitekturën, fotografinë, regjinë, interpretimin... Kjo shpjegon ndoshta përse shkruaj një letërsi pamore. Hedh në letër atë çka filmoj me sytë e mendjes.

HEJZA: Ka një kalim të heshtur mes rolit në skenë dhe rolit në jetë. Dikur duhej të përfaqësohej dikush tjetër, sot, ndoshta, jeta kërkon që të jemi version i më i thellë i vetes sonë të vërtetë. Dhe ndoshta ky është roli më i vështirë nga të gjithë. A e shihni ndonjëherë veten si dikë që dikur “luante” jetë të tjera, e sot “jeton” një rol më të thellë e më të vërtetë?

ANISSA MARKARIAN: Përvoja ime modeste, me vetëm 4 role kinematografike, ma bën paksa të vështirë përgjigjen. Më vjen më mbarë të frymëzohem nga jeta dhe karriera e dajës tim, aktorit të shquar Prokop Mima. Tema e njeriut-aktor dhe e aktorit-njeri ishte shpeshherë e pranishme në bisedat që zhvilloja me të. Për mua, kalimet e tij nga skena në jetën reale dhe anasjelltas ishin të krahasueshme me ndërrimin e veshjeve përpara pasqyrës. Heqim njërën manto (atë të rolit) dhe e varim në gardërobë; pastaj tërheqim një tjetër (atë të njeriut privat), e hedhim mbi supe dhe hyjmë në jetë. Mbaj mend se e kishte shumë zët këtë krahasim. Njëkohësisht edhe idenë se të jetosh jetën tënde baras-vlerësohet me interpretimin e një roli që, shpesh, emërtohet si “roli më i vërtetë” i një aktori. “Po pranova këtë paralelizëm, do të thotë se jam aktor edhe në jetë”, – më shpjegonte. Besoj se i jepte shumë rëndësi të qenët vetvetja. Ishte një person i mbrujtur me fisnikëri, njerëzi e kulturë të gjerë, që kultivonte pasione të mëdha. Personazhet që interpretonte në skenë nuk i braktiste kurrë. I punonte e i ripunonte pa fund, sepse ishte maniak i përsosmërisë. Dhe kuptova se rolet s’mund të ishin pallto që zhvisheshin e vareshin në portmanto gjer në dramën e ardhshme. Ato ishin krijesat e tij për të cilat duhej të përkujdesej çdo ditë. Njëlloj siç bënte edhe me lulet.

HEJZA: Mjekësia është në heshtje, në përqendrim, në përgjegjësi, një terren larg kamerave, larg vështrimeve. Ndonjëherë, shpirti i ndjeshëm kërkon pikërisht këtë: të mos jetë më objekt vështrimi, por mbajtëse e tjetrit. Kur iu kthyet mjekësisë, e ndjetë këtë si thirrje që vjen nga brenda, apo si një rrugë larg nga zhurma dhe ndriçimi i skenës?

ANISSA MARKARIAN: Do t’ju duket e habitshme, por unë gjej shumë ngjashmëri mes një ndërhyrjeje kirurgjikale në sallën e operacionit dhe xhirimit të një skene filmi në atelie. I kam përjetuar të dyja situatat dhe mund t’ju numëroj një sërë elementesh të përbashkëta. Duke filluar nga ndërtimi i dekorit. Ndonëse salla e operacionit mund të jetë e njëjta, lloji i aparaturave dhe vendi ku pozicionohen ndryshojnë sipas specifikës së ndërhyrjes që do të kryhet. E njëjta gjë edhe me ndriçimin. Duhet të jetë optimal dhe të fokusohet aty ku ndodh aksioni. Nëse për të xhiruar një skenë, aktorit i duhet të veshë kostumin e rolit e të kalojë në dhomën e grimit, kirurgu kalon së pari nga salla e larjes së duarve, pastaj vesh bluzën dhe dorezat sterile e... “hyn në rol”. Kur xhirohet në atelie, nuk lejohet asnjë pipëtimë tjetër përveç zërit të aktorëve dhe zhurmave të skenës që po filmohet. E njëjta heshtje dhe i njëjti përqendrim kërkohen edhe përpara se të fillojë operacioni. Më mrekullon sidomos çasti fillestar i veprimt. Regjisori hedh një vështrim të fundit rreth e rrotull pastaj thërret: “Motor!”. Kirurgu, me të marrë sinjalin e anestezistit, ndez bisturinë elektrike dhe fillon operacionin. Por, ushtrimi i mjekësisë përputhet më së miri edhe me mungesën e heshtjes. Më besoni, nuk ka pavijon më “të zhurmshëm” se ai i Urgjencave. Aq sa, ndonjëherë, kur

kthehem në shtëpi, u lutem të mive të mos më flasin për nja një orë a dy, sepse e kam të nevojshme të shijoj pak qetësi. Në këto raste, marr kompjuterin e ulem të shkruaj. Me fjalë të tjera, edhe pse mund të tingëllojë paradoksale, strehohem tek arti për të rimarrë veten nga zhurmat e mjekësisë.

HEJZA: Shkrimi është ndryshe nga aktrimi, aty nuk sheh askush fytyrën tënde, por ndjen mendjen dhe zemrën tënde. Është më e thellë se loja, më e ngadaltë se skena, më e vërtetë ndonjëherë se vetë rolet. A është për Ju shkrimi një përkushtim më i thellë ndaj artit sesa aktrimi – një lloj rikthimi në thelb?

ANISSA MARKARIAN: Shkrimin dhe aktrimin i shoh si dy shprehje artistike që plotësojnë njëra-tjetrën. Po të varej nga unë, do të kisha zgjedhur të vazhdoja të interpretoja role. Të qenët pjesëtare e një kolektivi krijues më frymëzon shumë më tepër se sa arti vetmitar. Në pamundësi për të vazhduar rrugën e nisur në kinematografi, iu përkushtova letërsisë. Megjithatë, aktrimi vazhdon të jetë i pranishëm edhe kur shkruaj. Në çdonjërin nga librat, mes morisë së personazheve që krijoj, dy a tri prej tyre i shoh si role të mundshme për t’i interpretuar. Dhe, me dashje a pa dashje, i mbaj paksa me hatër gjatë procesit të shkrimit. Për

kënaqësinë time më të madhe, të njëjtën gjë bëjnë shpeshherë edhe lexuesit. Më përfytyrojnë si personazh të librave të mi, sepse më njohin tiparet, zërin, mënyrën e të folurit dhe shprehjet e mimikës.

HEJZA: Në letërsi, çdo fjalë ka peshë, mund të shërojë ose të dëmtojë. Në sallën e operacionit, ndonjëherë nuk ka kohë për fjalë, por heshtja bëhet lutje. Në film, një fjali mund të mbetet përjetë. Çdo hapësirë e profesionit Tuaj e ka përdorur fjalën në mënyra të ndryshme. Cila është fjala që ju ka munguar më shumë në një nga këto tre botë – fjala që s’u tha në kohë, që s’u gjet dot, që nuk mund të thuhet as në letër, as në film, as në sallën e emergjencës?

ANISSA MARKARIAN: Një fjalë e pathënë, s’është domosdoshmërisht e munguar. Ka raste kur buzët s’arrijnë të shqiptojnë as edhe një rrokje, por sytë flasin shumë. E tillë është për mua shprehja e mirënjohjes nga ana e një pacienti që sapo është përmendur nga anestezia apo një lot që rrokulliset faqeve të një prindi kur i shpëtojmë fëmijën nga rreziku. Fjala që uroj të mos mungojë kurrë në mjekësi është diagnoza e saktë e sëmundjes. Ndërsa fjala që më mungon në art, të cilën kam mall ta dëgjoj e t’i bindem, është: “Motor!”

HEJZA: Ka një ndjesi të thellë etike dhe estetike në aktin e shpëtimit – qoftë



përmes një roli, goftë përmes një teksti, goftë përmes një ndërhyrjeje në trupin e njeriut. Nganjëherë aktorja shpëton personazhin nga harresa. Nganjëherë mjekja shpëton një jetë. Nganjëherë shkrimtarja shpëton veten. Në cilën nga këto tre hapësira keni ndier më shumë se e keni shpëtuar dikë – apo veten?

ANISSA MARKARIAN: Në profesionin tim, shpëtimi i jetës së tjetrit është një hollësi që nuk bën bujë. Sepse është akti thelbësor i zanatit e jo heroizëm. Ndërsa arti ka kute të tjera. I duhet të prekë shpirtin e të ngjallë emocione; të çlodhë, të frymëzojë e të argëtojë. Kur arrin të shpëtojë një jetë, ka arritur një kulm madhor. Dhe ky fakt kthehet menjëherë në një lajm të bujshëm. Si aktore, besoj se jetëgjatësinë më të bukur ia kam dhuruar Zanës, volejbollistes romantike të filmit “Në çdo stinë”. Si shkrimtare, me librin “Shtëpia te Selvia” kam shpëtuar nga harresa dy dekada ngjarjesh familjare. Ndërsa fakti që vazhdoj të shkruaj edhe në mërgim, më ndihmon të shpëtoj shqipen time. Falë shkrimit, arrita të ruaj kthjelltësinë gramatikore e letrare të gjuhës amtare dhe për këtë ndihem shumë krenare.

HEJZA: Të gjithë librat Tuaj i japin zë të kaluarës, një jete të jetuar në hije, në ndalim, në nostalgji. Ato janë si faqe të shkruara për të ruajtur një përvojë që përndryshe mund të zhdukej. Letërsia bëhet si një kuti e vogël për t’i fshehur gjërat e brishta. A e konsideroni shkrimin si një mënyrë për t’u çliruar nga heshtja?

ANISSA MARKARIAN: Absolutisht! Hedhja në letër e mendimit, e një hovi shpirtëror apo edhe e një ëndrre fluturake e aq më tepër rrëfimi i një historie, goftë ajo e vërtetë apo e sajuar, është një akt çlirues. Duke çliruar fjalën, zbusim edhe trysninë e krijuar brenda nesh nga magazinimi i mbresave, kujtimeve, dëshmimeve ose, thjesht, nga trillimet e një fantazie të shfrenuar. Për mua, shkrimi përfaqëson edhe një mënyrë të këndshme për të lidhur miqësi të reja. Ndonëse virtualisht, rrethi im miqësor zgjerohet nga libri në libër. Ja përse çdonjërin prej tyre e mbaj gjatë nëpër duar. Dëshiroj të kënaqem sa më shumë në shoqëri me personazhet që kam krijuar përpara se dorëshkrimi të marrë udhën drejt shtypshkronjës dhe lexuesve.

HEJZA: Shkrimtarët që jetojnë në dy ose më shumë gjuhë shpesh përballen me një ndarje të brendshme: njëra gjuhë është zemra, tjetra logjika e mbijetesës. Njëra është permallim, tjetra disiplinë. Ky tension përkethehet në një kompleksitet të bukur në tekst. Si bashkëjetojnë në Ju gjuha shqipe dhe ajo frënge, por edhe ajo e të parëve të Juaj – gjuha armene?

ANISSA MARKARIAN: E lindur në një familje me origjinë armene-shqiptare, kam qenë dygjuhëshe që në moshë fare të mitur. Armenishtja ishte gjuha e tim



eti, shqipja gjuha e sime ëme dhe, që të dyja, më tingëllonin shumë të ëmbla. Kur nisa të mësoj mbi gjenocidin otoman ndaj armenëve dhe u ndërgjegjësova se isha bijë e një të mbijetuarit të atyre

masakrave, armenishtja u bë një urë lidhëse shpirtërore me tokën dhe historinë e të parëve dhe të tillë e konsideroj edhe sot. Shqipja është tjetër gjë. Është gjuha e rrënjëve amnore, gjuha e arsyes dhe

e frymëzimit artistik. Bukurinë, por edhe tragjizmin e saj i zbulova falë kulturës gjuhësore të familjes së nënës. Te Mimallarët, shqipja jo vetëm flitej e këndohej, por përkëdhelej e ngrihej në





pedestal gjithashtu. Pas shqipes dhe armenishtes, gjuha e tretë që mësova është italishtja. Vite më pas, kur mora rrugën e mërgimit, zotërimi i italishtes më ndihmoi të ridiplomohem mjeke në Universitetin e Gjenovës – një etapë thelbësore për ushtrimin e mjekësisë në Francë. Ja përse italishten e konsideroj si gjuhën e rilindjes sime profesionale. Prej më shumë se tri dekadash, tashmë, gjuha ime e përditshme është frëngjishtja. Mësimin e saj ia dedikoj profesorit tim të nderuar, zotit Aziz Vrioni, patriot dhe intelektual shqiptar, i diplomuar në Paris, i cili kaloi 28 vjet në kampet e punës, i dënuar për propagandë antikomuniste. Falë tij, ato orë leksionesh ishin gjithashtu një arratisje e bukur drejt qytetërimit dhe kulturës franceze. Orët e takimeve të privilegjuara: Molière, Corneille, Racine, Voltaire, Montesquieu, Chateaubriand, Rimbaud, Bodelaire...

HEJZA: Arti shpesh përfaqëson jo vetëm ndjeshmërinë, por edhe përgjegjësinë. Sidomos kur vjen nga dikush që mban brenda vetes historinë e një populli të përndjekur. Të flasësh është një akt estetik, por edhe një akt etik. A keni ndjerë ndonjëherë se duhet të flisni - në letërsi, në film apo në intervista - jo vetëm për veten, por për të tjerët që nuk patën mundësinë të flasin? A është arti për Ju një lloj “mbrojtje e kujtesës së harruar”?

ANISSA MARKARIAN: Romanin tim të parë, “15 ditë prilli”, e quaj një vepër kryekëput militante. E tillë u përçua te publiku edhe drama me të njëjtin titull, vënë në skenë nga trupa e teatrit “A. Moisiu” të Durrësit në mars të këtij viti me regji të Driada Dervishit. Shtysa themelore për shkrimin e romanit ishte denoncimi i një të vërtete barbare për të cilën nuk ishte folur kurrë zyrtarisht. E kam fjalën për kufomat që disektonim në Fakultetin e Mjekësisë. Në vend që t’u dorëzoheshin familjeve për t’i qarë e varrosur denjësisht, trupat e djelmoshave të ekzekutuar përfundonin si material mësimor në laboratorët e anatomisë. I gjithë romani është një thirrje për të mos harruar të kaluarën e për të mos ulur kurrë vigjilencën. Sepse despotët mund të lindin në çdo kohë. Kur u japim tepër pushtet, kur nuk u kërkojmë llogari, kur u lejojmë ta mbajnë kolltukun për periudha të gjata kohe apo i brohorasim dhe i votojmë symbyllur.

Të njëjtin mision përmbush edhe romani im i dytë, “Fshesarja e Republikës”. Faqeve të tij u jap zë vajzave e grave të minoritetit rom e egjiptian, që në Shqipërinë e para viteve ‘90 konsiderohej si “i dorës së dytë”. Njëkohësisht, përmes fateve të tyre, përvijoj edhe problemet me të cilat përballet shoqëria shqiptare sot.

HEJZA: Ka raste kur bukuria e artist rrezikon të romantizojë dhimbjen. Aktorët, shkrimtarët, madje edhe mjekët, përballen ndonjëherë me pyetjen: a ka kufij ajo që mund të shfaqim, tregojmë ose trajtojmë? A keni përjetuar ndonjë konflikt mes asaj që është estetikisht e fuqishme dhe asaj që është etikisht e drejtë?

ANISSA MARKARIAN: Në punën time si mjeke zbatoj pa kompromise tri parime themelore: të qenët e përkushtuar, e pavarur dhe e drejtë. Me fjalën “e drejtë”, nënkuptoj ruajtjen e baraspeshës mes vendimeve terapeutike dhe nevojës së tyre. “Primum non nocere”, thoshte Hipokrati. Gjithashtu, respektoj me rreptësi sekretin profesional. Nuk e kam shkelur kurrë, për asnjë lloj arsye. Në letërsi, ndihem shumë më e lirë. Plotësisht e lirë! Kjo s’do të thotë se shkruaj pa përfillur normat etike. Por, në ndryshim me mjekësinë, s’jam e detyruar të zbatoj protokolle të parashkruara. Nga kjo pikëpamje, mjekësia dhe letërsia (ose arti në përgjithësi) qëndrojnë në dy plane diametralisht të kundërta. Në mjekësi, sidomos kur duhen marrë vendime shumë të shpejta, mosrespektimi i protokolleve të aprovuara e të sprovuara është humbje e pafalshme kohe dhe burim gabimesh profesionale. Ndërsa në art, përkundrazi, janë të mirëpritura eksperimentimet, dalja nga kornizat, novatorizmi. Mendoj

se kjo liri në të shkruar është njëra nga arsyet se përse lëvroj realizmin magjik.

HEJZA: Në shumë kultura, historia shkruhet nga burrat, por trashëgohet nga gratë. Gratë janë ato që ruajnë albumet, recetat, heshtjet, mallin. Ato nuk shkruajnë gjithmonë libra, por ruajnë botë të tëra. A keni trashëguar ndonjë histori, zakon, ose heshtje nga gjyshet apo nëna Juaj, që sot e ndjeni si pjesë të identitetit tuaj? A është letërsia Juaj ndonjëherë një përpjekje për t’i “dhënë zë” këtyre grave të harruara?

ANISSA MARKARIAN: Në formimin e ndjeshmërisë sime artistike kontributin vendimtar e ka dhënë pikërisht një grua. E kam fjalën për teta Itën, tezen e sime ëme. Jetonte në një shtëpi me ne dhe është personi që më ka rritur. Në shenjë mirënjohjeje, i kam dedikuar përmbledhjen me tregime “Më përfytyrohesh”. Si te Markarianët ashtu edhe te Mimallarët, gratë ishin pikë referimi. Gjyshja, nëna, motra e madhe... Edhe pse lekun e fitonin meshkujt, kuletën e familjes e administronin femrat. Përveçse nikoqire të zonja, disa prej tyre kishin edhe prirje artistike. Sidomos gjyshja ime nga nëna, momë Sia. Besoj se nga gratë e familjes kam trashëguar kënaqësinë dhe dëshirën për të rrëfyer. Ishin rrëfimtare të shkëlqyera! Kujtoj me përmallim të veçantë orët e kaluara duke i dëgjuar të më tregonin përralla, libra, filma, ngjarje familjare dhe fakte historike nga e kaluara e vendit.

HEJZA: Ndonjëherë libri që shkruajmë është si një “send i shenjtë” – i ngjan një ikone, një thesari të fshehtë. Ai bëhet vendi ku vendosim kujtimet tona më të rënda, por edhe më të shenjta. A ndiheni sikur librat Tuaj janë arka të vogla shpëtimi, të mbushura me copëza kujtese, dhimbje, por edhe dritë?

ANISSA MARKARIAN: Kur përmbylla librin autobiografik “Shtëpia te Selvia” u ndjeva e lehtësuar nga një përgjegjësi e madhe. Kisha përmbushur amanetin e prindërve. Uroj që, një ditë, çdo familje të shkruajë librin e saj të kujtesës. Dhe kështu, paftë pas pafte, do të arrijmë ta ndërtojmë të plotë mozaikun e vyer të së kaluarës sonë kolektive.

HEJZA: Letërsia është një mënyrë tjetër për të prekur trupin e tjetrit, atë trupin simbolik, shpirtin. Ndërsa pacienti i dorëzon mjekut jetën për ta shpëtuar, lexuesi i dorëzon autorit plagën për t’u kuptuar. Nuk është më pak e shenjtë kjo marrëdhënie. Kur ju lexojnë, a ndjeni se njerëzit po kërkojnë tek Ju përgjigje – apo, a është lexuesi për Ju një pacient i padukshëm, që kërkon shpëtim përmes fjalës?

ANISSA MARKARIAN: Lexuesin më pëlqen ta quaj një bashkudhëtar. I ftuar në një aventurë për të cilën mbaj përgjegjësi të plotë. Nëse vendos të më ndjekë (të më lexojë), e ka parasysht se rruga mund të jetë e paasfaltuar. Herë i duhet të jetë alpinist, herë speleolog e më tej palombar. Ndoshta e ndjell pikërisht ky lloj tharmi. Secili ka sfidën e vet. Kush me natyrën, kush me vetveten. Ndokush edhe me gjuhën. Nuk e merrni dot me mend ngazëllimin që provoj kur lexues nga atdheu apo në mërgim më shkruajnë se pas leximit të librit, u lindi dëshira të spastrojnë leksikun e shqipes së tyre.

HEJZA: E kaluara dhe e tashmja juaj përthuren si fije të një cope të veçantë, ku identiteti nuk është një etiketë, por një udhëtim i përhershëm për të ruajtur njeriun brenda njeriut. Nëse do të përpiqeshit ta përmbliidhnit veten përmes një metafore – si njeri, si mjeke, si artiste e shkrimtare dhe si nënë – cili do të ishte imazhi më i afërt me të vërtetën Tuaj sot?

ANISSA MARKARIAN: Nënë dhe grua e përmbushur, mjeke, artiste dhe qytetare e përgjegjshme. Ju falënderoj nga zemra për kënaqësinë që më dhuroi kjo bisedë. Ndihem e nderuar.

## Profile

# MURAT ISAKU

**Autori me shumë kujdes do ta trajtojë konfiguracionin gjeografik të Malit Sharr, njerëzit, banorët e tij, doket dhe zakonet e së kaluarës. Ai i përshkruan në mënyrë besnike edhe kontradiktat shoqërore, aspektet e jetës sociale**

#### Nehas SOPAJ

U lind në Gajre të Tetovës më 1928 dhe vdiq në moshën 77-vjeçare në Tetovë në vitin 2005. Mësoi në Tetovë, Elbasan, Prishtinë, Prizren, maturën e mbaroi në Normalen e Elbasanit, studimet e larta, për gjuhë e letërsi, i mbaroi në Beograd më 1953. Punoi si profesor i gjuhës shqipe në gjimnazin e Tetovës dhe pastaj u emërua si zv. drejtor i kësaj shkolle. Më vonë u caktua redaktor i TV Shkupit për emisionet në gjuhën shqipe, ku edhe u pensionua. Murat Isaku paraqet një nga figurat më të veçantë të letërsisë shqipe. Gjithë vepra e tij letrare, si atëherë kur ajo qe krijuar, por edhe sot kur autori nuk është më, sikur del i pavarur nga subjektiviteti, duke iu përmbajtur rregullave teorike si forma të një realizmi klasik që e ka ngritur dhe kultivuar shkrimtari, si në poezi, ashtu edhe prozë – vepra e para unit të autorit. Vepra u përmbahet rregullave të moscenimit zhanror që e krijon ajo: poezitë e autorit janë poezi, po kaq sa prozat e tij janë proza me kuptimin e plotë të fjalës. Te ky shkrimtar realist është e kotë të kërkosh eksperimentime ose krijime hibride, çfarë i shohim sot tek krijojnë krijuesit modernë, sado që autori i takon kohës sonë. Në konditat e bashkëkohësisë dhe të postmodernizmit, Murat Isaku edhe me konceptin e tij të realizmit të klasik i ka përjashtuar të gjitha eksperimentimet letrare. Prandaj, për nga karakteri, për nga zhanret dhe për nga ndërtimi i tyre, ato janë krijime letrare realiste klasike në kuptimin e plotë të fjalës, pasi që aty nuk ka tentim për thyerje të kanoneve letrare të realizmit, siç bëjnë sprovuesit e sotëm. Me një fjalë, autori është shkrimtar realist klasik në plotkuptimin e fjalës.

Marrë në përgjithësi, autori ka shkruar më pak poezi sesa prozë dhe kjo lë të mendosh se ai së pari është prozator po pastaj edhe poet. Duke lexuar mijëra faqe në prozë që kish shkruar autori, të cilat atij i kishte marrë shumë kohë për t’i krijuar, kjo me automatizëm na lë përshtypjen sikur e lë poezinë në dorë të dytë. Po kur themi se Murat Isaku, në përgjithësi, ka shkruar më pak poezi, por shumë më shumë prozë, sa herë flitet për këtë temë, mendoj se këtë mendim duhet marrë me rezervë, sepse në disa krijime në poezi, në metabolizmin artistik (mimesisit dhe katarsisit), autori qëndron më lart si poet sesa si rrëfimtار.

Edhepse prin mendimi se Murat Isaku është mbi të gjitha prozator, mund të themi se disa nga krijimet e tij më të dalluara nga vëllimi poetik Zani i malit, Drithma, por edhe Kurora e trollit, janë shumë më të realizuara artistikisht, sesa, të themi për shembull, faqe të tëra të romanit Gjaku i sharraxhive. E, pra, pa marrë parasysh se autori kishte derdhur shumë kohë dhe energji për ta shkruar këtë roman, sheshit shihen oscilime gjatë receptimit mimetik të “matjes” së vlerave të vërteta estetike të këtij romani. Dhe, kjo jo vetëm sepse autori vetë e kishte mënjanuar këtë vepër dhe nuk e përmendte më në bibliografinë e tij, por edhe sepse shpërthimet lirike në disa nga veprat e tij më të mira në poezi qëndrojnë shumë më lart për nga vlerat dhe realizimet artistike.

Mendimi kritik, megjithatë, mund të ndryshojë kur e lexojmë romanin Rreckajt. Ky roman, që për epiqendër e ka temën e qëndresës në kohë të sundimit osman, mban epitetin e kryeveprës së Murat Isakut si realizimi artistik më i arrirë qoftë, si temë e përpunuar shumë më mirë sesa te tre romanet e para të autorit (Dielli e din rrugën e vet, Flaka e vonuar dhe Gjaku i sharraxhive), qoftë si për nga mjeshtëria e mbarështrimit të lëndës



gjuhësore, ashtu edhe për nga mesazhi qendror i temës së qëndresës. Megjithatë, faqe të caktuara të romanit kanë vlime poetologjike (shihni për këtë gjë disa nga faqet e veçanta, ku protagonist i flet në monolog të brendshëm), pra ku ngjyrimi i folësit në vetë të parë merr timbre lirizmi dhe ku shpërthen si poet.

Murat Isaku u lind, u rrit dhe u kultivua në konditat e një ngrysjeje të përhershme shoqërore, ku përplasjet e krijuesit duhen lexuar si “za mali”, “drithma”, “plagë”, “damka”, “shtjella”, “fatprerët”etj., mu ashtu siç vetë titujt e veprave i shpjegojnë dhe në frymën e epokës në të cilat kishin lindur duke i shpjeguar ngjyrat e errëta. Vepra e këtij shkrimtari, qysh në fazën e tij krijuese, ka një prekje të lehtë të realizmit socialist tipike për kohën, e ndikuar nga shteti amë, e butë dhe subtile, që nuk prish asgjë në vlerat e përgjithshme që ka vepra e shkrimtarit. Si autor i disa librave me poezi dhe tregime, sidomos autor i disa romaneve, Murat Isaku ka qenë shkrimtar aktiv në letrat shqipe, duke krijuar vepra gjinishë të ndryshme në poezi e prozë më se gjysmë shekulli. Duke filluar me poezi dhe duke mbetur në prozë, më saktë në kultivimin e romanit, ai u përpoq t’i trajtojë disa nga temat më vitale për kohën, siç është tema e qëndresës kombëtare, të cilën e ka trajtuar me sukses dhe në mënyrë origjinale. Në kuadër të kësaj teme, autori me shumë kujdes do ta trajtojë konfiguracionin gjeografik të Malit Sharr, njerëzit, banorët e tij, doket dhe zakonet e së kaluarës. Ai i përshkruan në mënyrë besnike edhe kontradiktat shoqërore, aspektet e jetës sociale, të vrojtuaa nga aspekti historik, pastaj merret me temën e dashurisë, intimën e njeriut, brenditë e tij personale, disa prej të cilave janë të përpunuara në nivel të lartë artistik, madje për t’ia pasur lakmi.

Në fillet e tij letrare, ai merret me temën sociale, siç është tema e fatit të sharrëxhinjve (trasuar i pari nga E. Mekuli), por pastaj bota e tij do ta zgjerojë dioptrinë e vrojtimit të shoqërisë klasore, duke inkorporuar tema të tjera të ndryshme shoqërore, kombëtare dhe sociale. Në fazën e parë krijuese autori do t’i rreket temës së emancipimit të gruas shqiptare, që dikur ishte në modë. Duhet

dalluar romanin e parë të autorit, Dielli e din rrugën e vet, në të cilën trajtohet tema e emancipimit të fshatit tonë, e trajtuar edhe nga shkrimtarë nga më të ndryshmit e letërsisë sonë dhe, vetvetiu, një dozë ngjyrimi socrealist, tema këto që ishin të nënkuptueshme për kohën kur ishin të gjalla. Ajo që është me rëndësi të thuhet për këtë roman, është se Murat Isaku shquhet si mbujtës, qëmtues dhe lëvrues i thellë i pasurisë gjuhësore të shqipes, lëvrues i gjuhës së folur të personazheve, folklorit, fjalëve të urta e aforizmave të transponuara në formë alegorike, shpesh me tharme ironike dhe sarkastike gjatë modelimit të personazheve. Kjo rrugë e trasuar do të zgjerohet dhe thellohet më tej, sidomos me romanet Plagët, Rreckajt, Fatprerët etj. Me një fjalë, të gjitha veprat letrare në prozë i shquan begatia gjuhësore dhe shprehjet e shumta frazeologjike, duke krijuar mozaikun e lakonizmit të gjuhës së folur të personazheve.

Pos romanit Dielli e din rrugën e vet, Murat Isaku krijon një roman tjetër me natyrë erotike, me elemente autobiografike, që e magjeps lexuesin. Ky është romani Flaka e vonuar në të cilën autori si rrallë ndonjë krijues tjetër i rreket temës së dashurisë që përherë do ta ketë lexuesin e pasionuar, por edhe si temë që artistikisht është punuar mirë. Në një mori romanesh dhe përmbledhjesh me tregime, Murat Isaku do t’i rreket përshkrimit të ambientit të Pollogut, duke pasqyruar njeriun shqiptar, femrën shqiptare, malësorin tonë, sharrjanin, duke e parë dhe pasqyruar atë nga këndi i tij origjinal dhe duke ia dhënë atij timbrin e gjuhës së folur të personazheve.

Në fazën e tretë krijuese, në vitet e ’70-ta, te autori veçohet posaçërisht romani Rreckajt, një roman i qëndresës kombëtare në të cilën e portretizon malësorin tonë, i cili në kohë të gjitha kohërat reziston për të mbijetuar, një temë qendrore e kohës, shumë karakteristike për të gjithë krijuesit shqiptarë që krijonin jashtë shtetit amë, në Kosovë, Maqedoni etj. Është kjo faza më e lartë krijuese e Murat Isakut, koha kur krijuesi tashmë është pjekur astistikisht. Vitet e ’70-ta janë vitet më të rëndësishme për shumë krijues bashkëkohorë shqiptarë, ndër të cilët edhe

Murat Isaku. Janë shumë impresive dhe artistike disa nga faqet e këtij romani, ku – përmes personazhit kryesor, Kelmend Garria, ndjehet protesta e shkrimtarit ndaj pushtuesit, ndërsa gjithë këtë e bën përmes formës së monologut të brendshëm, një mënyrë e re e rrëfimit të autorit, për të shfaqur zërin e brendshëm, thjesht autorial, që ë vonë do të artikullohet edhe më hapur në fazën tjetër, të katërt.

Në vitet e ’70-ta tema e qëndresës kombëtare i preokupon të gjithë krijuesit e të gjitha gjinive dhe zhanreve letrare, sidomos te shkrimtarët e pjesës së dytë të trojeve shqiptare, ku bën pjesë edhe M. Isaku. Romanet Vdekja më vjen prej syve të tillë të R. Qosjes, Rruga e shtëpisë sime të N. Rrahmanit, Shtatë persona ndjekin autorin të R. Kelmendit, Vegullia të B. Musliut etj. në të cilën mund të radhitet edhe romani Rreckajt e M. Isakut, është koha kur qenë krijuar disa nga veprat që edhe sot paraqesin vlerë dhe vepra ndër më të rëndësishmet të letërsisë bashkëkohore shqipe edhe për shkakun se ato për temë qendrore e kanë qëndresën kombëtare. Vepra në fjalë, Rreckajt, veçohet sidomos me një diskurs lirik, me tone dhe klithma të thella të shpirtit, ku, krahas “dramës” së rrëfimit, e krijon protestën dhe ku, sidomos në disa nga faqet e këtij romani, autori e artikulon zërin e tij të vërtetë, zë që i del me lartësi të shpirtit në rrëfimet e tij, fshehur pas “sharrjanit” protagonist i cili i përçon idetë si mesazhe të shkrimtarit.

Faza e fundit krijuese e Murat Isakut e përmbledh produksionin e vonshëm, që nis me romanin Shtjella deri te romani Fatprerët. Kjo fazë krijuese del nga kornizat e vendosjes së ngjarjes në kohë dhe hapësirë konkrete, ik nga historia dhe miti, duke u bartur në bashkëkohësi. Kjo është koha kur krijuesi merret me kritikën e shoqërisë së prishur,riticizmin e asaj aparature degjenerike që prin në shoqëri, një vlerë tjetër e re estetike e veprës së tij, duke e ngritur atë në një shkallë më të lartë stilistikisht. Temën e qëndresës në këto vepra e shtrin dhe modifikon në konditat e kohërave më të reja të bashkëkohësisë, duke nxjerrë mikrotëmën e ndjekjes dhe të persekutimit të genies shqiptare nga pushteti në plan të parë, sipas përjetimit të vet personal të ndjekjes dhe persekutimit. Është shumë e kuptueshme pse autori në këtë fazë e përshndërron temën e qëndresës, shpesh duke dalë nga fati kolektiv i popullit në temën e qëndresës individuale, sepse faktografia rrëfimore, si faksion i mbaruar, tani, në konditat e bashkëkohësisë, ndjen nevojën të krijojë fiksione personazhesh me ngjarje, drama dhe ngjyrimë shpesh pezhorative. Stili i shkrimtarit tani mbart karakteristikat e një rrëfimi të ri, ndaj edhe gjithë proza e tij, tregimet, novelat dhe romanet, sikur paraqesin një orientim tjetër të autorit, që shpie kah moderniteti.

Murat Isaku, në letrat shqipe në Maqedoni, do të mbetet krijuesi i parë i mirëfilltë shqiptar, nismëtar i poezisë dhe romanit shqiptar te ne. Nëse e shohim ndaras nga pjesa tjetër, vepra e tij letrare qëndron në krye të kësaj pjese të letërsisë sonë. Ajo i sfidon të gjitha të arriturat tona, duke vazhduar të jetë në krye të herave si prozë, por edhe si poezi, duke e bërë autorin një ndër krijuesit tanë më të lexuar. Duke qenë pjesë integrale e letërsisë shqipe në përgjithësi, vepra letrare e autorit vazhdon të jetë në krye të prezantimeve gjithandej nëpër antologjitë dhe botimet tona, por edhe në prezantimet në gjuhë të huaja. Sa për kuriozitet të opinionit, le të më lejohet t’ua përkujtoj një prezantim timin të autorit tonë, Murat Isaku, në gjuhën japoneze, që gjendet në Antologjinë e tregimit të Maqedonisë në Japoni, në vitin e largët 1981, nga përkthyesi i njohur J. Tanaka.

*Kur historia gjykohet me syzet e ideologjisë*

# A ISHTE BOGDANI ANTISEMIT!?



**Të marrësh kategori moderne dhe postmoderne si “antisemitizmi”, “homofobia”, “multikulturalizmi” e t’i trajtosh në shekullin XVII është jo vetëm metodologjikisht e gabuar, por propagandë e thellë ideologjike. Madje është ideale për gjueti shtrigash!**

**Albert BIKAJ**

Rrjetet sociale e kanë “demokratizuar” dimensionin e medias, e kanë ndryshuar mënyrën e komunikimit, qarkullimit dhe pasqyrimin të [dez]informacioneve dhe ideve. Njëkohësisht edhe e kanë polarizuar. Pasi praktikisht, si i dituri, i padituri apo gjysmë i dituri, mund të ketë qasje në Facebook dhe të lexojë, të shkruajë çfarë t’i ketë qejfi. E po që se ndokush synon aktivizmin politik, kjo formë mediatike është ideale për të përhapur narrativin e preferuar. Sidomos kur audienca është interaktive, krijon ndjesinë e analistit, kritikut shoqëror, bile edhe personazhit publik. Nga ana tjetër, rrjeti është global, të globalizuara janë edhe trendet, qofshin për mirë apo jo. Konkretisht, do të veçoja polarizimin, që realisht është banalizim i dy ideologjive; dy rrymat kryesore, jo domosdoshmërisht monolite, si populizmi dhe uokizmi (en. Wokism – që bazohet në teoritë kritike postkolonialiste dhe aktivizmin social që gjykon historinë anakronikisht). Duke i pasur parasysh të gjitha këto, nuk është çudi të lexosh analiza me prapavija të tilla. Duke filluar nga postimet dualiste (por shumë kreative), ku rryma populiste shfaqet në trajtën e pseudo-historianëve, deri te ato ku thuajse çdo gjë analizohet dhe klasifikohet si fobi, eurocentrizëm, racizëm, fashizëm e ku ta di unë. Kategoria e parë lëvrohet dhe njihet mirë ndër ne (e kam fjalën për pseudo-historianët), ndërsa kategoria e dytë është relativisht rrymë e re, madje shitet si prestigjioze dhe përdoret në qarqe

intelektuale dhe mediatike perëndimore. Kohëve të fundit, edhe ndër ne më ndodh shpesh që të lexoj statuse, artikuj, bile edhe disertacione me qasje të tilla. Kjo është një ndër arsytet pse po shkruaj. Kohë më parë, teksa po hapja Facebook-un, hasa në një status të detajuar ku, ndër të tjera, thuhej se Pjetër Bogdani (1627–1689), Marin Bici (1565–1625) dhe disa personalitete të tjera shqiptare na paskan qenë antisemitë! Autori nuk ishte dokushdo, por i mirë-arsimuar dhe aktivist i së majtës opozitare, të mos i jap emër. Fillimisht u shtanga, pastaj thashë me vete, çudi që nuk e paska vazhduar akuzën më tej? Bogdanin dhe Bicin mund t’i akuzonte fare lehtë edhe për racizëm, seksizëm, homofobi, islamofobi, antiliberalizëm, shovinizëm, radikalizëm të djathtë eurocentrik dhe për kundërshtim të multikulturalizmit. Por kjo do ta bënte krejtësisht absurde argumentin, apo jo? Thua se këta dy klerikë të shekullit XVI, respektivisht XVII, që me mundim të madh ushtronin detyrat e tyre, në luftë për ekzistencë nën represionin osman, na paskan pasur luksin të tejkalojnë paragjykimet e shekujve!? Më vjen keq që shprehëm kështu, por jam i bindur se nuk e kishte aspak gabim George Orwell kur thoshte se vetëm intelektualët mund të besojnë në disa ide absurde. Siç e përmenda më parë, i tillë është rasti me këtë kategori intelektualësh të obsesionuar me teorinë kritike, të bindur se analizat e shkrimeve të vjetra mund të bëhen anakronikisht, pa kontekst, pa metodologji, por thjesht si kritikë sociale, por edhe “virtue signaling”, ose

thjesht oportunist: ndjekje trendesh ideologjike. Për t’iu rikthyer “antisemitizmit”, e cila është goxha akuzë e rëndë, thuajse çdo historian dhe njohës i mirëfilltë i letërsisë e di se përgjatë mesjetës, natyrisht edhe në shekullin XVII, qoftë në shkrimet teologjike, qoftë në polemika, përdorimi i gjuhës së ashpër ndaj paganëve, krishterëve, hebrenjve, myslimanëve apo heretikëve ishte pjesë e diskursit të kohës; varet thjesht nga vendi. Për më tepër, dihet fare mirë se nuk bëhej fjalë për ideologji raciste, por për gjuhë polemike të zakonshme brenda debateve teologjike, pasi ideja e racizmit është e re dhe i takon periudhës moderne. Prandaj, të marrësh kategori moderne dhe postmoderne si “antisemitizmi”, “homofobia”, “multikulturalizmi” e t’i trajtosh në shekullin XVII është jo vetëm metodologjikisht e gabuar, por propagandë e thellë ideologjike. Madje është ideale për gjueti shtrigash! Por çështja është se faktet janë kryeneçe, nuk ndryshojnë. Bogdani, p.sh., ishte prelat i periudhës së barokut, i formuar në mjediset intelektuale katolike të Italisë, ndërsa kryevepra e tij “Çeta e Profetëve” pasqyron gjuhë tipike të diskursit dhe teologjisë së kohës. Nuk e përjashtoj se mund të ketë përdorur shprehje polemike ndaj hebrenjve ose të tjerëve, por kjo s’ka asnjë lidhje me antisemitizmin ideologjik modern, i cili është racor, pra biologjik. Përndryshe, me standardet e tilla, antisemit i bie të jetë edhe Shën Pali dhe apostuj të tjerë që ishte etnikisht hebrej, por edhe elita e kohës në fjalë brenda Europës. Madje, për qarqet intelektuale

në Perëndim edhe mund të trajtohen me nuancë, pasi disa prej tyre ishin të afërt me pushtetin, në kohëra kur përndjekjet e hebrenjve nuk ishin të rralla. Sidoqoftë, gjyqet e tilla anakronike më kujtojnë një ngjarje të kobshme të historisë: gjykimi famëkeq i Papa Formozit (816 – 896), të cilin kundërshtarët e zhvarrosën, gjykuan për diçka që nuk ishte fajtor dhe më pas ia përdhosën trupin. Prandaj, në kontekstin tonë paramodern-ballkanas është absurde të mendohet një gjë e tillë, pasi kleri katolik shqiptar nën Perandorinë Osmane jo vetëm që nuk kishte pushtet, por shpesh përndiqej dhe i mohoheshin liritë minimale. Për më tepër, dihet se Bodganit iu dhunua varri dhe iu përdhos trupi nga osmanët, ndërsa tani po tentohet t’i përdhosen edhe emri. Prandaj, “analizat” e tilla shabllonike nuk janë thjesht lajthitje absurde statusesh polarizuese në rrjetet sociale, por përbaltesje figure, shtrembërim faktesh dhe instrumentalizim i historisë për hir të qëllimeve ideologjike, duke e kthyer atë në mjet propagandistik, njësoj si në regjimet totalitare. Mbi këtë strategji ishte i ndërgjegjshëm shkrimtari i madh çek Milan Kundera, i cili paralajmëronte te romani i tij “Libri i së qeshurës dhe harresës” se për të likuiduar një popull fillimisht i duhet fshirë kujtesa për t’u zëvendësuar me libra të rinj, kulturë të re, histori të re. Kështu, së shpejti ky komb do të fillojë të harrojë se çfarë është dhe çfarë ka qenë. Ky mund të mos ketë qenë qëllimi i akuzuesit të Bogdanit, por [keq] interpretimet e tilla në rrugë të tilla shpien.

Qasje

# DIALEKTI SI STIL

Erget G CENOLLI

Në leksionet e mbajtura në disa universitete të SHBA-ve në vitin 1960, Italo Kalvino, duke folur për Neo-realizmin Italian, përmendi edhe një sërë shkrimtarësh, si: Karlo Emilio Gada, Pier Paolo Pazolini e deri tek Alberto Moravia, të cilët në veprat e veta “dialektin e përdorin si një mjet të veçantë shprehës, me gjithë pasurinë e një ndjeshmërie të përkryer formale.”

Më poshtë vazhdon: “Pazolini i shkruan romanet e tij në dialekt ose më mirë të themi në zhargonin e lumpenproletariatit të periferisë së Romës...”

“Gjuha e Gadës është një kullë Babilonie, ose më mirë të them, shtresëzimi i të gjitha dialekteve (përmbi të gjitha ai milanez e roman)...”

“Dhe romancieri ynë më i famshëm, Alberto Moravia, gjendet tani në këtë udhë të kërkimit dialektor. Në “Rrëfimet romane” si edhe në romanin e tij të fundit “Çoçarja”, gjuha e Moravisë ndjek me fare pak ndreqje grafike, të folurën dialektore romane”.

(Citimet e mësipërme janë marrë nga libri “Ese dhe shkrime të tjera kritike” Tiranë, 1986, pikërisht nga shkrimi i lltalo Kalvinos “Tri drejtime në romanin e sotëm



Italian”, përkthyer nga origjinali nga Piro Misha).

Duke lexuar këto citime mundohem të heq një paralele mes asaj letërsie dhe letërsisë shqipe pas viteve ‘90-të kur u

thyen prangat e standardit socialist dhe një sërë shkrimtarësh filluan të shkruanin në dialekt, sidomos në atë gegë. Nëse të shkruarit në dialekt nuk do të ishte ndaluar, sidomos pas ‘72-shit, do të

kishim një letërsi më të larmishme, më pranë letërsisë europiane.

Dialekti është një minierë e artë gjuhësore ku shkrimtari mund të gjejë perla me të cilat të selitë stilin vetjak. P.sh. duke lexuar përmbledhjen poetike të Ledia Dushit “N’nji fije t’thellë gjaku”, po përpiqem të përfytyroj: A do të kishte këtë elegancë dhe aromë gruaje; këtë thellësi përshkrimi; këtë ujëvarë metaforash; këtë harmoni tingullore kjo poezi nëse do të shkruhej në standard? Kurrsesi.

Për ta mbyllur po sjell një poezi nga ky vëllim, duke theksuar se studiuesit e letërsisë duhet ta kthejnë më tepër vëmendjen kah letërsia me dialekt, ashtu si Kalvino në kohën e vet:

\*\*\*

kisha dashtë  
vijën e purpurt  
t’qiellit  
me e kalue nëpër fyt  
e ma n’zemër  
e ma n’krye  
me i pështjellue  
ujnat e përshkënditun  
t’kupës yjelëshue  
për ata që gjallojnë  
(prej) heshtjeje  
ditët janë  
aromash e trishtimi

## Shënime letrare

# "FËMIJË TË JESH...", KËNDVËSHTRIME TË POETIT IBRAHIM KADRIU

**Temat e trajtuara lidhen ngushtë me jetën e përditshme të një gjyshi, me detaje përkujdesjeje për nipat dhe mbesat**

Xhahid BUSHATI

“Fëmijë të jesh” (autori: Ibrahim Kadriu, redaktor: Xhevat Syla, ilustrimet: Uran Bahtijari, Sh. B. “FAIK KONICA” Prishtinë, 2020) është një vëllim për fëmijë, i konceptuar si një marrëdhënie dashurie gjysh-nip, mbesë; duke ruajtur të gjallë fëmijërinë, ndërsa i strukturuar dhe i kompozuar në këto cikle: - Me nipat e mbesat.; - Dhemb shpina pa vitamina.; - Kolla e keqe ajo dreqe.; - Çka kam pa’ e çka kam ndi’.; - Dhia në ballkon.; - Kur vjen dita.

Përmes çdo poezie, autori fal ngrohtësi gjyshi, humor, i cili shëtit në realitete të përditshme, në mjedise fëmijërore e familje e më gjerë. Në këto aspekte të paraqitura plot emocion personazhe janë nipat e mbesat e shtrenjtë të gjyshit-shkrimtar. Është një gjuhë fëmijërie, me të cilët komunikon dhe rrëfen, falë vëzhgimeve dhe përvojave të tij, si dhe cilësimit të detajeve poetikë e jetësorë të gjetura, të cilat flasin në rrugëtimin e prindërimit.

Cikli i parë poetik “Me nipat e mbesat” është zemra e librit. Përbën një himn dashurie deri në adhurim e shenjtëri për gjeneratën më të re: nipat dhe mbesat e poetit. Në vargjet e poezisë rrëfehen: zënka, lodra, pyetje pa fund, kujdesi prej gjyshi, etj. E gjitha përshkruhet e përçohet me një dashuri të thellë me një ton prindëror. Gjuha, figuracioni letrar, ka ngjyrë të ngrohtë, ndjeshmëri dhe ritëm të shpejtë që ndjek energjinë dhe vrullin e fëmijëve. Tematikisht kemi përballje brezash. Ky brez i ardhur në jetë gjyshit-poet i ndreq mëngjesin, e përqafon, po në shtëpi nuk i pëlqejnë orët, s’duan ta bëjnë gjumin me orar... etj., etj. Spikat portreti detajues i Lirit, Elisës, Jonës, Norikut. Janë portrete plot magji që falin magji moshe, me detaje reale jetësore, dhe... varg pas vargu poeti Kadriu pikturon plot ngjyra



fëmijërinë e tyre reale.

Ndërsa cikli i dytë poetik “Dhemb shpina pa vitamina”, nis me poezinë “Lumi”, ku udhëtimi i tij është një paralelizëm me udhëtimin e jetës. Shquhet për figuracion të larmishëm dhe për një ndërtim kompozicional metaforik e metrik. Poeti paraqet një vitrinë poetike për vlerat e vitaminave, këshilla, kujdesje e përkujdesje vetjake... etj. E, ato janë: vitamina: A, B6, B9, C, D, B12, E, K; të cilat i gjejmë te pemët, perimet, frutat, kërpudhat, hudhra, kastravec, karrota e kamomili. Këto të fundit nga pikëpamja poetike janë shpirtëzuar përmes një komunikimi të qartë e të vlefshëm për të rriturit e për fëmijët. Pra, kemi edhe një përzierje të një humori me dhimbshurinë për vështirësitë e moshës së tretë, të cilat, këto poezi, japin edhe një moment reflektues. Kurse cikli «Kolla e keqe, ajo dreqe», sjellin një përballje tipike me shqetësime të përditshme, si: gripi, kolla, e ftohura, por të trajtuara me një sens optimizmi dhe gëzueshmërie. ‘Kolla’

është personazhi ‘ajo dreqe’ që nuk i lë as të flenë fëmijët, dhe ato gjejnë mënyra të çuditshme për t’i shpëtuar asaj: - që nga çajrat e tek shumë ide gati sa magjike aq fëminore. Kujdesi për shëndetin është i trajtuar jo në mënyrë predikuese, por argëtuese.

Cikli i katërt “Çka kam pa’ e çka kam ndi’ është një përmbledhje vëzhgimesh dhe përvojash jetësore që gjyshi-poet ua përcjell fëmijëve. Shpesh, temat e trajtuara kanë të bëjnë me ndodhi të hershme, me përvojat nga lufta, varfëria, jeta në fshat, ardhja e teknologjive të reja... dhe të kohëve të reja që ndryshojnë e do të ndryshojnë përherë... Ndonëse vargjet janë, shpesh, nostalgjikë, ata janë të mbështjella me një ton dashurie dhe përmallimi, të cilat janë larg patetikës. Është një rrëfim përmes letërsisë gojore, ku funksioni edukativ, kujtesor ndërton ura përmes breznive.

Cikli i pestë “Dhia në ballkon”, mbase është një nga ciklet më humoristikë të librit. Titulli, ndonëse është paradoks,

por e fton lexuesin për të njohur situata të jashtëzakonshme në një kontekst të zakonshëm. Dhia - simbol fshati - vendoset në kontekst qyteti, në ballkon. Kemi realizimin e situatave absurde dhe të pazakonta, duke ballafaquar fshatin me qytetin në një mjedis humoristik. Urbanizimi, ndërrimi i realiteteve, nostalgjia për fshatin, marrëdhëniet e reja me natyrën...etj., janë disa dukuri që i gjejmë në këtë cikël interesant.

Cikli i fundit është “Kur vjen dita”. Të gjitha motiveve, poeti u fal dritë. Ndryshe nga ciklet e tjera, kanë përparësi nuancat filozofike. Nuk është drita e një dite, por edhe drita e historisë, por edhe portreti i mixhës së lagjes, misioni i bletës punëtore, të Mal Balës që punon pa hile, të Lezes që dërgon pikturat e me motive të vendlindjes mërgimtarëve, për famën e Cen Kaçelit dhe fabulën e xixëllonjës që drita e saj magjike i bën fëmijët të luajnë lirshëm dhe pa frikë..., etj. Autori na përgatit e na rrëfen për rëndësinë e të sotmes, por edhe të përballemi e të triumfojnë lidhur me problemet e së nesërmes të gjeneratës së re që rritet dita-ditës, për të cilët dashuria dhe përkujdesja duhet të jetë maksimale.

Po cili është kumti poetik i shkrimtarit Ibrahim Kadriu? Temat e trajtuara lidhen ngushtë me jetën e përditshme të një gjyshi, me detaje përkujdesjeje për nipat dhe mbesat, kujdesi për shëndetin, lojën apo ndodhitë e thjeshta, por të ngarkuara emocionalisht. Gjuha është ajo e bisedës. Shprehjet e përdorura janë, shpesh, nga gjuha e përditshme, plot thagma, batuta e frazeologji që e bëjnë poezinë të ndjehet si bisedë e zakonshme: në mjedisin familjar, të oborrit, lagjes, fshatit e e qytetit... etj. Një libër që të mëson për plakjen dhe jetën, për kalimin e kohës dhe vlerën e jetës familjare.

(Shkodër, fund–gusht, 2025)

Mbresa

# MËRKUNA E ZEZË OSE GRATË NUK I TUTEN ASPAK HERKULËVE

**Mërkuna e zezë është ndoshta romani i parë në letërsinë shqipe ku gratë ndjehen po aq të pushtetshme sa burrat**

**Rezart PALLUQI**

Mërkuna e zezë është romani i parë që unë lexoj prej shkrimtarit të mirënjohur, Agron Tufa. M’u duk e padrejtë dhe e papranueshme që deri më sot nuk pata marrë mundin të lexoj qoftë edhe një roman të tij. Në rrafshin gjuhësor ndesha atë që pata pritur më parë. Tufa është një mjeshtër i gjuhës shqipe, qoftë asaj toske, e pak më shumë asaj gege. Çdo fjali është e pasur me figuracione origjinale, përshkrime të mrekullueshme të peizazheve natyrore që veriu shqiptar dhe katundi ku edhe luhet romani i ka me bollëk. Gjuha e përdorur është e ngrohtë, përçon njerëzillëk/familjaritet të thellë, e të bën të kujtosh Dostojevskin, i cili diti të ndërthurte dhimbjen njerëzore në një tezgjia magjike gjuhësore.

Gjithçka përreth qe zbardhur: binte një borë e pjerrët me fjolla të spërdredhura, të dendura, të njëtrajtshme. Qe buzëmuzg. Ndjeva të ftohtë, andaj u pështolla rishmi, si munda, me mushamanë e zezë. Tashmë vareshim tatëpjetë një kodre, përfund së cilës gjendej një urë: përnën të, nën rrokullimë gurësh, vraponin ujërat kafe-vjollcë të një përroi të madh, të shoqëruara me një tis të lehtë avullime.

S’di pse këto ujëra, ç’prej fëmijërisë së hershme – sa herë që udhëtoja me mamën në kohë shiu - më dukeshin si groshë e zier, sikur, diku nga majëmalet, dikush të kishte zier groshë (për lëmoshë): mandej, kjo groshë e trashë vraponte teposhtë të shuante urinë e fusharakëve.

Dëbora dhe hakmarrja janë dy prej fenomeneve që dominojnë romanin. Ajo luan këtu një rol të dyfishtë. Jo vetëm ia rëndon jetën banorëve të katundit malor, por edhe zgjat kohë-qëndrimin e Gurit, personazhit kryesor të romanit. Bora, që nuk resht së rëni gjatë gjithë kohës në të cilën shtjellohet romani, metaforizon edhe ashpërsinë e jetës në këtë katund, i cili vuan prej një mallkimi të përhershëm. “Kush është kjo frymë, gjyshe?”

“Thashë gjë për frymë?, - u çudit ajo.

“...Një lloj Fryme hakmarrëse, the. Hakmarrëse për çfarë?”

“Nuk e di bir, po mendoj se një ters i madh ka zënë rrënjë në këtë katund”.

\*\*\*

“Nuk mund të të them më shumë. Ti duhet sa më parë të shëndoshesh, të paktën aq sa për të përballuar rrugën. Ti nuk e di që vetëm katundi ynë është shpëputur nga bota. Vetëm katundin tonë e ka ngujuar bora. Mos mendo se kjo është e rastit”.

Edhe pse novela shpaloset në një rrafsh të shkurtër kohor, rreth një muaj, e kaluara luan një ndikim të fuqishëm mbi jetën e përditshme dhe fatin e banorëve të katundit. E kaluara këtu zëvendëson të ardhmen, e cila i paraprin, i zë pritë asaj. Në roman fenomeni kohor përmendet dy herë, festat e nëntorit, si dhe 24 dhjetor, dita e mërkunës së zezë. Tufa shpërfaq rivalitetin midis besimit pagan dhe atij të Krishterë, ku në vend të Krishtit, lindin gratë e çliruara prej burrave të tyre dhunues.

“Si nuk e kupton? Ato janë shtriga! Ato thirrën ardhjen e Natës së Mërkurë! Shihe, këtë shi do ta ndajë dëbora. Për këtë i hodhën veglat e punëdorës në pus. Ata i lutën Natës së Mërkurë. Po t’i shohësh sepetet e tyre janë përplot vegla punëdoreje, përplot kukulla, përplot leshra grash e delesh të zeza. Afron e Mërkura e



Zezë. I takon të bjerë më 24 dhjetor”.

“Më duket se e ekzagjeron. Me sa di unë, kjo datë përkon me Krishtlindjet”.

“S’ka rëndësi! E Mërkura e Zezë është shpirti i përjetshëm i femrave që ngrihet kundër kësaj feste.

Struktura e romanit është lineare, me nënkapituj të shkurtër që rrjedhin shpejt. Në roman ndeshim skena të bukura dashurie, të cilat Tufa na i sjell krejt natyrshëm, duke filluar nga flirtimet e personazhit kryesor, Gurit, pesëmbëdhjetëvjeçarit të vetëm në katund, ende të virgjër, i cili ashtu si çdo mashkull, është në kërkim të dashurisë së parë. Gjuha seksuale që Tufa përdor është e zjarrtë, e drejtpërdrejtë, çka edhe shpreh ndjenjat e fuqishme seksuale të çdo djali të virgjër. Guri kryen seks me kushërirën e tij, e këtu, sipas mendimit tim, thyhet një tabu letrare, ngaqë ky fenomen është i pranishëm në familjen shqiptare e më gjerë në Ballkan, veçse këtë e ndeshim rrallë në letërsinë shqipe.

“Hë pra!”, - tha ajo me padurim.

I peshova me të dyja pëllëmbët mes dy kodrave. Ajo shkrydhi qafën e gjatë me rënkime kënaqësie, duke m’i kapur pëllëmbët me dy duart e saj e duke m’i vënë sipër kodërzave.

“Pesho! Fort e më fort!”, - urdhëroi ajo.

Koka më digjte si mangall me prush,

ndërsa duart dridheshin. Pëllëmbët e mia peshuan sipër kodrave të buta, ndërsa ajo mes rënkimesh të ëmbla kërkoi me duar në tahmin dhe ndeshi me sendin e fortë në pantallonat e mia.

E përfshiu dhe e fërkoi, mandej e pa: fytyra ime lulëkuqe nuk dinte ku të fshihej. Ajo ma mori dorën time të bindur dhe ma rrsi thellë, poshtë llastikut të mbathjeve, duke e fërkuar pas një territori të leshtë e të butë. Me dorën tjetër mbi zverk, ajo më rrëzoi ngadalë mbi kodrat e veta e, mandej, buzët e saj u puqën e gllabëruan gjatë të miat. Ndjeva gjuhën e saj të lëngshme që depërtoi në gojën time, e më pas, duart e saj që më hoqën pantallonat.

Tufa arrin me mjeshtëri, që nëpërmjet një romani të shkurtër, format novele, të shpalose një histori mijëra vjeçare, e cila mbart mbi kurriz një peshë të madhe dhe të ndërlikuar: gra të dhunuara që hakmerren po aq me pamëshirë ndaj burrave dhunues, duke mos kursyer edhe dy burrat e fundit në fshat, axhën dhe personazhin kryesor, Gurin, çka e bën këtë libër të veçantë të paktën në llojin e tij, ku gratë, të cilat duke qenë të pafuqishme ndaj pushtetit gati-gati absolut dhe të përjetshëm të burrave, përdorin fuqitë mbinatyrore, hyjneshën e tyre, Mërkunën, vetëm e vetëm që ato të

marrin rolin që ato meritojnë në familje, shoqëri e më gjerë.

Gjyshja më dha leje të dilja nëpër fis, përndryshe do të bëhesha derr nga mërzia. Ajo tha se në gjithë katundin gjeje a nuk gjeje dy, tre a katër vërsnikë, po dhe ata kishin mbetur në konviktet e qytetit. Madje dhe burrat, po të mos vije në hesap pleqtë e vjetër, bëheshin a s’bëheshin aq. Por sidoqoftë, kishte çupa të moshës sime, me të cilat mund të luanim në gjithëfarë lojërash zbavitëse.

“Po ku janë burrat, pse ka aq pakë meshkuj?”, - pyeta gjyshen i habitur.

“Ka kohë që në katundin tonë bëjnë vaki gjëra të çuditshme që s’t’i rrok mendja”, - tha.

“Burrat, pa mbushur moshën tënde, sikur i tërheq dikush, sikur i ndjell diç e panjohur, sikur i përndjek një lloj Fryme hakmarrëse... Ikin të gjithë: në shkolla, punë të ndryshme zanati, ushtri. Dhe në kthefshin, nuk rrinë më shumë se një javë. Befas u zverdhet jeta këtu dhe largohen...”,

- vazhdoi ajo, por unë e ndërpreva:

“Kush është kjo frymë, gjyshe?”

“Thashë gjë për frymë?, - u çudit ajo.

“...Një lloj Fryme hakmarrëse, the. Hakmarrëse për çfarë?”

“Nuk e di bir, po mendoj se një ters i madh ka zënë rrënjë në këtë katund”.

“Cilat janë gjëra të çuditshme që s’t’i rrok mendja?”

“Lloj-lloj... s’di ç’të them...”, - mërmëriti ajo duke mbushur koshat me jonxhë të thatë.

“Këtu burrat ftohen shpejt prej grave të veta.

Mërkuna e zezë është ndoshta romani i parë në letërsinë shqipe ku gratë ndjehen po aq të pushtetshme sa burrat. Ky roman mund të shërbejë si një burim frymëzimi për ndërgjegjësimin e femrës në familje dhe në të gjitha sferat e shoqërisë, duke braktisur kështu njëherë e përgjithmonë pozicionin “viktimë” ose “vetëviktimizues”.

Krejt ndryshe nga mentaliteti i Krishterë, këtu, gratë i përgjigjen plumbit me plumb. Sidoqoftë, mbyllja e romanit e ndryshon raportin bardhë e zi- përballjen fatale të dy ushtrive gjinore-burrë-grua, ngaqë Guri mbrohet prej Fatushës. Kjo e fundit, nuk i bashkohet Mërkunës, por mbron Gurin, çka edhe sjell nuancën e domosdoshme artistike si dhe mirëkuptimin dhe bashkëpunimin e domosdoshëm që duhet të ndërtohet midis gjinisë burrë-grua. Këtë e vërejmë edhe te gjyshi dhe gjyshja e Gurit, të cilët tregojnë pjekuri, maturi duke qëndruar larg Mërkunës së Zezë, një lloj akti ky refuzues, çka edhe nënkupton se pagja vjen kryesisht prej mirëkuptimit, mëshirës dhe faljes së mëkatit dhe jo hakmarrrjes së përjetshme.

Në mbyllje, magjet e bukës këtu janë plot. Nuk ndeshim asnjë konflikt politik, po ashtu asnjë krizë ekonomike. Kjo na dëshmon edhe një herë se bota emocionale, respekti, dashuria e ndërmjetme, luajnë një rol shumë më të madh se mirëgenia, plaçka, ndaj, parë në këtë prizëm, ky roman mund të shërbejë si një kushttrim ndaj njeriut modern, i cili vrapon si i verbër ndaj pasurimit materialist dhe anashkalon nevojat e tij emocionale, duke rrëshqitur drejt vetmisë, e një sferë të tillë nuk e hasim tek familja e kryepersonazhit Guri, sepse atje jeta brendafamiljare gëlon energji, ëndrra dhe dashuri të ndërsjellët.


## Interpretime

# ROMANI QË S’KA NEVOJË PËR NJË FUND

**(Pasthënie e veprës “Kështjella” të Franz Kafkës, botoi Shtëpia botuese DUDAJ, Tiranë, 2012)**

**Ardian KLOSI**

Më 27 janar të vitit 1922 Franz Kafka shkon, së bashku me doktorin që e kuron për sëmundjen e tuberkulozit, e cila i është shfaqur qysh më 1917, në Spindelmühle në masivin malor midis Çekisë dhe Polonisë. Prej shtatorit 1920 nuk është marrë më me krijimtari letrare, tani që në ditët e para të vendosjes në hotelin Krone fillon të shkruajë një roman të ri, të tretin në radhë pas “I humburi” (Amerika) dhe “Procesi”. Spindelmühle është sikurse fshati i “Kështjellës” i mbuluar me dëborë, por për të tjerat ky vend i zhvilluar turistik pak i ngjan fshatit të humbur, të mbyllur e arkaik të romanit. Pas një qëndrimi tri-javor Kafka kthehet në Pragë dhe kërkon zgjatje të lejes nga Shoqëria e sigurimeve të aksidenteve në punë, e më pas, duke qenë që shëndeti vazhdon të përkeqësohet, dalje në pension të parakohshëm. Nga 23 qershori deri më 18 shtator shkrimtari qëndron tek e motra Ottila në qytetin e vogël Planá të Bohemisë, ku vazhdon punën intensive me romanin, të cilën megjithatë e ndërpret aty nga fundi i muajit gusht. Në një letër të fillimit të shtatorit i shkruan mikut të tij Max Brod: “m’u desh ta ndërpres me sa duket përgjithmonë historinë e kështjellës, nuk isha më në gjendje ta rifilloja prej “krizës” që nisi një javë përpa-ra udhëtimit për në Pragë, megjithëse pjesa e shkruar në Planá nuk është dhe aq e keqe sa ajo që e njuh ti”. Ndër tri romanet që la dorëshkrim Kafka, “Kështjella” është më i gjati. Romani u botua më 1926, por jo në tërësinë e tij, pasi Max Brodi duke dashur “të japë përshlytjen e një vepre të plotë”, e ndërpriste historinë aty ku Frida e lë përfundimisht K.-në - pra në këtë botim mungonin episodet e Byrgelit, të shpërndarjes së dosjeve, biseda mes Pepit e K-së etj.. Më 1951, në botimin e tretë, Brodi e jep veprën të plotë, duke pas ndërhyrë vetëm në disa fjalë dialektore ose të vjetuara e në çështje të pikësimit. Vetëm më 1982 me daljen e botimit të plotë kritik të veprës së Kafkës (dorëshkrimi i “Kështjellës”, 6 fletore të formatit kuart, ruhet bashkë me të tjera dorëshkrime të Kafkës në Bodleian Library të Oxfordit), u bë i mundur edhe një riprodhim i saktë i “Kështjellës” që respektonte deri dhe pikësimin e autorit e sido-mos ndarjen e mbititullimin ose numërimit e kapitujve përbërës. Natyrisht nuk jepeshin pjesët të cilave autori u kishte hequr vizë; kështu p.sh. ka qenë i ndryshëm fillimi, vepra nga kapitulli 1-3 ishte nisur në vetën e parë etj.. Përkthimi shqip mbështetet mbi variantin përfundimtar që del prej botimit kritik të origjinalit. Janë të shumta interpretimet që i janë bërë “Kështjellës” nga këndvështrime letrare, psikologjike, psikanalitike, teologjike, hebraike etj., po kaq të shumta edhe alegoritë e simbolet që i mvishen figurës së Kështjellës. Nuk do të sjellim këtu shembuj prej tyre, pasi dhe nuk ka ndonjë vlerë ta ngarkosh lexuesin me to. Por le të më lejohet nënvizimi i disa momenteve siç e kam parë dhe ndier “Kështjellën” në muajt e bukur po edhe të tendosur të shqipërimit të saj: **MITI I SHKRIMTARIT:** Kështjella është një organizëm i epërm që ka në dorë fatet e njeriut. Ndërtimi i saj në pamje të jashtme është burokratik, por në të vërtetë së brendshmi është mitologjik. Sa më shumë që i afrohet K.-ja, aq më e paarritshme duket ajo; edhe kur kemi përshlytjen se kemi njohur një radhë zyrash, marrim vesh se këto janë vetëm “zyrat e përparme”, se pas tyre ka të tjera zyra më të thella, ose zyra kontrolli. Kështu del që struktura e Kështjellës është e pafundme, në fillim na thuhet se ajo i takon njëfarë konti Westwest, por ky pastaj humbet sa



më shumë që hyjmë në brendësi të mitit. Megjithëse tundimi është i fortë, është e kotë të kërkoen paralele biblike ose hebraike me Kështjellën, pasi paralelet gjithmonë do të ngecin ose thyhen në origjinalitetin e veprës. Edhe vetë veprimet burokratike që shtrihen në gjithë indin e Kështjellës i përjashtojnë këto paralele. Duket ka të drejtë studiuesi Rainer Stach që e quan Kështjellën një mit privat të Kafkës: «Komponentët e mitit janë... imazhe dhe metafora... që krijojnë së bashku një tërësi imagjinare dhe logjike. Imazhet shumohen në variacione shumëfishe, ato vargëzohen me njëritjetrin duke krijuar... një pëlthurë me sythe të imta që rritet e rritet: një mit privat. Në qendër të kësaj pëlthure është siguria që ekzistojnë fuqi të cilat kanë në dorë fatin e çdokujt” (Kafka, Die Jahre der Erkenntnis, Frankfurt a.M. 2008, £ 480). **LUHATJA DHE MISTERI:** Një tjetër veti e Kështjellës është papërcaktueshmëria e saj, misteri që e mbështjell. Në fillim ngjan sikur brenda saj gjithçka funksionon në mënyrë të përkryer -asnjë i huaj nuk mund ta kalojë natën në fshat pa miratimin e autoriteteve; ose shpjegimi i gjatë i kryeplakut mbi mundësinë tepër të rrallë të një gabimi. Mirëpo qysh në komunikimin në telefon, në krye të librit, ose edhe në pamundësinë e kryeplakut për të gjetur një x dosje, shohim se konstrukti është me shumë të çara, me shumë kundërtënie. Edhe një figurë qendrore sikur-se Klami është krejt e papërcaktuar: “thonë se ai ka pamje tjetër kur vjen në fshat dhe tjetër kur ikën nga fshati, tjetër pamje para se ta ketë pirë një birrë e tjetër pas kësaj, tjetër pamje kur zgjohet e tjetër ku fle, tjetër i vetëm e tjetër në bisedim” (në çekisht fjala klam do të thotë mashtrim, shajni). Ky Klam i dërgon papritur një letër absurde K.-së, në të cilën e lëvdon për punët e tij matë-se si gjeometër. **MUNGESA E DHUNËS:** Kështjella vendos mbi fatet e njerëzve, po këtë nuk e bën duke ushtruar ndonjë forcë apo përmes ndonjë aparati dhune; K.-ja disa herë refuzon t’u bindet autoriteteve dhe këta nuk e detyrojnë dot që t’u bindet; vetëm se stigma ose tëhuajtja që pëson njeriu kur nuk i bindet Kështjellës, është e pamëshirshme. Këtë e tregon më së miri fati i familjes së Barna-basit që izohohet dhe degradon deri në minimumin e ekzistencës pa kurrfarë veprimi të jashtëm të Kështjellës, e cila

mallkimin mbi këtë familje e ka shqiptuar veç në rrugë misterioze. **VETËLËVIZJA:** Kështjella, si aparat i stërmadh, duket sikur merret me administrimin e çështjeve të fshatit. Mirëpo këto do të ishin shumë pak për të përligjur ekzistencën e gjigantit; në skena të veçanta si për shembull veprimi te zyrat e përparme ose shpërndarja e dosjeve herët në mëngjes në Oborrin e zotërinjve shohim se Kështjella ka një moment vetëlëvizjeje e vetëfunksio-nimi, gati të pavarur nga fatet e personave të ndryshëm që janë regjistruar nëpër protokollat: protokollat fillojnë e bëjnë një jetë të mëvetshme. Edhe kjo përforcon përfytyrimin e Kështjellës si një mit i pavarur nga bota reale. **NË PËLHURË ËNDRRASH:** Në shumë pjesë të tij romani ecën nëpër struktura ëndrrash: K.-ja vë re se pas ndjesisë së tij s’kanë kaluar as dy orë nga mëngjesi, megjithatë është errur; errësira, dimri dhe dëbora mbretërojnë gjatë gjithë romanit; ose të vihet re se si çdokush në çdo çast ka marrë dijeni për veprimet e K-së, sikur këto t’i thoshte dikush publikisht në mes të fshatit; ose se si njëri nga ndihmësit, Jeremiasi, brenda një dite është plakur (“ishte më i moshuar, më i lodhur, më me rrudha”). Ndaj dhe dy ëndrrat që sheh K.-ja gjatë monologut të Byrgelit na duken si ëndrra në mes ëndrrash. Ndërtime surreale janë një numër skenash si larja e burrave në shtëpinë e Lazemanit, dëbimi i shërbëtorëve me kamxhik nga Frida, veprimi në zyrat e përparme të Kështjellës, shpërndarja e dosjeve të Oborri i zotërinjve etj.. **TË SHKRUARIT SI FORCË EPRORE:** E lidhur ngushtë me të mësipërmen, është mënyra se si e kupton ose e përjeton Kafka të shkrua-rin: ai është për të një akt çlirimi, një jetë e dytë që e shpërblen për gjithë mundimet dhe zhgënjimet e jetës reale, një jetë që jo doemos ka të bëjë me të parën (kjo bën të dështojë shumica e interpretimeve alegorike apo simbolike që i mvishen veprës së tij). Kafka shpreson se vetëm krijimi letrar do mund ta shpëtojë prej shembjes përfundimtare fizike, siç i shkruan mikut të tij doktorit Klopstock atë dimër. Ja si e përshkruan shkrimtari tera-pinë që do të thotë për të krijimtaria në një letër drejtuar Max Brodit më 27 janar 1922, pra ditën e mbërritjes në fshatin Spindelmühle: “Ngushëllimi i çuditshëm i të shkruarit, misterioz, ndoshta i rrezikshëm, ndoshta shpëtues: Kërcimi përtej

radhës vrasje - vëzhgim, vrasje - vëzhgim, duke krijuar një lloj më të lartë vëzhgimi, më të lartë por jo më të mprehtë dhe sa më lart që ngjitet, sa më e pambërritshme që është nga “radha” aq më i pavarur bëhet, aq më shumë ndjek ligje të veta të lëvizjes, aq më e paparashikueshme, e gëzueshme, ngjitëse është rruga e tij.» Kurse në një letër tjetër drejtuar po Brodit më 12 korrik të atij viti, Kafka i njuh të shkruarit atributin e shtëpisë, vatrës, strehës, që jepen të gjitha nga fjala gjermane «zuhause”: “Jam larguar prej shtëpisë dhe më duhet të shkruaj drejt shtëpisë, edhe pse Shtëpia [streha, ngrohtësia] ka kohë që është marrë prej ujërave tej, larg në përjetësi”; mirëpo po këtu të shkruarin e quan “shërbim për djallin” dhe “zbritje te fuqitë e errëta”. **JETA REALE:** Por, megjithëse të shkruarit te Kafka si te çdo shkrimtar i vërtetë, bën një jetë të pavarur, ne nuk mund të rrimë pa diktuar edhe te “Kështjella”, përjetimet, vuajtjet dhe ngushëllimet e njeriut Kafka. Të vihet re se si bien disa nga personazhet e tij qendrore, në radhë të parë K.-ja, në minimumin e ekzistencës, në mjerimin e mjerimit, duke mbetur megjithatë brenda një kornize “reale” (në ndryshim nga personazhe të tjera të prozës kafkiane, si p.sh. nëpunësi-insekt Gregor Samsa te “Shndërrimi”, ose majmuni-njeri te “Letër akademisë” që kapërcejnë përtej kufirit realist). Kështu e zëmë, K.-ja e fillon jetën në fshat me njëfarë statusi: ka të drejtë të ketë një dhomë në Bujtinën e urës, po pastaj prej andej detyrohet të strehohet në një shkollë, të flejë me të dashurën dhe dy ndihmësit e tij në një qosh të improvizuar të një klase, kurse në fund të romanit, duket se pajtohet me ofertën e Pepit për t’u rrasur, fshehurazi, në dhomën e tri shërbyeseve, në shtrëtitë më shumë sesa me shtrëtitë normale ngjajnë me raftet e një dollapi... Edhe qortimet e vazhdueshme që pëson K.-ja në rrugën e tij, gjithë ato të meta, paturpësi, poshtërsi që i vihen në dukje, na kujtojnë lajtmotivin e përhershëm të K.-së, birit të dëbuar, të larguar nga vatra, të tëhuajtur, që gjithmonë duhet ta brejë ndërgjegjia për kushedi çfarë gabimesh, një kompleks që e ka gjetur zbërthimin më të hollësishëm, përveçse te tregimet emblematike “Dënimi” e “Shndërrimi” te Letra e gjatë drejtuar babait. Në botimin e vitit 1951 (Frankfurt a. M., f. 481) Max Brodi dëshmon se sipas fjalëve të Kafkës romani do të përfundonte me vdekjen e K-së në kohën që i vjen lajmi nga Kështjella se ishte miratuar për të leja e qëndrimit. Në këtë mënyrë edhe kjo veper sikurse dhe «Procesi» ose «Shndërrimi» ose «Dënimi» ose «Arti-sti i urisë» etj., do të përfundonte me vdekjen e protagonistit si fund për një makth të pafund. Vetëm se në këtë rast vdekja nuk na duket shumë si mbyllje logjike e zhvillimit të romanit. Ajo që tentohet, ajo që tndon protagonistin nga fillimi në fund është zhbirimi i Kështjellës, afrimi tek ajo, zbulimi i misterit të saj. Mirëpo në vend që të afrohet, ky zbulim largohet gjithmonë e më shumë, gjithmonë e më i pamundshëm duket afrimi i K-së në Kështjellë. Në qoftë se në fillim ai merrte letër të drejtpërdrejt nga Klami, komunikonte me kryeplakun, komunikonte me Fridën, këta në njëfarë mënyrë ishin shumë më pranë Kështjellës sesa personazhet e mëpasshme Barnabasi, Olga, Pepi, Lazemani që janë gjithmonë e më të dobëta, gjithmonë e më të pashpresa ura drejt saj. Në këtë kuptim romani duket sikur as që ka nevojë për një fund pasi fundi është i dhënë në lëvizjet e dy përbërësve kryesorë: Kështjellës, gjithmonë e më shumë drejt misterit, K-së, gjithmonë e më pa shpresë për të hyrë ndonjëherë në të.

Botime të veçanta

# NJË DIALOG PËR SHOQËRINË, POLITIKËN DHE DEMOKRACINË

(Valentina Leskaj: “Politika si ide”, botoi TOENA, Tiranë, 2021)

## Nga Majlinda RAMA

Në rrymën e gjerë të trajtesave mbi sistemet sociale dhe politike në shoqëritë bashkëkohore, meritojnë vëmendje të veçantë shqyrtimet mbi parimet se si funksionon dhe sa qëndrueshmëri ka demokracia dhe fenomenet shoqërore që lidhen me të, siç janë, besimi qytetar, stabiliteti, të drejtat dhe liritë, transparenca, pluralizmi, qeverisja, proceset politike, klasat shoqërore, përfshirja, etj. Një ndër këto kontribute të rëndësishme është edhe libri “Politika si ide”, i intelektualës dhe politikanës, Valentina Leskaj, i cili nxjerrë në dritë aspekte të tjera që pasurojnë qasjet ekzistuese, por edhe sjellin një perspektivë të re, më të veçantë.

### DRITARE E RE MBI KUPTIMIN E POLITIKËS

Ky libër, siç e thekson edhe vetë autorja, përfaqëson një udhëtim reflektues. Titullohet “Politika si ide”, por nuk është vetëm ide, është më tepër se kaq, sepse thellohet dhe analizon çështje tejte thelbësore, mbi lirinë e qenies dhe demokracinë e shoqërive. Hapet me një shprehje të Václav Havel, “Me fjalën demokraci nuk kuptojmë vetëm sistemet, institucionet dhe marrëdhëniet midis tyre, kjo është demokracia teknike, por në radhë të parë ajo është marrëdhënie me botën dhe shoqërinë, mënyrë mendimi, shpirti i jetës publike. Teknologjia e demokracisë është e pakonceptueshme pa kulturën demokratike”, që e zhvendos konceptin e demokracisë përtej mekanizmave formalë institucionalë, duke e përkufizuar atë si një kulturë mendimi dhe shpirt të jetës publike. Me këtë devizë, qysh në hyrje, Leskaj e paralajmëron lexuesin për një dritare të re mbi kuptimin e politikës, në një dimension shumë më të hapur. E njohur për angazhimin aktiv në disa rrafshë, Valentina Leskaj, me këtë botim plotëson profilin e një intelektualje që lëvizë natyrshëm në sferën publike dhe politike dhe ndërton ura komunikimi me një spektër të gjerë (përmes formave të ndryshme të ndërveprimit), ku, ndër më të rëndësishmet, mbetet edhe forma e librit, si medium mendimi dhe dialogu. Gjithë çfarë perceptohet gjatë leximit të librit “Politika si ide”, është reflektimi mbi marrëdhëniet tona në raport me politikën dhe jetën shoqërore, mbi mënyrën se si i kemi kuptuar dhe si duhet t’i rimendojmë gjërat (që shpesh na duken të thjeshta). Ky libër është për ata që kërkojnë të kuptojnë më shumë, që pyesin më shumë dhe që duan të marrin pjesë në mënyrë më të vetëdijshme në hapësirat sociale. Strukturuar në disa pjesë/kapituj të dallueshëm, gjithë libri paraqet një tablo të gjerë të realitetit tonë dhe sjell mendime në mënyrë kritike mbi shumë zhvillime, por edhe më të transformuar). Para se të thellohem në përmbajtjen e librit, dëshiroj të trajtoj një aspekt të rëndësishëm që lidhet me strukturën e tij: Leskaj, e bindur se forma dialoguese e bën tekstin më të drejtpërdrejtë dhe më tërheqës për lexuesin, e shmang rrëfimin klasik autobiografik, i cili mund të kishte rezultuar i ngarkuar ose monoton dhe, në



vend të një kujtese lineare, ajo zgjedh të ndërtojë një dinamikë komunikative, me pyetje-përgjigje, ku zëri i intervistueses (Bardhylit) krijon tensionin e nevojshëm për të thyer rutinën. Kjo strategji narrative, jo vetëm që gjallëron rrëfimin, por edhe e zhvendos leximin nga intima personale tek analiza e përgjithshme, sepse përmes këtij formati ambig (herë rrëfim, herë pyetje), e intervistuar (Leskaj) dominon, bëhet orientuese dhe udhëheqëse për tema të mëdha politiko-shoqërore, tema shpesh të nënvlerësuara, anashkaluara apo keqinterpretuara, që nis nga roli i grave në politikë te grupet e marginalizuara, nga funksionimi i demokracive të brishta te mekanizmat e pushtetit dhe proceset vendimmarrëse në shoqëritë post-totalitare, nga shoqëritë e centralizuara te ushtrimi i së drejtës, sjellja ndaj gjinisë së butë, etj. Një tjetër zgjedhje teknike që e bën leximin tërheqës deri në fund, pa e humbur shkëlqimin, është edhe fragmentarizimi/ ndarja në kapituj, si një mundësi që shmang çoroditjet që sjellin librat voluminozë për tema të cilat, shpesh bëhen burime reference vetëm për një komunitet të caktuar. Që të mos zgjatëm me formën, Valentina Leskaj shpalos me kujdes një sërë çështjesh (siç e përmenda më lart), çështje si ajo e gruas në veçanti, lëvizjet feminist në përgjithësi, të drejtat e njeriut, liria e fjalës, mendimi dhe lëvizja e lirë, humanizmi politik, sfidat e shoqërive civile, sistemet politike, shoqëritë tranzitive, etikën dhe kulturën politike, shoqëritë e centralizuara, krizat demografike, sfidat

e komunikimit publik dhe politik, rolin e gjuhës në shërbim të bashkimit, urrejtjen si sjellje dhe akt dhune (personale dhe kolektive), historitë dhe fatet e vendeve ish-komuniste, etj. Nga të gjitha anët që ta shohësh këtë libër, vihet re se lajtmotivi dhe linja boshë e tij, që e shtyn Valentina Leskajn të analizojë, të kërkojë rrugë, të japë ide, të ngrejë hipoteza, të ofrojë teza dhe të ballafaqohet me realitetin, është liria. Liria mëtohet si një betejë për t’u fituar, por edhe për t’u ruajtur, si betejë për t’u menaxhuar, si fazë maturie e mbërritjes, por edhe si përgjegjësi për të mos u shpërdoruar. Qysh në kapitullin e parë, pjesën hyrëse të librit, me trajtimin që ajo sjellë për gratë, për lëvizjet e tyre, në Shqipëri dhe në botë, për dëshirën dhe mundësitë, për luftërat e vockla dhe të mëdha, ajo parashtron mundësi për hapësira lirie (çka duhet thënë se, nisma si këto, duhet të ndjehen përpara se të bëhen, sepse të tillat, nuk mund të jenë kurrë mekanike, të orkestruara, të dala nga njerëz të frustruar të politikës apo intelektualizmit, liria kërkon mendje të emancipuar, shpirta të pakufi, njerëz të guximshëm dhe me vetëdije personale dhe kolektive).

### RAPORTI NJERI-QEVERISJE

Pikërisht, këtë bënë Valentina Leskaj, duke na treguar se ajo ka një mision në mendje dhe në shpirt. E ka të qartë, qysh në fillim, se çfarë dëshiron të trajtojë dhe, gradualisht, shpalos ide iluminuese, zhvilluese, frymëzuese dhe vetëdijesuese. Leskaj, vjen

nga shoqëria civile në politikë, jo nga politika në politikë, në kuptimin e ngushtë të fjalës, pra, jo produkt i sistemit politik, por rezultat i angazhimit personal, profesional dhe shpirtëror, prandaj dhe e një mirë fuqinë e botës me në qendër njeriun. Sepse, duhet pranuar që, përvoja jonë, shqiptare, na ka treguar se politikanët në tërësi, sado dhe sido që vijnë nga shtresa të ndryshme sociale, profesionistë në fushat e tyre (me disa përjashtime), qenien njerëzore e kanë parë si mjet për të mbërritur synimet; shpesh, ky individ është trajtuar si një entitet mekanik, si një numër, por rrallë si një shpirt, si një qenie humane, që ndjen, që do, që di, që s’di, që kërkon, që s’kërkon dhe, nëse kjo qenie-njeri-qytetar, një ditë vendos të shprehet, të bëhet më i dukshëm, të shfaqet në kërkim të së drejtës, për të cilën mund të mos ketë qenë i vetëdijshëm, ai mbetet vetëm dhe i pafuqishëm përballë sfumaturës politike. Bash këtu lind një problematikë e re, që i referohet njohjes dhe mosnjohjes, fuqisë dhe pafuqisë, pushtetit dhe nënshtrimit. Ky balancim i vështirë (dhe fatkeqësisht i përhershëm) mes të individit dhe politikës, është një çështje që vijon të kërkojë një zgjidhje të thellë dhe të qëndrueshme. Dhe, Leskaj, me vetëdije dhe autoritet, rravgon për të sugjeruar një orientim të ri, që e ta shtyjë lexuesin e saj drejt një apogjeu tjetër, drejt një hapësire më të lartë shpirtërore dhe më të gjerë sociale. Ky raport (njeri-qeverisje), mëton të bazohet mbi vlera demokratike, duke pasur parasysh një shoqëri në tranzicion si e jona, autorja ngulmon të depërtojë duke sjellë vazhdimisht hapësira alternative, për të krijuar mundësi të reja mendimi dhe ballafaqimi shoqëror, që sigurisht, flasin për një tejkalim të modeleve tradicionale të qeverisjes apo formave të zakonshme të angazhimit qytetar. Në këtë mënyrë, hapësirat që ajo sugjeron, karakterizohen nga paradigma policentrike, ku vendimmarrja dhe përgjegjësia shoqërore shpërndahen në mënyrë proporcionale. Sipas këtij vizioni, politika duhet të jetë një arenë ku adresohen sfidat kolektive dhe projektohet një e ardhme më e drejtë, më gjithëpërfshirëse, me politika që nuk përjashtojnë askënd, një kusht i domosdoshëm për ndërtimin e një shteti të konsoliduar dhe të qëndrueshëm. Ky theks (i vazhdueshëm) është vendosur mbi bindjen se politika duhet të jetë filozofi dhe kulturë mendimi (pra, një lloj edukimi si kulturë politike, që përfshin ata që e bëjnë politikën dhe qytetarët e thjeshtë), vetëm kështu mund të vihen themele në ndërtimin e një demokracie funksionale. Vëmë re: “Kultura politike si lakmuese e nivelit të demokracisë së një vendi, është një koncept i gjerë që përfshin disa elemente... krijimi i një kulture politike demokratike është një proces i gjatë dhe është vështirë të arrihet në nivele të atyre shoqërive që kanë 200 vjet demokraci nga një vend që ka vetëm 30 vjet e sidomos kur vijmë nga një traditë feudale e komuniste.... Politika jonë nuk ka qenë në gjendje të krijojë një kulturë politike të komunikimit apo të bashkëpunimit pozitë-opozitë për çështje të mëdha të vendit, të bëjë një pakt kombëtar afatgjatë, që vë përpara interesat e mëdha strategjike” , shprehet Leskaj, teksa u referohet vendeve demokratike, si Gjermania, por edhe atyre që vijnë nga ish-blloku komunist, kryesisht nga Evropa Lindore, të cilat, sipas saj, në funksion të interesave të ndërsjella kombëtare, kanë arritur të bëhen bashkëpunuese dhe konstruktive në proceset politike dhe integruese. Për ilustrim, ndalet te rasti i Kroacisë, duke përmendur marrëveshjen ndërpartiake që forcat politike atje arritën për të çuar përpara procesin e integritetit në Bashkimin Europian. Leskaj përg-

jatë gjithë librit, duket sikur vë përballë dy brigje, vrojtimin e drejtë dhe artikulimin e qartë, duke i paraqitur ato herë në mënyrë të drejtpërdrejtë, herë në mënyrë të tërthortë, përmes rrëfimeve personale apo analizave kontekstuale. Ajo thekson se politika ka “fytyrë”, në kuptimin që ajo strukturoret mbi ndarje ideologjike, e majtë dhe e djathtë, të cilat s’duhet të jenë thjesht kategorizime teknike, por mishërime të filozofisë mbi qenien, mbi shoqërinë dhe mbi funksionimin e shtetit. (Leskaj nuk i trajton këto çështje në formën e kapitujve teorikë mbi partitë politike, por i ndërthur në mënyrë organike me përvojën e saj konkrete dhe frymën analitike që rrjedh prej saj). “Në fakt e majta, ashtu si edhe e djathta, përgjithësisht kanë ndryshuar si koncept dhe në këtë optikë duhet parë edhe e majta Shqiptare, po ndërkohë shpesh dominimi i politikës së ditës dhe nevoja e votave ka prevaluar mbi përkatësinë ideologjike, duke çuar drejt alternativave që nuk kanë ruajtur thelbin e së majtës”, shprehet Leskaj, kur ndalet tek formacionet dhe ideologjia politike. Le të ndjekim udhën që na shtron autorja, kapitull pas kapitulli, për të ndalur në nyjet ku përplasen idetë, tensionet dhe vizionet e saj: Libri nis me kapitullin “Gratë, një histori e shkurtër e feminizmit”, i cili ofron një vështrim thelbësor mbi rolin e grave përgjatë historisë së tyre dhe shoqërive, ku ato kanë bërë pjesë, si forcë dinamike dhe e pandashme në zhvillimin e tyre kudo, si në Shqipëri ashtu edhe në rrafshin ndërkombëtar. Nëpërmjet këtij shqyrtimi, Leskaj synon të shpalosë me detaje figurat që lanë gjurmë dhe lëvizjet që ato bënë në ndërtimin dhe përhapjen e vetëdijes feministe, për të sfiduar normat dhe strukturat patriarkale, duke vlerësuar, po ashtu, rëndësinë e këtyre kontribuueseve, si fituese të betejave që formoi drejtësinë mbi to. Për ta argumentuar këtë përpjekje, ajo sjell në vëmendje figura të shquara grash shqiptare, siç janë: mo-trat Qiriazi, që ndihmuan në arsimim me shkollën e vashave, krijueset e talentuara, Selfixhe Ciu, Olga Plumbi, Mila Vangjeli, intelektualen e rrallë, Musine Kokalari, etj. të cilat, secila në mënyrën e vet, kontribuan në emancipimin e gruas, me rezonim në një kontekst më të gjerë shoqëror. Në një perspektivë tjetër, Leskaj përmend protagoniste të njohura që dominuan arenën ndërkombëtare, si, Sylvia Pankhurst dhe Ray Strachey, Eleanor Roosevelt, Virginia Woolf, Simone de Beauvoir, Margaret Atwood, etj., emra që, jo vetëm, shënuan një kthesë në lëvizjet për të drejtat e grave, por edhe artikuluan me forcë bindëse rolin e saj në kulturë, letërsi dhe politikë, duke promovuar një shoqëri të hapur, të barabartë dhe pa tabu. Po ashtu, Leskaj, jo më kot, e vë theksin në vitet ’60, si një periudhë vendimtare për ndryshime qartësisht strukturore dhe ideore në fushën e të drejtave të njeriut, veçanërisht të grave në shumë shtete europiane. Sipas saj, feminizmi, megjithëse ndonjëherë mund të jetë perceptuar si fenomen kullimtar apo si ‘modë’, në thelb përfaqëson një transformim të madh të mendësisë kolektive dhe marrëdhëniet mes gjinive. Ky zhvillim, i nxitur nga lëvizjet sociale dhe politikat progresive, solli forcimin e pozicionit të gruas në shoqërinë moderne e bashkëkohore. “Franca kishte një traditë më të hershme në feminizëm, por ajo që ndodhi sidomos në vitet 1968-1969, me protestat e mëdha civile, me grevën e përgjithshme të Majit 1968, që përfshiu rininë universitare e miliona punëtorë të fabrikave, përveçse antiestablishment ishte një nxitje për ndryshim në norma sociale, kulturore, që shënuan një kthesë të rëndësishme në çështjet e të drejtave njerëzore dhe në ato të të drejtave të grave dhe, përgjithësisht, për një shoqëri më të hapur e pa tabu.

##### POLITIKË-BËRJA, HAPËSIRË QË NXIT DEBAT TË VAZHDUESHËM

Vitet 1960 u shënjuan edhe në Angli, Gjermani, Holandë, Itali, vendet Nordike etj, për ndryshimet që sollën dhe për efektin e tyre në lëvizjen për të drejtat e njeriut dhe të drejtat e grave gjithashtu. Në ndarjen “Rrugë brenda meje”, rrëfimi zhvendoset në një prani tjetër, atë që unë e preka më lart, tek e brendshmja e narratorit, aty ku, në fakt, merr jetë çdo hap dhe iniciativë kolektive e shoqërore. Me një sfond historik të pasur, Leskaj e paraqet

këtë angazhim (vetjak) si proces të brendshëm dhe e lidh atë me përvojat dhe sfidat e jetës, sa në sferën personale, aq edhe në sferën kolektive. Duhet theksuar se, Leskaj ka një aftësi të jashtëzakonshme për të të bindur. Duke shpalosur mendimet e saj me qartësi, forcë dhe sinqeritet, por edhe me ndjeshmëri ndaj grupeve shoqërore të brishta, ajo merr përsipër të bëhet bosht qendror lidhës ndërmjet lexuesit dhe çështjes që parashtron. Kjo duket në mënyrën se si i organizon idetë, konceptet që paraqet përmes referencave konkrete, deri tek ilustrimi për fushat përkatëse, ku rrëfimi aspiron të depërtojë, edhe si shpalosje mbi çështjet, edhe si analizë e kujdesshme mbi to. Këtë e bën me ton racional dhe të balancuar, në të gjitha ‘përballjet’ që merr përsipër të shqyrtojë. Te kapitulli i dytë, i titulluar “Politika si ide”, Leskaj e trajton politikën, jo vetëm si një menaxhim institucional, sikurse mëton Havel, por edhe si një përplasje idesh dhe vizionesh, ku ndërthuren mendimi teorik dhe veprimi praktik. Autorja thekson se politikë-bërja është një hapësirë që nxit debat të vazhdueshëm, zhvillim të ideve, rishikim të normave ekzistuese, kërkon transformim të herëpashershëm dhe që ka potencialin të ndikojë në strukturat shoqërore, ekonomike dhe kulturore. Kjo sipas saj, shtyn në rezonim mbi realitetet tona të menaxhimit politik dhe aspiratën qytetare për një shoqëri më të drejtë dhe më të barabartë. Për argument, autorja paraqet marrëdhëniet kronologjike historike që ka pasur politika me shoqërinë civile përtej veprimtarisë formale dhe institucionale, angazhimin qytetar, ndërveprimin me grupet e interesit dhe aktivizimin e atyre që e synojnë realisht ndryshimin social. Në këtë kontekst, Leskaj tregon se, edhe përfshirja e saj në politikë, erdhi si një proces natyral, i lidhur ngushtë me përpjekjet që ajo pati, për të adresuar çështje mbi drejtësinë sociale dhe avancimin e vlerave morale/etike të barazisë dhe demokracisë. Ajo rrëfen me sinqeritet momentin krucial në jetën e saj, kur, pas një ftese të papritur nga ish-kryeministri Fatos Nano, ajo kaloi nga një angazhim aktiv në shoqërinë civile, në një rol qeveritar. “Nuk kaluan as tri minuta dhe më mori Nano. “Vali, si je? Nuk je në Shqipëri?”; I thashë që jam rrugës për në Paris. Më tha se “dua të të ftoj të bëhesh pjesë e kabinetit tim qeveritar si ministre e Punës dhe Çështjeve Sociale”. Ishte krejt e papritur për mua, nuk e kisha menduar që një ditë do t’i bashkohesha politikës...” , rrëfen Leskaj. Kapitulli “Nga Bukureshti në Strasburg/Kehl - Shqipëria në NATO”, pasqyron disa momente kyçe të historisë së Shqipërisë, përjetime të vendit, por edhe të vetë autores, nga brenda proceseve vendimmarrëse, diplomatike, gjeopolitikës etj. Në këtë pjesë, Leskaj ofron një qasje të drejtpërdrejtë mbi zhvillimet që shoqëruan rrugën e Shqipërisë drejt anëtarësimit në NATO, duke nxjerrë në pah rolin dhe ndikimin e saj në këtë proces, në një periudhë kritike të politikës shqiptare. Ajo ndërton një panoramë të detajuar mbi zhvillimet e kohës, duke sjellë, për qartësi, diskutimet dhe propozimet që ajo vetë ka paraqitur, siç është rasti i fjalimit në Kuvendin e Shqipërisë, (13 shtator 2007), një propozim për disa reforma të rëndësishme, që i konsideronte të domosdoshme për vendin, reforma që synonin forcimin e institucioneve dhe proceset demokratike, si hapa të rëndësishëm për të garantuar stabilitet dhe siguri për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO. “Oferta jonë, lidhet me reformën në Sistemin e Drejtësisë, me reformën e Decentralizimit, me reformën e Territorit, reformën në Administratën Publike dhe me reformën Zgjedhore ka mbetur pezull...” Përgjatë gjithë këtij kapitulli, Leskaj na tregon se zëri i saj politikë ka qenë aktiv, i vendosur dhe me vizion për zhvillimin e vendit e integrimin e Shqipërisë në strukturat ndërkombëtare, si pjesë e natyrshme e botës perëndimore. Rrëfimi dhe analiza mbi politikën e brendshme dhe të jashtme, rrugën e anëtarësimit në NATO dhe një sërë zhvillimesh të tjera, mund të shërbejnë si dëshmi dhe dokument historik dhe analitik, sepse është një referencë e besueshme dhe korrekte, pa fetishizime, pa orvatje për t’i zbukuruar, as fshirë apo shtuar, porse shfaqjes me ndershmëri të historisë sonë pluraliste. Tek “Tjetri, pushteti i gjuhës”, Leskaj sjell një këndvështrim mbi gjuhën, si mjet komunikimi, në politikë dhe jashtë



saj, që mund të ndikojë, përjashtojë dhe përfshijë; se si, me apo padashje, përdoret për të krijuar ndasi dhe konflikte, por edhe për të ndihmuar në procese pajtimi dhe integrimi social. Ky kapitull, vë në dukje se gjuha, është faktor i rëndësishëm i identitetit shoqëror dhe si e tillë, ajo ka potencialin për të ndikuar në marrëdhëniet midis njerëzve dhe grupeve sociale, duke e forcuar ose dobësuar kohezionin social. “Duhet thënë se gjuha që ne përdorim, dhe jo rrallë, e që tenton ta gjykojë apo ta denigrojë tjetrin, jo gjithmonë është gjuhë urrejtjeje, ndaj lipset të ndahet qartë për të mos i ngatërruar këto dy gjëra.... E vërteta është që te ne ka gjuhë urrejtjeje dhe politika nuk bën përjashtim, madje shpesh edhe identifikohet me të, duke u bërë jo vetëm bartëse e kësaj gjuhe, po edhe burim i saj. Në këtë rast dëmi që bën shkon përtej marrëdhënieve brenda politikës, prek gjithë shoqërinë ndaj dhe problemi është më i madh”, ndërsa thekson rëndësinë e një komunikimi etik në hapësirën e madhe, atë që është e përbashkët, ku fjala dhe diskursi mund të shërbejnë, si elemente të fuqishme në përmirësimin e tolerancës dhe për krijimin e një shoqërie më të hapur dhe më të respektueshme.

##### FTESË PËR REFLEKTIM MBI POLITIKËN

Ndërsa në kapitullin “Vështrim mbi zhvillimet demografike në Shqipëri”, Valentina Leskaj ofron hulumtim dhe analizë mbi lëvizjet e popullatës dhe sfidat që lindin nga tranzicioni demografik. Ajo ndalet te rënia e lindshmërisë, plakja e shoqërisë dhe emigrimi i shpejtë i forcës punëtore, duke nxjerrë në pah pasojat që këto lëvizje mund të sjellin në zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe politik të një vendi të vogël, si Shqipëria. “Çështja e popullsisë është një problem serioz dhe shumë kompleks që në fakt nuk ka marrë vëmendjen e duhur dhe peshën që ka sidomos nga politikëbërja. Mjaftojnë disa statistika të thjeshta, për të kuptuar se sot jemi përpara një situate që flet për rritje me ritme relativisht të shpejta të moshimit të popullsisë, duke e bërë atë një problem serioz, jo vetëm për të sotmen, por sidomos për të ardhmen e Shqipërisë”, thekson ajo. Kjo temë thekson rëndësinë e adresimit të këtyre sfidave përmes politikave të qëndrueshme dhe të mirëpërgatitura, të cilat mund të balancojnë kërkesat e ndryshueshme të një shoqërie në zhvillim dhe nevojat emergjente të një popullsie në ndryshim. Ndërsa tek kapitulli “Çështjet sociale, një sfidë e përhershme”, autorja thekson përvojat e saj, si Ministre dhe jo vetëm, në hartimin dhe zbatimin e politikave sociale, në një Shqipëri të brishtë, me një strukturë shoqërore të plasaritur dhe me shumë plagë sociale të trashëguara nga periudha të ndryshme historike. Ajo ofron një pasqyrë të përpjekjeve për ndryshim, (nga viti në vit), për çështje, si, varfëria, papunësia, pabarazia, mungesa e mundësive për grupet e marginalizuara etj. “Kjo nuk është punë e një individi, qoftë edhe

ministër, është punë e një ekipi profesional e të përkushtuar që ka qenë i angazhuar seriozisht, me të cilin kam punuar si një skuadër... Natyrisht, nuk them se sot i ka kaluar vështirësitë, po gjithsesi është një diferencë e madhe krahasuar me 18 vjet përpara, kur treguesit e varfërisë, papunësisë, të shërbimeve sociale, të pensioneve etj. dhe kategorive në nevojë, ishin më të përkeqësua dhe natyrisht që nevoja për reforma ishte më imediate dhe shumëdimensionale...”, vijon më tej, ndërsa shqyrton, se si politikat sociale mund të shërbejnë si mjet për riparimin në kohë të këtyre plasaritjeve, duke krijuar mundësi për zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë shqiptare dhe forcimin e mirëqenies qytetare. “Politika si ide”, është një ndër përpjekjet më koherente në fushën e studimeve shoqërore dhe shkencat socio-politike, që synon të ofrojë për lexuesin një udhë të hapur, një koncept të ri dhe një ftesë për reflektim mbi politikën, e cila, assesi nuk duhet parë, si ushtrim i pushtetit, por si një sistem vlerash, sistem që ndërtohet mbi konstruksione më të gjera shoqërore. Në gjithë kapitujt e librit, qoftë si rrëfim, qoftë si qasje analitike, autorja bën bashkë disa dimensione, që lidhen me dy anë të medaljes: ndërtimin teorik të politikës, si ide dhe projekt shoqëror dhe lëvizjet praktike, siç janë, përvoja, historia, dinamikat shoqërore, proceset e zgjatura, kornizat e ngushta për procese integrimi, etj., çështje këto që nxisin mendim dhe debat të gjithëkohshëm dhe lexuesi ka mundësinë ta rishqyrtojë marrëdhënien mes politikës dhe shoqërisë, ndoshta në një mënyrë tjetër, më të ndërgjegjshme dhe më përfshirëse. Prandaj, secili kapitull, shërben si thirrje për një këndvështrim të ri, për ta menduar më mirë politikën dhe për të ndërtuar një narrativë të tjetër mbi të, gjë që do t’i shërbente vetë atij (lexuesit). Në këtë kuptim, diskursi i Leskajt synon të jetë gjithëpërfshirës dhe aktivizues, në mënyrë eksplicite, bën bashkë të gjithë aktorët që përbëjnë jetën socialo-politike, që nga vendimmarrësit institucionalë dhe politikanët përtej bindjeve partiake, deri te qytetarët e angazhuar, nga intelektualët dhe zërat kritikë, të politikanët aktivë të spektrit të gjerë politik, duke i nxitur drejt një analize të mënyrës se si politika perceptohet dhe praktikohet. Duhet theksuar se, “Politika si ide”, është dritare alternative ndaj të kuptuarit dhe të ushtruarit të politikës, që nuk synon të imponojë një diskurs të caktuar, por të kontribuojë në pasurimin e këtij diskursi, përmes hulumtimit, analizës së ndershme dhe përvojës personale të autores. Më shumë se një rrëfim autobiografik, ky libër është ftesë për ndërgjegjësim dhe përfshirje, i orientuar nga vlerat, pjesëmarrja aktive dhe përgjegjësia qytetare, dhe, duhet thënë që vjen nga rrugëtimi e një zonje me përvojë të gjithanshme, aktiviste për të drejtat e njeriut, drejtuese e shoqërisë civile, anëtare e qeverisë, deputete, kryetare e Grupit Parlamentar të PS dhe nënkryetare e Kuvendit të Shqipërisë, etj.

Profile

# SOHRĀB SEPEHRI

**Vargjet e tij, me një ton ëndërror dhe metafizik, janë të zhytura në mitologji dhe misticizëm dhe përdorin një stil figurativ të paraqitjes, të zhvilluar falë ndjeshmërisë së tij të fortë si piktor**

Të lexosh Sohrāb Sepehri-n është si të zhytesh në një vaskë, në kopshtin e qetë të një fortese. Zëri i Sepehrit përshkon kohën dhe hapësirën dhe arrin deri te ne kristalor. Nuk ka shqetësim, përveç atij të diktuar nga dëshira për të parë magjinë e së tashmes, hyjnoren që përmbahet në gjithçka. Filozofja Valentina Furlotti për poetin dhe piktorin Sohrāb Sepehri (Kashan, 1928 - Teheran, 1980) thotë se është një nga poetët më novatorë dhe modernë iranianë të shekullit të njëzetë, Sepehri gëzon shquarje ndërkombëtare. Gjatë gjithë jetës së tij udhëtoi pa u lodhur nga Azia në Shtetet e Bashkuara, duke shfaqur pikturat e veta në galeritë me emër në Nju Jork, në Bienalen e Parisit dhe në shumë vende të tjera. Vargjet e tij, me një ton ëndërror dhe metafizik, janë të zhytura në mitologji dhe misticizëm dhe përdorin një stil figurativ të paraqitjes, të zhvilluar falë ndjeshmërisë së tij të fortë si piktor. “Sepehri - pohon kritiku letrar Francisco Soriano - është i pandryshueshëm në shkrimet e tij poetike, por gjithmonë i ri, në vazhden e një gjendjeje dydimensionale të përvetshme, ku ndërthuren poezia dhe muzika, piktura dhe vallëzimi, përmbetja dhe tejkalimi. Një poetikë shumë e thellë me përfaqësime delikate që na rikthejnë, në një farë mënyre, në disa përshkrime të natyrës të mbushura me tejkuptim ndonjëherë të palexueshme, siç ndodh te Montale. Sipas Giuseppe Contes, “artisti nga Kashani, poeti mistik par excellence i letërsisë persiane të shekullit të njëzetë, pavarësisht se ishte thellësisht i lidhur me tokën e tij dhe kulturën fetare të origjinës, ishte në gjendje të arrinte një vështrim universal mbi gjendjen njerëzore dhe shpirtërore të kohës së tij në harmoni me atë çka ndodhi edhe me autorë të tjerë iranianë të përvetshëm, të cilët ende lexohen dhe vlerësohen, si Rumi”. Valentina Furlotti shpjegon: “Vepra e tij është bartëse e një mesazhi në çdo çast. Poeti shpreson të na përcjellë dijen, një dije jo mejtim, por përvojë. Ai dëshiron

të na mësojë të hapim vështrimin ndaj botës, për të kapur pafundësinë në një shportë të zbrazët, duke kapërcyer çdo hamendësim shkencor, siç shkruan ai në poezinë e tij të famshme, “puna jonë nuk është të njohim misterin e trëndafilut, por ndoshta të notojmë në magjepsjen e tij”.

**DRITË, UNË, LULE, UJË**

S’ka re.  
S’ka erë.  
Ulem në zgrip të vaskës në oborr:  
peshk i vogël, dritë, unë, lule, ujë.  
Bistaku i dëlirë i jetës.

Nëna ime mbledh borzilok.  
Bukë, borzilok dhe djathë, qiell pa re,  
vesë mbi lulen e petunias.  
Shëlbimi është afër: këtu, ndër lulet e oborrit.

Ç’ledhatim derdh drita në tasin e bakrit!  
Shkalla e zbret mëngjesin nga kulmi i murit.  
Gjithçka e fshehur pas një buzëqeshjeje.  
Ka një të çarë muri i kohës,  
fytyra ime mund të shihet nga atje.  
Ka gjëra që nuk i di.  
Por di që do të vdes, nëse këpus një fije bari.

Ngjitem lart, në majë, jam krejt flatrim.  
Shquaj rrugë në terr, jam plot drita.  
Jam plot shkëlqim dhe rërë,  
pemë dhe degë.  
Plot rrugë, ura, lumenj, dallgë.  
Përplot me hijen e një gjetheje në ujë:  
sa vetmi brenda meje!

**ADRESA**

“Ku është shtëpia e Mikut?”  
- pyeti kalorësi në agim.  
Qielli mëdyshtet.

Kalimtari mbante një degë drite  
mes buzëve, ia ofroi rërës së errët  
duke treguar me gisht një plep dhe tha:  
  
“Para se të mbërrish te pema,  
gjej një shteg më të blertë se ëndrra e Zotit  
ku dashuria është blu si flatrat e sinqeritetit.

Vazhdo deri në fund të udhës  
që shquhet përtej adoleshencës,  
pastaj kthehu drejt lules së vetmisë  
dhe ndalo dy hapa përpara,  
duke kundruar rrjedhën e përvetshme të miteve tokësore  
i pushtuar nga një frikë e kulluar.


Në intimitetin e tjetërsueshëm të hapësirës  
do të dëgjosh një shushurimë:  
do të shohësh një djalosh që kacavjerret në pishën shtatlartë  
për të rrëmbyer zogun e pulës nga foleja e dritës  
pyete atë  
se ku është shtëpia e Mikut”.

**NJË LAJM DUKE ARDHUR**

Një ditë, do të vij dhe do të sjell një si-hariq.  
Dritë do të derdh në venat e tua  
dhe zëllartë do thërras:  
“O ju, shportat e të cilëve janë plot ëndrra!  
Ju solla mollën, mollën kuqaloshe të diellit”.  
Do të vij t’i jap një degë jasemini lypësit.  
Gruas së bukur lebroze  
të tjerë vathë do t’i dhuroj.  
Do t’i them të verbrit:  
“Ah, ç’pamje e bukur ky kopsht!”  
Do të bëhem shitës shëtitës dhe në ecejakje do bërtas rrugicave:

“O vesë, vesë, vesë”!  
Një kalimtar do të thotë: “Sigurisht që është një natë e terrtë”!  
dhe unë, një galaktikë do t’i dhuroj.  
Mbi urë,  
një vogëlushe pa këmbë.  
Do t’i qarkoj gushës Arushën e Madhe.  
Do largoj çdo fyerje prej buzëve.  
Do ta shemb çdo mur.  
Hajdutëve do t’u them:  
“ Mbërriti një karvan plot buzëqeshje”!  
Renë do ta bëj copë-copë.  
Do të lidh sytë me diellin,  
zemrat me dashuri,  
hijet me ujin,  
degët me erën.  
Do të bashkoj ëndrrën e foshnjës me zukatjen e gjinkallave.  
Do të ngre fluturimthi shumë shqiponja.  
Do të ujis shumë saksi lulesh.  
Do të vij tek kuajt e lopët  
dhe bar të freskët ledhatimesh do të shkarkoj.  
Do t’i sjell kovën e vesës pelës së etur.  
Gomarit të moçëm në rrugë,  
mizat do t’ia zboj.  
Do të vij dhe në çdo mur  
një karafil do të mbjell.  
Në çdo dritare do të lexoj një poezi.  
Do t’i jap një pishë çdo sorre.  
Do t’i them gjarprit:  
“Ç’vezullim ka bretkosa”!  
Do të bëj paqe.  
Do të bëj njohje.  
Do të eci.  
Dritë do të ha.  
Do të dua.

**(Përgatit dhe përktheu: Rielna Paja)**





## HEJZA

diçka, atëherë ndjej se kjo ka ekzistuar më parë. Kur unë vihem në lëvizje nga ideja e përgjithshme, pak a shumë e kam të qartë fillimin dhe fundin dhe pastaj shkruaj midis-in, por më duket se këtë idenë time, unë e ndjej, është pikë për pikë sinë realitet. Pikërisht kështu, por ajo është e fshehur dhe borxhi im prej poeti është ta zbulojë atë. Bredli thotë se poezia të lë përshtypjen e diçkaje të re të pazbuluar, ndërsa shfaqja në kujtesë – përshtypjen e së harruarës. Kur lexojmë një poezi të mrekullueshme, na vjen në kokë se vetë mund ta kishim shkruar atë, që poezia ka ekzistuar qysh më parë në ne. Kjo na çon ndër mend përkufizimin platonian për poezinë: “E lehtë, flatrore, e shenjtë”. E lehtë, flatrore, e shenjtë mund të jetë muzika (nëse nuk llogarisim që poezia është gjini e muzikës). Platoni ka bërë diç më tepër nga ç’ka përcaktuar poezinë: ai na ka dhënë modelin e poezisë. Ne mund të vijmë në mendimin që poezia - është përvojë estetike; kjo është krejt e re në predikimin e poezisë. Kam qenë profesor i letërsisë angleze në Fakultetin e Filozofisë dhe Filologjisë në Universitetin e Buenos Airesit dhe kam gjakuar, sipas mundësisë, ta anashkaloj historinë e letërsisë. Kur studentët më pyesnin për biografinë, iu përgjigjesha: “Biografia nuk ka rëndësi; tekembramja, Shekspiri nuk ia ka pasur idenë e ekzistencës së biografisë shekspiriane”. Xhonsoni, në botë nuk i shkonte mendja për librat që do të shkruheshin për të. “Përse të mos u kthehemi drejtpërdrejt teksteve? Nëse këto tekste ju sjellin gëzim, bukuri; nëse ato nuk ju pëlqejnë, lërin; ideja e leximit të detyruar është absurde, me po të tillë sukses, mund të flasim për lumturinë e detyruar. Parashtroj se poezia - është diçka ndjesore dhe nëse ju nuk e ndjeni poezinë, atëherë nuk ndjeni bukurinë, nëse tregimi nuk ju cyt dëshirën për me ditë ç’ka ngjau mandej, ky shkrimtar shkruan jo për ju. Lëreni librin e tij mënjanë, letërsia është boll e begatë sa të mund të gjendet një shkrimtar tjetër, i denjë për mendjen tuaj ose ai që nuk ju tërhoqi vëmendjen sot, do ta lexoni nesër”. Kështu kam mësuar unë, duke u bazuar në dukurinë estetike, e cila ende nuk ka marrë përkufizim. Dukuria estetike - është diçka po kaq ashiqare, sa ç’është po aq e drejtpërdrejtë, sa ç’është po aq e papërcaktuar dashuria, shija e frutave, uji. Ne e ndjejmë poezinë si afërsinë e femrës, e ndjejmë si mëngjesi dhe limanin. Nëse e ndjejmë poezinë drejtpërdrejt, përse na u dashka t’i shtojmë asaj dhe fjalë, padyshim edhe më të dobëta sesa ndjenjat tona? Njerëzit që e ndjejnë dobët poezinë, si rregull, zënë ta japin mësim atë. Unë mendoj se e ndjej poezinë dhe mendoj se nuk e kam nxënë atë; unë nuk kam nxënë dashurinë prej këtij apo atij teksti, unë u kam mësuar studentëve ta dashurojnë letërsinë, të dallojnë lumturinë në të. Unë pothuajse nuk jam i aftë për arsyetime abstrakte, ju

tashmë mund ta keni vënë re që unë gjithnjë mbështetem në citate dhe memuaristikë. Pa arsyetuar për poezinë në mënyrë abstrakte, nga ç’mund të isha marrë prej përtese dhe mërzie, ne mund të marrim tekstet në gjuhën spanjolle dhe t’i shohim ato.

##### SONETI I KEVEDOS

Kam zgjedhur dy tekste shumë të njohura gjersa, siç kam folur tashmë, kujtesa ime është e pasigurt dhe unë parapëlqej tekstin, i cili ruhet në kujtesën tuaj. Shqyrtojmë një sonet të njohur të Kevedo-s, shkruar në kujtim të Don Pedro Teles Hironit, Hercogut të Osunës. Do ta lexoj atë prajshëm e mandej, do ta analizojmë varg për varg.

Faltar pudosu patria al grande Osuna
Pero no a su defensa sus hazañas,
diéronle muerte y cárcel las Españas
de quien él hizo esclava la Fortuna
Lloraron sus invidias una a una
con las propias naciones las extrañas
su tumbasonde Flandres las campañas
y su epitafio la sangrienta Luna
En sus exequias encendio as Vesubio
Parténope y Trinacria al Mongibelo,
El llanto militar crecio endeluvio.
Diole el mejor lugar Marte en su cielo;
la Mosa, el Rhin, el Tajo y el Dunubio
murmuran con dolor su desconsuelo (1)

Para së gjithash, dua të veçoj që kjo poezi - është ligjëratë në mbrojtje të një të dënuari me vdekje. Poeti mbron hercogun Osuna, për të cilin, në një poezi tjetër, shkruan: “Vdiq në burg, dhe i vdekur i burgosur qe”. Poeti thotë se hercogu, për nderin e Spanjës, kreu heroizma lufte, ndërsa ajo ia pagoi atij me burg. Këto argumente janë të paplota, përderisa nuk ka asnjë shpjegim që heroi është i pafajshëm apo që mund të jetë i ndëshkuar. Megjithatë

Faltar pudo su patria al grande Osuna
Pero no a su defensa sus hazañas,
diéronle muerte y cárcel las Españas
de quien él hizo esclava la Fortuna

paraqet në vetvete një shprehje demagogjike. Dua të them që nuk e lëvdoj dhe nuk e shaj sonetin, por përpiqem ta analizoj atë.

Lloraron sus invidias una a una

con las propias naciones las extrañas

Këto dy vargje nuk janë më poetikët,ata janë të kushtëzuar nga forma e sonetit dhe, përveç kësaj, domosdoshmërisë së rimës. Kevedo ka shfrytëzuar formën e vështirë të sonetit italian me katër rima. Shekspiri parapëlqente sonetin elisabetian më të lehtë, me dy rima.

Kevedo vijon: varri i tij - fushat e Flandrisë, epitafi i tij - gjysmëhëna e përgjakur. Kjo është më kryesorja. Këto dy vargje ia detyrojnë madhësttinë e tyre shumëkuptimësisë. Mua më kujtohen një mori diskutimesh në lidhje me të kuptuarit e këtyre vargjeve. Çka do të thotë “varri i tij - fushat e Flandrisë”? Mund të përfytyrosh fushat e Flandrisë, fushatat luftarake të hercogut. “Epitafi i tij -gjysmëhëna e përgjakur” - është një ndër vargjet spanjolle më të mbamendshme. E çka do të thotë ai? Ne mendojmë për hënën e përgjakur të Apokalipsit, për hënën e kuqërreme sipri fushës së betejës, por ekziston edhe një sonet tjetër i Kevedës kushtuar hercogut Osuna, në të cilin thuhet: “A las lunas de Tracia con sangriento // ecclipse ya rubrica tu jornada” (2). Kevedo kishte parasysh para së gjithash, flamurin osman; hëna e përgjakur është gjysmëhëna e kuqe. Unë mendoj se do të biem në një mendje të mos përjashtojmë as edhe një interpretim; nuk do ngulmojmë të pohojmë se Kevedo rrëfen për fushatat ushtarake, ose për jetëshkrimin e hercogut, ose për hënën e përgjakur në fushën e betejës, ose për flamurin turk. Kevedo nuk i përjashton leximet e ndryshme. Vargjet janë të mira pikërisht për nga shumëkuptimësia.

En sus exequias encendio as Vesubio
Mandej:
Parténope y Trinacria al Mongibelo

Përndryshe, Vezuvi do ta kishte djegur Napolin, ndërsa Etna - Siqelinë. Sa rrallë i shikon këto emërtime të lashta, të cilat, të duket, se pastrojnë emrat e lavdishëm nga mbishtresimet e së shkuarës. Dhe

El llanto militar crecio en deluvio

Ja edhe një tjetër dëshmi se sa të ndryshme janë poezia dhe qasja rationale; ushtarët, lotët të cilët ngjizin përmbytjen, të duken të pabesueshëm. Por jo në vargjet që kanë ligjësitë e tyre. “Kuja e luftës”, pikërisht e luftës, është tronditëse. E luftës - është një përcaktimi çuditshëm kundrejt fjalës “kujë”.

Mandej:

Diole el mejor lugar Marte en su cielo

Dhe këtë varg është e pamundur ta kuptosh duke u udhëhequr nga logjika; nuk ka shkas të mendosh që Marsi do t’i bëjë vend hercogut Osuna përbri Cezarit. Fraza mbahet me inversion. Ky është një gur prove i poezisë: poezia ekziston jashtë kuptimit.

la Mosa, el Rhin, el Tajo y el Dunubio
murmuran con dolor su desconsuelo

Unë do t’i kisha quajtur këto vargje që më kanë magjepsur kaq vjet, krejtësisht

të gënjeshtërt.a. Kevedo përpiget të na bindë se heroin e vajtojnë vendet ku ai ka luftuar, dhe lumenjtë lavdimëdhenj. Ne e ndjejmë rrenën, më e mira do të kishte qenë të thuhej e vërteta, si Uodsuorthi, i cili, në fund të sonetit, i profetizon Dagllasit për çka ai i ka sjellë dëm pyllit. Dhe, duke i thënë që kobi i Dagllasit në lidhje me pyllin është i tmerrshëm, që ai ka shkatërruar një ushtri fisnike, “vllazninë e pënderçme të drurëve”, shton se ne na zemëron e keqja, kurse vetë natyrën - indiferenca, përderisa lumi Tuit dhe luginat e gjelbra dhe kodrat vazhdojnë të ekzistojnë. Ai ndjen se mbërrin ai efekt maksimal, duke i folur të vërtetën. Menjëmend, ne na zemëron vdekja e drurëve të bukur, ndërsa për vetë natyrën, kjo gjë është indiferente. Natyra e di (nëse ka krijesë të quajtur natyrë) që do rrisë drurë të rinj, që lumi do ta vazhdojë vrapin e tij. Për Kevedon është i rëndësishëm nami i lumenjve. Ka gjasë, mendimi që lumenjtë në të cilët u përlesh Osuna, janë krejt indiferentë ndaj vdekjes së tij, do të kishte qenë edhe më më poetik. Por Kevedo do të shkruajë një elegji, një poezi për vdekjen e njeriut. Çka don të thotë vdekja e njeriut? Bashkë me të vdes fytyra e papërsëritshme, sikundër ka thënë Plini. E papërsëritshme është fytyra e çdocilit njeri , bashkë me të vdesin mijëra ngjarje, mijëra kujtime. Kujtimet e mëmijërisë dhe tiparet njerëzore, tepër njerëzore. Kevedo duket se nuk ndjen asgjë të këstillë. Në burg vdes miku i tij hercogu Osuna dhe Kevedo shkruan këtë sonet celebral; ne ndjejmë indiferencën e poetit. Soneti është shkruar mu si një ligjëratë në dobi të të akuzuarit kundër shtetit që e ka mbyllur hercogun në burg. Të duket sikur hercogu nuk është i shtrenjtë për të; sido që të vijë, ai nuk bëhet i shtrenjtë për ne. E prapëseprapë, ky është një prej soneteve më të mrekullueshme spanjolle.

##### SONETI I I ENRIKE BANÇS

Kalojmë te një tjetër sonet, të shkruar nga Enrike Bançsi. Do të kishte qenë marrëzi të pohojmë që Bançs - është poet më i mirë se Kevedo. Po a ka vallë kuptim një krahasim i tillë? Shqyrtojmë një sonet të Bançsit, në të cilin duket ashiqare dashamirësia e tij:

Hospitalario y fiel en su reflejo
donde a ser apariencia se acostumbra
el material vivir, está el espejo
como el claro de la luna en pelumbra.
Pompa le da en las noches la flotante
claridad de la lámpara, y tristeza
la rosa que en el vaso agonizante
también en él inclina la cabeza.
Si hace doble el dolor, también repite
las cosas que me son jardín del alma
y acaso espera que algún día habite
en la ilusión de su azulada calma
el Huésped que le deje reflejadas
frentes juntas y manos enlazadas. (3)

Ky është një sonet shumë kureshtjendjellës, sepse heroi i tij na del jo pasqyra: këtu kemi një hero të fshehtë, i cili zbulohet aty nga fundi. Ia nisim me temën e sonetit kaq poetik: pasqyra që dyfishon gjithçka të dukshme:

donde a ser apariencia se acostumbra
el material vivir...

Ndërmendim Plotinin. Dëshën të vizatojmë portretin e tij, ndërsa ai refuzoi: “Unë vetë jam hije e arketipit që ekziston në qiell. Përse m’u dashka të krijoj hijen e hijes?” Arti, mendonte Plotini, është dukja e dytë. Nëse njeriu është aq i thyeshëm, jo jetëgjatë, si mund të të magjepsë paraqitja e tij? Këtë pra ka ndjerë Bançsi: ai ka ndjerë fantazmagorinë e pasqyrës. Në të vërtetë, në ekzistencën e pasqyrës ka diç të mnershme: pasqyrat gjithherë më kanë shtënë tmerrin. Mendoj se diç të ngjashme ka ndjerë dhe Poe. Ekziston një punim i tij shumë pak i njohur për mobilimin e dhomave. Ai e quan të domosdoshme për t’i vendosur pasqyrat në mënyrë të tillë që ato të mos e pasqyrojnë njeriun kur rri ulur. Kjo zbulon tmerrin e tij kur shihej në pasqyrë. Po këtë gjë ne e vërejmë në tregimin e tij “Uilliam Uillson” mbi pasqyrimet dhe në tregimin për Artur Gordon Pim-in. Jo shumë larg Antarktidës, gjallon njëfarë fisi; një njeri prej kësaj tribuje, me të parë veten për herë të parë në pasqyrë, u plandos i shituar tmërri. Ne jemi mësuar

## HEJZA

me pasqyrat, e prapëseprapë, në këtë dyfishësi dukjeje, ka diçka të frikshme. I kthehemi sonetit të Bançsit. Përkufizimi “mikëpritës”, i aplikuar ndaj njeriut, do të na dukej i sforcuar. Po kurrë nuk na ka shkuar ndërmend që mikëpritëse mund të jenë pasqyrat. Pasqyra përmbyll në vetvete hareshëm dhe paqtueshëm gjithë mumosjen:

Hospitalario y fiel en su reflejo donde a ser apariencia se acostumbra el material vivir, está el espejo como el claro de la luna en pelumbra.

Në e vështrojmë pasqyrën, gjithaq shkëlqimtare, dhe, për më tepër, poeti e krahason atë me hënë e pambërritshme. Ai ndjen në pasqyrë diçka të çuditshme dhe magjistare, të ngjashme me “hënën e ndritshme në gjysmëterr”. Mandej:

Pompa le da en las nochesla flotante

claridad de la lámpara ...

“Drita vozitëse” i bën sendet të pakonturta,gjithë të vagullta, si pasqyra në gjysmëterr. Ashiqare, koha e veprimit është mbrëmje ose natë.

Kësisoj:

...la flotante claridad de la lámpara, y tristeza la rosa que en el vaso agonizante también en él inclina la cabeza

Tani, përpara nesh, në një sfond të vagullt, - një trëndafil i kundruar qartë.

Si hace doble el dolor, también repite las cosas que me son jardín del alma y acaso espera que algún día habite en la ilusion de su azulada calma el Huésped que le deje reflejadas

frentes juntas y manos enlazadas

Këtu ne ndeshemi me temën e sonetit, i cili na dalka jo pasqyrë, por një dashuri e drojtur, një dashuri e ndrydhur. Pret jo pasqyra, që sheh fytyrat që aviten tek njëra-tjetra dhe duart që kapërthehen, por poeti. Mirëpo pezmi e shtrëngon atë të flasë jo drejtpërdrejt dhe kjo është ndërtuar mahnitshëm, sepse që nga fillimi, lind “mikëpritëse dhe besnike”, që nga fillimi, pasqyra është jo prej qelqi apo metali. Pasqyra - është krijesë njerëzore, mikpritëse dhe besnike, dhe ne mësohemi me atë që para nesh hapet një botë iluzore, e cila së mbrami, identifikohet me poetin. Ky poet dëshiron të shohë mysafirin, dashurinë. Ky sonet, për nga thelbi i vet, është i ndryshëm nga soneti i Kevedos, ndërsa pranin e gjallë të poezisë ne e ndjejmë në vargjet e tjera të këtij të fundit:

varri i tij - fushat e Flandrisë.

epitafi i tij - gjysmëhëna e përgjakur.

Unë kam folur tashmë për gjuhët dhe për atë që, krahasimi i një gjuhe më një tjetër, është i padrejtë;sipas meje, ka dëshmi të mjaftueshme dhe, nëse na vjen në kokë një poezi, një strofë në spanjisht, nëse ndërmendim

quién hubiera tal aventura sobre las aguas del mar como hubo el conde Arnaldos la mañana de San Juan, (4)

atëherë kuptojmë se puna s’ka të bëjë me atë se sa i eci anijes dhe as me kontin Arnaldos, ne ndjejmë që këto vargje mund të ishin thënë veçse në spanjisht. Kumbi i frëngjishtes nuk më kënaq, në vështrimin tim kësaj gjuhe nuk i mjafton kumbimi i plotë i gjuhëve të tjera romane, po a mund të mendohet vallë keq për gjuhën në të cilën janë krijuar vargje të tilla të mahnitshme si vargu i Hygosë: L’hydre - Univers tordant son corps écaillé d’astres. (5) Si ta kritikojmë këtë gjuhë, pa të cilën nuk do të kishin qenë vargje të tilla? Pamjaftueshmëria e anglishtes, mendoj se qëndron në faktin se ajo i ka humbur zanoret e hapura të anglishtes së vjetër. Pa marrë parasysh këtë, ajo i dha mundësinë Shekspirit të shkruajë:

And shake the joke of inauspicious stars from this worldweary flesh,

çka në përkthim tingëllon e pasaktë: “Dhe trand harenë e yjve fatkeq nga ky kurm i përbotshëm” Në spanjisht, kjo është një hig; në anglisht - gjithçka. Nëse do të më binte të zgjidhja një gjuhë (megjithëse s’ka asnjë arsye të mos i parapëlqej të gjitha njëherësh), kjo do të kishte qenë gjermanishtja dhe mundësia e saj për të ngjizur fjalë të koklavitura më shumë se sa anglishtja me zanoret e hapura dhe muzikën e mrekullueshme. Përsa i përket italishtes, është e mjaftueshme “Komedia”.

##### BUKURIA NA ZË PUSI

Askënd nuk e habit bukuria me të cilën janë spërkatur gjuhë të ndryshme. Mësuesi im, një hebreo-spanjoll i mrekullueshëm, poeti Rafael Kansinos-Assens, më ka rrëfyer një lutje të tillë: “O Perëndi, le të mos bëhet kaq bukur”, ndërsa te Brauning ndeshim: “Kur ta ndjejmë veten krejtësisht të sigurt, do bëjë vaki diçka - një perëndim dielli, një finale e korit të Euripidit, dhe ne gjendemi sërish në dalldi”. Bukuria na zë pusi. Nëse e zotërojmë mundësinë për të ndjerë, atëherë e ndjejmë atë në poezi në çdocilën gjuhë. Unë duhej të kisha studiuar më tepër letërsi lindore; ia përfytyroj vetes ato veçse përmjet përkthimeve. Unë e ndjeva ndikimin e bukurisë së tyre. Për shembull, vargu i poetit persian, Hafizit: “Fluturoj, hiri im do të jetë unë”. Këtu është kallur e gjithë dija mbi transmigrimin e shpirtave - “hiri im do të jetë unë”, - unë pra, do të rishfaqem në botë edhe një herë, në një tjetër shekull, do të jem Hafiz, do të jem poet. E gjitha kjo është shprehur në disa fjalë, të cilat i kam lexuar në anglisht, po zor se ato ndryshojnë fort prej persishtes. “Hiri im do të jetë unë” - është thënë tepër thjeshtë, që të mund t’i nënshtrohet ndryshimeve. Mendoj se, të studiosh letërsinë nga pikëpamja historike, është e gabuar. Megjithat, ka gjasa, për ne, (edhe për mua ndër të tjera) rrugë tjetër s’ka si të ketë. Ekziston një libër i një poeti, sipas meje të mrekullueshëm, dhe kritiku të keq, Marselino Menendes-y-Pelaio, i cili mban titullin “Njëqind poezitë më të mira spanjolle”. Lexojmë në të: “Ande yo caliente y ríase la gente”(6). Nëse kjo është një prej poezive më të mira, atëherë, cilat janë më të këqijat. Por në këtë libër ne shohim vargjet e Kevedos, të cilët ua

citova, dhe “Dërgesën” e një anonimi seviljan, dhe një morie poezish të tjera të mrekullueshme. Për fat të keq, nuk ka as edhe një poezi të Menendes-y-Pelaios, i cili nuk e ka përfshirë veten e vet në antologji. Bukuria ekziston gjithkah dhe, ka gjasa, prore. Miku im, Roy Bartolom, i cili ka kaluar disa vjet në Persi dhe përkthen Khajamin direkt nga farsi, më kumtoi diçka që e parashikoja: që në Lindje, në tërësi, nuk mësojnë as letërsinë, as filozofinë nga pikëpamja historike. Pikërisht kjo gjë e mahniti Deisen dhe Maks Mylerin, të cilët nuk mundën të përpilojnë një listë kronologjike të autorëve. Historia e filozofisë mësohet, si të themi, nëse Aristoteli do të kishte nisur dispute me Bergsonin, Platoni me Hjumín, - të gjithë njëkohësisht. Në përfundim, dua të sjell tre lutje të detarëve fenikas. Kur anija pothuajse po fundoset nën ujë - kjo ngjet në shekullin I e.s., - ata lexojnë njërën prej tre lutjeve. E para tingëllon kështu: “Mëmë Kartagjenë, po ta kthej rremen”. Nëna Kartagjenë - është qyteti Tir, prej nga e ka prejardhjen Didona. Mandej - “po ta kthej rremen”, kjo është e jashtëzakonshme. Fenikasi e sheh jetën vetëm si rremtar. Jeta e tij është sosë dhe ai e kthen rremen që të mund të vazhdojnë ta rremojnë të tjerët. Lutja tjetër është edhe më drithëruesja: “Po dremis, mandej rishmi do kap rremen”. Njeriu nuk përfaqëson fatin dhe i avitet mendimit për kohën ciklike. Dhe, së mbrami, e sprasmja, në shkallën më të epërme prekëse, lutja dallon prej të tjerash, përderisa në të nuk ka pranim fati; është hapi i një njeriu të dëshpëruar, i cili duhet të vdesë dhe të dalë para gjyqit të hyjve të mnershëm. Ai flet: “Perëndi, gjykomë mua jo si Zot, por si njeri, të cilin e gëlltiti deti”. Në këto tre lutje, ne drejtpërdrejt e ndjejmë - ose unë ndjej - praninë e poezisë. Pikërisht në to është dukuria estetike, dhe jo në biblioteka dhe në bibliografi, dhe jo në studimin e një morie dorëshkrimesh apo volumesh të vështira. Ua lexova tre lutjet e detarëve fenikas prej tregimit të Kiplingut, “The manner of men” (7), tregimit për Shën Palin. Origjinale të jenë ato për nga shprehja jo aq e saktë, apo i ka shkruar ato Kiplingu, poeti i madh? Me të shtruar pyetjen, kam ndjerë siklet: a ka vallë kuptim të zgjedhësh? I shqyrtojmë të dyja mundësitë, të dyja pjesët e dilemës. Në rastin e parë, fjala është për lutjet e detarëve fenikas, njerëzve të detit, të cilët e përfytyronin jetën e tyre veçse në det. Nga gjuha fenikase, të themi, ato kaluan në greqisht, prej andej - në latinisht, prej latinishtes - në anglisht. Kiplingu i ka shkruar ato nga e para. Në rastin e dytë, poeti i madh, Rudiard Kipling, i përfytyron detarët fenikas, në njëfarë mënyre afrohet me ta, bëhet vetë ata. Ai ia përfytyron vetes jetën si jetë deti dhe kall në buzët e detarëve këto lutje. Gjithçka ka iku në të kaluarën: detarët e paemër kanë vdekur. Kiplingu ka vdekur. E ç’ndryshim ka se kush prej këtyre fantazmave i ka shkruar dhe sajuar këto vargje? Metafora interesante e poetit indian - nuk e di nëse do të mundja ta vlerësoja plotësisht atë - thotë: “Himalajet, malet e larta Himalaje (majat e të cilëve, sipas fjalëve të Kiplingut, janë gjunjë të tjera malesh), Himalajet - janë buzagazi i Shivës”. Malet e larta - janë

buzagazi i zotit të mnershëm. Metafora, si minimum, është madhështore. Unë e ndjej bukurinë fizike si diçka të perceptueshme, megjithë trupin. Kjo nuk është rrjedhojë e arsyetimeve, ne nuk mund ta mbërrijmë bukurinë sipas ligjesh, ne ose e ndjejmë atë, ose nuk e ndjejmë. Dua me i dhanë fund me një varg poezie të një poeti të shekullit XVI, që pati zgjedhur për vete një emër poetik të jashtëzakonshëm - Angelus Silezius. Ky varg do të jetë bilanci i gjithçkaje që folëm sonte, nëse nuk do të llogarisim arsyetimet e mia apo thuajse arsyetimet; unë do ta sjell atë së pari në përkthim e mandej, gjëmanisht, që ju ta dëgjonit: - Trëndafili nuk pyet “përse”, ai lulëzon, sepse lulëzon: “Die Rose est ohne warum; sie blühet weil sie blühet”.

##### Shënime

1) Atdheu do të ketë nevojë për Osunën,

Por nuk iu bënë mburojë heroizmat e tij,

Spanja, për të cilën ai e bëri skllave Fortunën,

Burgun dhe vdekjen i dhanë atij.

Vajtojnë për të

Dhe populli i tij, dhe të tjerë,

Për varr ka - fushat e Flandrisë,

Për epitaf - gjysmëhënë e përgjakur.

Në funeralin e tij Vezuvi dogji

Partenopenë, dhe Trinakrinë - Mongibelo;

Kuja e luftës ngjiz përmbytjen.

Vendin më të mirë ia zgjodhi Marsi në qiell.

Mosa, Rini, Tahoe dhe Danubi

Qajnë pangushëllueshëm për pikëllimin e tyre.

2) Në hënën e Trakisë fushatat tuaja do të shtrihen // me eklips të përgjakur.

3) Mikpritëse dhe besnike në pasqyrime

Ku rëndom e gjalla, shndërrohet në shajni,

Pasqyra e ngjashme me

Hënën e ndritshme në gjysmëterr.

Drita plluskuese e llampës natën

I jep asaj luciditet, dhe trishtimi është -

Trëndafili që në vazo jep shpirt,

Gjithë duke varur kokën.

Ajo e dyfishon pikëllimin dhe përsërit

Atë çka lulon në shpirtin tim,

Dhe, gjasë ka, pret, që herëdokur

Të qesë dukën e vet

Në qetësinë e iluzionit blu

Mysafiri, dh’atëherë ajo do t’i shfaqë

Fytyrat puqur dhe duart - kapërthyer. (sp)

4) Kush pra është kaq i lumë

Mbi valët e detit,

Se sa konti Arnaldos

Në ditën e Shën Huanit? (sp)

5) Hidra-Gjithësi rrotullon ndër unaza trupin mbuluar me luspa yjsh (fr)

1) Nëse iki i zemëruar, gjithçka përreth gajaset. (sp)

2) “Lloji njerëzor” (angl)

**(Përktheu: Agron TUFA)**

## Poezi: Xhevahir SPAHIU

### BALLËPËRBALLË

Unë dal në rrugë  
me tufa mimozash në duar,  
ti me shkopinj dhe me plumba,  
ti me qen  
unë me pëllumba.

Unë kam fytyrë -  
ti skafandër,  
ti dhëmbët -  
unë fjalën.

Unë kërkoj një grusht jetë  
ti më kërkon edhe vdekjen.  
Të dy  
sy ndër sy  
sy ndër sy  
të dy.

Pëllumbat e mi pasurojnë hapësirat.  
Ikën qentë prej teje, muarrën malet  
përpijetë.

As qentë nuk të duan.  
Nuk të duan as qentë.

### KUR SHESHET ISHIN ZBRAZUR

Kur gjysma bënte kafe  
dhe gjysma pinte kafe

- po unë s qeshë aty -

Kur sheshet ishin zbrazur  
(kamxhiku prehej pakëz)

një lot kërkonte sy.  
\*

tri kafshë  
mbi katër rrota  
m i gëlltitën sytë.

(vdekje, të theri zemra?)

qajnë gishtërinjtë e mi si stalaktitet  
për ju, o shpella,  
ç paskëshit mbajtur brenda!

\*

Kur shkon dhe kokën e kthen pas,  
Kur hyn dhe derës i ve lloz,  
Mos do të thotë: vdekja t u qas  
Dhe ti s arrin të klithësh: - Mos!

### DIL

Kur s i qesh buza buzëqeshjes,  
Kur dhe vetmia zë vetmohet  
Ti rri ngujuar brenda heshtjes  
Po tjetërkush për ty ngujohet.

Je gjeth i degës hijerëndë  
Je dru i pyllit që nuk sos  
Nga zëra njerëzish rrafsh iu shembën  
të lashtat mure Jerikosë.

Dikush për ty përbluan urinë  
Mos ndjejnë uri as zogjtë, as ti.  
Ti - një shushamë në suferinë, -  
ngujuar brenda vetes rri.

Dil sa pa rënë nata e gjatë,  
sa pa të marrë harrimi osh,  
Në këtë botë të pamatë  
Të rrosh, përkthehet të luftosh!

### DIGJEN QIRINJTË

Digjen qirinjtë në shuplakën e mbrëmjes  
Shëtitorët tiranase shtrirë si shandanë  
Qirinjtë lotët s i fshehin,  
Qirinjtë njerëzisht mund të qajnë.  
Flakët luhaten  
si fjalët e firomës së fundit,  
i flasin erës  
i flasin gurit.  
Sa të rrimë e të nënim orë e çast errësirën  
më mirë, thanë njerëzit, të ndezim qirinj  
në kujtim të shpirtave të atyre që s janë  
përsHPirtje për të vdekur, paqe për të gjallët  
që treten pak nga pak si qirinjtë shpirtbardhë  
Digjen qirinjtë shëtitores së Tiranës  
digjen dhe qajnë  
për ata që s janë;

por dalin nga terri ca terre mbi terr  
dhe nisin t i fikin qirinjtë, për tmerr.  
Fiket i pari, rrëzohet dhe një  
vdesin po asnjëri prej tyre s nxjerr zë.

Qirinjtë me mijëra - me mijëra shpirta.

Fikësit s kishin kohë,  
fryma po u sosej, -  
pastaj pas një gjëme  
do ndiznin tjetër gjëmë.

Atëhere, siç shtyp fëmijët një tank  
i shtypën me këmbë.

Vetëm njërin, ah, njërin s arritën ta fikin  
Qiririn hyjnor të Naimit.



Tregim/ Frano KULLI

# FLETËKAMPI



Ka qenë vera e vitit 1990. Pesëmbëdhjetëditëshi i parë i gushtit. Ne me dy fëmijët tanë dhe kunati, Angjelini, vetë i katërti me të vetët kishim zanë një kabinë në plazhin e Shëngjinit. Kishim ba gati rropullitë që duheshin, pjata e tenxhere, lugë e piruj, ushqimet e lana mënjane për këto ditë; aq mish, djathë e burofresko sa kishim mujtë me kursye prej kater pesë tollonave\* të fundit, perimet e freskëta nga kopështi i shpisë, aq sa mund t’i rezistonin vapës së gushtit e kishim marrë trenin , që nisej nga Shkodra heret në mëngjes. Ashtu rrezgabezga\*\*, sikur do të na e zinte dikush atë furrikun kabinë ku do të përmbldheshim për pesëmbëdhjetë ditë tetë frymë, që mezi e kishim gjetë e ia kishim pague paret. Simoni me Luçien, që shkurt e thirrshin Luçi, kishin një javë që kishin zanë vend te kampi i Punëtorëve. Në Shëngjin kishte dy kampe pushimi, oborret e jeshilueme të të cilëve ishin ngjitë e ngjitë; ai i puntorëve dhe ai i pionierëve. (Kampe quheshin asokohe shpitë e pushimit, njëlloj si vendvuajtjet e dënimeve për të burgosunit). Ishin burrë e grua. Luçit i kishte ra me ndejë në dhomë me një grua dhe Simonit me Rustemin. Ashtu kishin mujtë me i gjetë fletët e kampit, veçmas. Luçi, bante si bante; ajo ishte mësue gjithmonë me njerëz gjithëfarësh e familjarizohej gjithësesi, po për Simonin ishte tjetër gja. Bashkëbujtësi i tij për këto ditë pushimesh ishte krejt i përkundërti i tij. Ai kishte qenë e, ende aty gjindej, në një zyrë hijerandë të qytetit, ku përziheshin e luheshin fate njerzish. Por, si i mirëinformuem për kohët që po ndryshonin ai ishte hedhë dukas në krahun e të revoltuermve... Simoni, ai burrë i pashëm, me fytyrën e lëmuet e të buzëqeshun, duke përshkue

e soditë pothuaj krejt bregun, në orët e herëshme të mbasdites vinte tek ne, që ishim te hotel “Flutura”, në krahun tjetër, jo larg portit. Njerëzit pushues të shtrimë në ranën e nxehtë nën çadrat e vjetrueme, në atë orë çonin përpjetë antenat e radiove “Iliria” të gatëshme me përpj zanin kumbues të spikerit, që vinte nga valët e “Zërit të Amerikës”. Rrjeta e zhurmuesve ishte shprishë prej ngjarjeve të Ambasadave të Tiranës\*\*\* e lajmet për hapje-thyerjen e portave dhe hyrjen e mijsa shqiptarëve në interieret e tyne ishin bá lajme të përbotëshme. Simoni kishte qenë nxënës në Seminarin Papnuer. E kishte ndërpre rrugën e thirrjes meshtarake dhe prej andej kishte hy në rrugën e mësuesisë. E asaj rruge nuk i ishte nda mandej për rreth katërdhjetë vjet. Me atë ekzgjencë që kishte përfutue në vitet nistore të rrugës së formimit të tij ndër jezuitë. Aq serioz kishte qenë me mësuesinë sa na e thoshte si pengun e vet, se dy herë , vetëm dy herë ishte paraqitë në orën e mësimit pa bá ditar edhe pse ato dy herë kishin qenë të justifikueshme. Nejse... Tashti ai ishte në pension, kishte pesë vjet që ishte në pension dhe, ngjarjet e atyne ditëve që pasononin njëna tjetrën me një ritëm të hatashëm ai i komentonte shkurt, po me aq adrenalinë sa e banin burrin të fluturonte edhe kur ishte ndejun. Mbasi fëmijtë tanë , të katërtit, që ishin në mosha të përafërta, ishim mbledhë rreth tij, ai ngrihej në gjunjë të mëdhenj e fillonte: Unë prej Zotit jam i kshtenë e gjithmonë kështu du me kenë... Mandej Puna e pendimit...

O Zoti jem, po më vjen keq megjith zemer për mëkatet që kam ba

kam bjerrë Parrizin, kam fitu ferrin, por ma fort se t’kam fye ty. O e mira e pambarueme, Mëshirë o Zot, m’fal o Zot ! Po t’jap fjalën, me ndihmë tande s’kam me t’fye mja kurrë Ashtu kjoftë !

Sapo kishte fillue uratën, që ua këndonte plot kantilenë e pasion fëmijve, prej larg, siç ishim ashtu grumbull, kush ndejë e kush në gjunjë, ndigjojmë zanin kumbues të Luçit: -Simon, Simon... -Urdhno, hajde Luç, hajde se këtu jam, a të thashë se po shkoj te Angjelini ?! -Po, mor po, po u vonove fort se... -Po na me pushime jena, moj Luç... -A na duhet me u ba gadi, me shku..., a ke harrue , á ? Gruja e huaj asht e sëmure e m’pret me i ba bá inxheksionin e mbasdites. Ata ishin martue vonë.. Edhe Luçia fillimisht kishte qenë nxanëse në Kuvendin e Murgeshave Stigmatine. Mbasi i paten qitë me forcë prej aty në fillimvitet ‘50, ajo kishte fillu punë në spitalin e qytetit, në fillim si sanitare, mandej si infermiere. Zoti s’ju kishte falë fëmijë. Tashti edhe ajo ishte në pension po, në spital, atje ku kishte shërbye prej katërdhjetë vjetësh, shkonte ditë për ditë. Në të njëjtën orë. Gjithmonë pak minuta para se të fillonte orari i punës. Kurse për kthimin nuk kishte orar. Ashtu sikurse nuk kishte pasë kurrë. Asgjë s’kishte ndryshue nga e përditëshmjja e përherëshme e saj; kishte ndryshue vetëm dita e firmosjes së listëpagesës , nga dy herë në muaj në një herë në muaj. Dhe vendi i listëpagesës, nga Spitali i qytetit në Sigurimet Shoqërore... Luçi e kishte mbyll aty bisedën e , duke

na përshëndet ne ishte nisë përpara drejt “rezidencës” së tyre, drejt kampit pra. E bindur se Simoni po i shkonte mbas. Mirëpo ai, ende nuk ishte shkëput prej nesh. -Gjithmonë kështu ka kenë Luçi, tuj ngá vrap. Më kujtohet njëherë, nuk ka shumë vjet, erdhi vonë fort prej spitalit . E i kthehem: -Çkã buna asht kështu, moj Luç, kaq vonë. Mandej, ti edhe ndoj ditë mundesh mos me shku moj burrneshë se ti tash në pension je. Po ajo, pa prit qortimin tem të përvujtshëm m’u kthye: -Joo Simon, si mundem me ndejë pa shkue, ata njerëz kanë nevojë për mu e unë baj sevap për ta. - Po, moj po, ban sevap për ta- i thashë-por po hin në gjynah me mu. E niset përmbas Luçit. Prej larg sheh Rustemin, bashkëbujtësin e dhomës. Antenat e radiove “Iliria” tashma ishin ulë njëherëshi në të gjithë plazhin. Kishte mbarue edicioni i orës 6 të “Zanit të Amerikës» e ai mezi pritte me ja komentue Simonit, i cili gjindej në udhëkryq; me ndjek Luçin në ngutin e saj apo me durue të shamet e rregjimit prej Rustemit... Por e zhdavariti shpejt mëdyshjen, tue vijue në drejtimin për ku ishte nisë.

-----  
\*tolloni - autorizimi për të blerë ushqime me të cilin racionoheshin ushqimet e munguara në treg.

\*\*rrezgabezga-shpejt e shpejt, ik të ikim

\*\*\*ngjarjet e 2 korrikut 1990, kur mijëra qytetarë të Tiranës hynë në Ambasadat e vendeve perëndimore

Ese

# POST-STRUKTURALIZMI DHE DEKONSTRUKSIONI

**Derrida është përgjegjës për zhvillimin e dekonstruksionit në një "metodë" të rëndësishme letrare gjatë viteve 1970 dhe 1980**



## Arne MELBERG

Post-strukturalizmi dhe dekonstruksioni janë nocione teorie kontraverse në teorinë moderne letrare dhe rrallë shfaqen në formën e tyre të pastër. Në të njëjtën kohë, ekziston një linjë e gjatë shenjëzimesh kritike gjuhësore, retorike, filozofike, historike dhe letrare aktuale që mund të nxirren nga strukturalizmi dhe që “dekonstruktivisht” merren me kritikën në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Por, në realitet, ndoshta është vetëm një person që mund të quhet post-strukturalist dhe dekonstruktivist njëkohësisht - filozofi francez Jacques Derrida, i cili kurrë nuk e përdori termin post-strukturalizëm dhe ishte kritik ndaj dekonstruksionit, të paktën kur përdoret si emër në trajtën e shquar. “Kushdo që beson se merret me diçka si dekonstruksioni në njëjës, ka gabuar që në fillim dhe diçka tjetër ndodh”, thekson ai. Por, megjë dekonstruksioni është gjithmonë ‘diçka tjetër’, gabimi nuk është kurrë i plotë.” (1988). Megjithatë, Derrida është përgjegjës për zhvillimin e dekonstruksionit në një “metodë” të rëndësishme letrare gjatë viteve 1970 dhe 1980. Pikënisja e Derridës ishte fenomenologjia kritike filozofike e Heidegger-it dhe Husserl-it; me këtë pikënisje, ai mund të kritikonte strukturalizmin francez të viteve 1960 si «metafizik». Kjo nënkuptonte nocione të esencave dhe hierarkive në botën e mendimit; për shembull, se strukturat duhet të kenë një qendër dhe se tekstet duhet të kenë një origjinë strukturore. Derrida mendonte, ndërkaq, në mënyrë të decentralizuar dhe iterative: përsëritja dhe ndryshimi përcaktojnë atë që ai e quan “tekst”. Dhe ky “tekst”, për të përdorur një frazë të famshme nga De la Grammatologie të vitit 1968, nuk ka “anë të jashtme”: nuk ka asnjë instancë “jashtë tekstit” që mund të përcaktojë kuptimin e tekstit. As brenda në tekst nuk ka ndonjë instancë të qëndrueshme të privilegjuar: në vend të kësaj, është ndryshimi, zhvendosja, përsëritja, zëvendësimi që krijon kuptimin. Projekti dekonstruktiv i Derridës mund

të përmblihet në një formulë: tensioni midis ngjarjes si unike dhe shenjes si të përsëritshme. Kjo pikënisje relativisht e thjeshtë ka rezultuar e frytshme dhe produktive në një numër fushash: para së gjithash në historinë e filozofisë dhe kritikën konceptuale, por edhe në kritikën institucionale në një numër fushash si sociologjia, jurisprudenca dhe arkitektura. Megjithatë, duhet thënë se studimet letrare dhe kritika letrare kanë qenë më mirënjohëset nga shumë marrës të ideve të Derridës. Kjo për shkak se kritika e tij ndaj filozofisë shkaktoi lëkundjen e kufirit midis filozofisë dhe letërsisë dhe nga këmbëngulja e tij se të gjitha tekstet duhet të lexohen sipas kushteve të vetë tekstit. Në këtë mënyrë ishte më e lehtë për t’u pajtuar si me praktikën neokritike ashtu edhe me atë filologjike - me kusht që të mos këmbëngulej në kuptim të qëndrueshëm - sesa me filozofinë e zakonshme. Përveç kësaj, Derrida ka paraqitur leximet e tij origjinale letrare, për shembull, të Mallarmé-së, Ponge-s, Genet-it, Joyce-t, Kafka-s, Celan-it. Letërsia me sa duket ka qenë një frymëzim i rëndësishëm për projektin e tij filozofik. Ndryshe, premisat e tij më të rëndësishme filozofike gjenden në “kritikën” e Kantit ndaj kushteve të dijës, “shkatërrimin” e metafizikës nga Nietzsche, përfshirë kritikën e tij ndaj gjuhës të frymëzuar nga retorika, dhe projektin e Heidegger-it për të “shkatërruar” “metafizikën perëndimore”, të cilën ai e quan “histori e ontologjisë”. Po aq e rëndësishme ishte zakoni i Heidegger-it për të kritikuar terminologjinë “metafizike” me ndihmën e etimologjisë, domethënë, duke ushtruar një kritikë gjuhësore mbi termat e vetë koncepteve. Zhvillimi i Paul de Man-it nga kritika letrare fenomenologjike në dekonstruksion ishte një kthesë drejt retorikës: ai zbuloi se zhvendosjet dhe ndryshimet e Derridës mund të lexoheshin si figura retorike të të folurit. Kështu, de Man-i u lidh me një traditë të vlefshme retorike, së cilës ai, megjithatë, i ofroi një zbatim filozofik gjuhësor - ashtu siç mund të përdorte Derrida filozofinë e tij me relevancë teorikë-letrare. Kjo do të thotë që dekonstruksioni, sipas

versionit të de Man-it, nuk mund të reduktohej në një teknikë për gjurmim të efekteve retorike, por në vend të kësaj dekonstruksioni u emërua si veti e vetë gjuhës, një veti që gjuha letrare e demonstroi me efektivitetin më të madh. Paul de Man, për shembull, në esenë programatike “Semiologjia dhe retorika” (1979) - mund të analizonte diçka aq të thjeshtë si pyetjen retorike (“What’s the difference?”) me vëzhgimin se kuptimi gramatikor nuk është i pajtueshëm me atë retorik: retorika “përfashon “logjikën dhe gramatikën. Ndërkohë edhe gramatika është e infektuar me retorikë dhe de Man-i duket se anon nga ideja se tërë gjuha në fakt është figurative dhe në këtë aspekt, retorike. Nuk mjafton të thuhet, beson de Man, se retorika është rekonstruksion i letërsisë nga kritika letrare, domethënë, demonstrimi i saj i kontradiktave midis, për shembull, pohimit dhe pyetjes. “Dekonstruksioni nuk është diç që i kemi shtuar tekstit, por ajo që gjithmonë ka qenë pjesë përbërëse e tekstit që nga fillimi” (1979, f. 17). Në terminologjinë e de Man-it, “leximi retorik” është hapi i parë i dekonstruksionit; hapi i dytë dhe vendimtar merret kur retorika bëhet më shumë se një teknikë, domethënë tekst. Retorika bëhet kështu jo vetëm një “pezullim” kritik i logjikës dhe gramatikës, por edhe i vetvetes; të gjitha leximet e frymëzuara nga retorika të de Man-it përfundojnë në një pikë të tillë zero. Është e lehtë të kuptohet se një strategji kaq kokëforte negative i acaron shumë njerëz që e marrin letërsinë pozitivisht. Duket se de Man-i është i vetmuar në negativitetin e tij të rreptë. Derrida, për shembull, gjithmonë këmbëngul në dekonstruksionin si një aktivitet pozitiv. Por edhe de Man-i ka qenë burim frymëzimi për të tjerët: në veçanti në SHBA, mund të dallohet një lloj shkolle dekonstruktive. J. Hillis Miller-i ka zhvilluar leximin retorik si një metodologji letrare në një numër veprash, dhe kjo punë vazhdon, për shembull, me Barbara Johnson, Cynthia Chase, Neil Hertz, Werner Hamacher, Andrzej Warminski, Kevin Newmark. Dekonstruksioni mbase mund të konsiderohet një version i

poststrukturalizmit i frymëzuar nga fenomenologjia dhe kritika gjuhësore. Megjithatë, si një zgjatim i strukturalizmit, ekziston një gamë e tërë versionesh në praktikën letrare pa asnjë uniformitet teorik. Në Francë, kritika feministe me emra si Silvine Agacinsky, Hélène Cix-ous, Luce Irigaray, Sarah Kofman, Julia Kristeva, ka provuar rrugë të ndryshme larg strukturalizmit. Filozofë të rëndësishëm me lidhje letrare që mund të quhen post-strukturalistë janë, për shembull, Gilles Deleuze dhe Felix Guattari, Philippe Lacoue-Labarthe dhe Jean-Luc Nancy. Filozofi dhe shkrimtari francez, i cili më shumë se kushdo tjetër përshkroi rrugën drejt strukturalizmit dhe më pas daljen prej tij ishte, megjithatë, Roland Barthes-i. Hapat e parë i hodhi me S/Z, ku ai shqyrton me kujdes një tregim të shkurtër të Balzakut. Analiza tani synonte jo vetëm zbërthimin e “kodeve” të historisë, por edhe leximin e retorikës deri në detajet më të vogla. Rezultati ishte që leximi u bë instanca vendimtare e tekstit; dhe Barthes-i në të njëjtën kohë i bëri homazh leximit «të rrëmbyeshëm” në broshurën Le plaisir du texte. Disa autorë të veçantë në kufijtë e strukturalizmit dhe dekonstruksionit kanë qenë të preokupuar me leximin krijues. Kjo vlen për francezin Maurice Blanchot, një kritik letrar shumë i rëndësishëm për zhvillimin e dekonstruksionit. Kjo vlen edhe për amerikanin Harold Bloom, i cili në një seri analizash mbi poezinë pohoi rëndësinë e leximit “të fortë” për të gjithë formimin letrar. Libri më i rëndësishëm i Paul de Man-it u quajt “Allegories of Reading” dhe në një artikull të mëvonshëm, “The return to Philology”, ai pohonte se “leximi i thjeshtë” ishte strategjia më e rëndësishme e dekonstruksionit. Shembujt sugjerojnë se post-strukturalizmi dhe dekonstruksioni gjithsesi janë kontribute më të fundit në studimet letrare, por megjithatë janë të lidhura ngushtë me traditat e mëdha të leximit me rrënjët në hermeneutikë dhe filologji.

(Nga suedishtja: Qerim RAQI )

*Luixhi Pirandelo: “Gjashtë personazhe kërkojnë një autor”*

# DRAMA QË TRONDITI TEATRIN MODERN

**Pirandelo, me këtë dramë novatore, ndërthur në mënyrë tronditëse jetën me artin, realitetin me iluzionin, njeriun me personazhin, duke rrëzuar “murin e katërt” dhe duke e bërë vetë teatrin objekt të teatrit**



## Leonard VEIZI

Vepra e nobelistit italian Luixhi Pirandelo, “Gjashtë personazhe kërkojnë një autor”( “Sei personaggi in cerca d’autore”), është një nga dramat më rrënjësore të shekullit XX, që ndryshoi përgjithmonë mënyrën si e shohim teatrin. Premierë më 9 mars 1921 në Teatro Valle në Romë, ajo u prit fillimisht me habi dhe kundërshti, por shumë shpejt u kuptua se Pirandello kishte sjellë një revolucion estetik dhe filozofik në artin skenik.

### Një teatër i ri: iluzioni, kriza dhe identiteti

Pirandelo, me këtë dramë novatore, ndërthur në mënyrë tronditëse jetën me artin, realitetin me iluzionin, njeriun me personazhin, duke rrëzuar “murin e katërt” dhe duke e bërë vetë teatrin objekt të teatrit. Gjashtë personazhe të “papërfunduar” futen në një teatër ku po bëhen prova dhe kërkojnë që një autor t’ua japë zërin, kuptimin dhe përmbylljen. Ata kanë histori, vuajtje dhe plagë, por janë pa autor. Kërkimi i tyre shndërrohet në një metaforë të njeriut modern që endet pas një kuptimi

të plotë të ekzistencës.

### 5 shtyllat filozofike të veprës

Personazhi është më real se njeriu i vërtetë – Një personazh i shkruar është i pandryshueshëm, i përhershëm, më i qëndrueshëm se vetë njeriu.  
-Kriza e autorit – Vepra trajton krizën e krijimit: kur nuk ka më një autor, identiteti mbetet i copëtuar dhe pa drejtim.  
-Teatri si iluzion dhe e vërtetë – Ndërpritet ndarja mes spektatorit dhe aktorit; vetë procesi i krijimit bëhet ngjarje.  
-Kërkimi për identitet – Personazhet kërkojnë një kuptim, një përmbyllje, si njerëzit në botën moderne që nuk gjejnë dot vendin e tyre.  
-Jeta si skenë – Pirandello e sheh jetën si një teatër ku secili luan një rol, por nuk di kush ia ka shkruar atë rol.

### Pirandelo, një jetë mes dhimbjes dhe gjenialitetit

Luigi Pirandello u lind në Agrigento të Sicilisë më 28 qershor 1867 dhe u bë një nga figurat më të rëndësishme të letërsisë moderne europiane. Ai studioi filologji në Romë dhe në Bon të

Gjermanisë, por jeta e tij u ndriçua nga dramat e shpirtit dhe mendjes. Gruaja e tij vuante nga sëmundje mendore, një përvojë që e thelloi trajtimin e çmendurisë, vetmisë dhe identitetit të rrënuar në veprat e tij. Ai fitoi Çmimin Nobel për Letërsi në vitin 1934, për “mjeshtërinë e tij në rifreskimin dhe transformimin e artit të dramës”. Trashëgimia e tij përfshin rreth 50 drama, mbi 250 novela dhe 7 romane, që ndikuan thellësisht autorë si Beckett, Sartre, Ionesco. U nda nga jeta më 10 dhjetor të vitit 1936.

Në Shqipëri: një vepër që frymëzon skenën

“Gjashtë personazhe kërkojnë një autor” është vënë në skenë disa herë në Shqipëri, por një nga vëniet më të njohura dhe më të suksesshme ishte ajo e realizuar nga Teatri Kombëtar në Tiranë, nën regjinë e Mehmet Xhelilit. Në këtë produksion u angazhuan aktorë të mirënjohur si: Fatos Sela, Marjeta Ljarja, Dritan Boriçi, Olta Daku dhe Eftiola Laçka, të cilët dhanë jetë një shfaqjeje që nuk ishte vetëm artistike, por edhe filozofike. Produksioni shqiptar ka përqafuar

strukturën e pazakontë të veprës, ku aktorët bëhen personazhe dhe personazhet kërkojnë të jenë më shumë se rol. Në realitetin shqiptar, ku individi shpesh jeton në tensionin mes detyrës dhe dëshirës, mes maskës dhe të vërtetës, kjo dramë ka marrë një kuptim të thellë social dhe shpirtëror.

### Nga Roma në Tiranë, përmes përkthimit

Falë përkthimit mjeshtëror të Donika Omarit, vepra e Pirandelos ka arritur të komunikohet me saktësi, thellësi dhe elegancë në gjuhën shqipe. Përkthimi i saj nuk është thjesht gjuhësor, por edhe filozofik, duke ruajtur misterin, kontradiktën dhe tensionin që e bën këtë vepër të pavdekshme.

### Epilog

Në fund, Pirandelo nuk na jep përgjigje, por na lë me një pyetje thelbësore: A është jeta jonë vërtet e jona, apo jemi edhe ne si ata gjashtë personazhe që kërkojnë një autor për të na dhënë kuptim?

Në këtë pikë teatri ndalet, reflektimi nis.

Profile: Woody Guthrie

# BARDI PËRPARIMTAR

**Një humanist i përjetshëm që i bashkohet aradhës së artistëve të mëdhenj amerikanë progresistë–realistë kundër oficialitetit dhe skemave të rreme proto–fashiste që, de facto, janë shfrytëzim e dehumanizim**



**Bujar MEHOLLI**

Vite më parë pata botuar një artikull për atin e folkut amerikan, Woody Guthrie. Mbase jam ndër të rrallët që kam shkruar, në shqip, diçka për të. Guthrie, si pionier i folkut modern amerikan, e popullarizoi dhe revolucionarizoi zhanrin - veçanërisht me incizimin legjendar “This Land Is Your Land” (himni alternativ amerikan) si reaksion ndaj kic këngës “God Bless America” - me shfaqjet e shumta nëpër radiostacione të Los Angeles-it e New York-ut. Artist i angazhuar politikisht, kritik përmes këngës, lirikat i këndoi nëpër takime sindikatash, mitingje politike e mbremje të ndryshme, folkun e shndërroi në fenomen urban që pati më vonë ndikim të ndjeshëm te artistë të tjerë, qoftë për mënyrën e kompozimit, qoftë për idetë progresiste-demokratike të teksteve (shkroi afër 1000 sish), në linjë me shkrimtarë të mëdhenj të kohës si Dreiser, Lewis a Steinbeck, ky i fundit njëherit dhe mik i Woody Guthrie-t. Vizionet e tij sociokulturore sikur identifikohen nga njëra anë me njëfarë konservatorizmi soji që e do bujqësinë të pavarur dhe përkrah institucionin e familjes tradicionale si themel shoqëror, nga ana tjetër me rebelizmin, radikalizmin, që e vë në përkrahje të sindikatave të politizuara, makinën e tij më të fortë, kitarën, e shndërron në mjet për projeksionin e madh, universal, anti-fashist, u këndon grave, mbështet të drejtat e njeriut, barazinë, drejtësinë sociale, internacionalizmin - dinjitar për t’u quajtur artist i popullit që këndon:

Unë jam një refugjat me tas në duar përherë nga pluhuri mbuluar, duke kërkuar për fruta edhe shumë s’kam për të qëndruar. Kaloj male dhe dete tok me gruan dhe fëmijët, seç është një autostradë e vjetër që të djeg e përvëlön, gjersa mbi të kalon... Vështirë, oh, prorre ka qenë vështirë këtu. Kjo është e sotmja jonë, ja, kështu jemi katranosur poshtë këtij mali, përbri asaj shkretëtire, jemi thjeshtë refugjatë të mbuluar nga pluhuri. Ne jemi bredhacakë, kështu na thonë. Sot jemi këtu, pastaj marrim udhë, udhëtojmë tok me stinët si refugjatë pluhuri që jemi. Nga toka e Jugut krejt e thatë tok me gruan dhe fëmijët marrë udhë, kjo botë e vjetër, ah, sa e vështirë për një refugjat nga pluhuri mbuluar... Po, ne bredhim e bredhim pa pushim, rruga është shtëpia, është streha jonë, kjo rrugë mbushur me gjemba dhe pa fund, e pa fund për një refugjat të pluhurosur... Bredhim dhe punojmë çfarë na del përpara, punojmë frutat në këtë vorbull shkretëtire, kjo është tamam punë për një refugjat pluhuri. Unë jam refugjat, tasi im me pluhur është mbushur, ngandonjëherë ndalem dhe vras mendjen, vallë a do të jem gjithmonë një refugjat pluhuri me tas në duar? (@bm)

Zëri i tij shtrihet përgjatë një itinerari të gjerë rural e urban; mbuluar sikur me njëfarë tisi të Moisiut, delikat, i zhgënjyer, i vendosur e protestues, artikulimi i ideve përmes zërit të shtruar, sinjifikativ, mbron punëtorin që ka humbur gjithçka nga Depresioni i Madh, endacakun, të pashpresin... është shok me të, ia njuh hallet, ia përjetëson në muzikë, deklamon se toka është e të gjithëve, i përket secilit e secilës duke iu kundërvënë ideve ksenofobe-fashiste të hierarkisë së bardhë, tipave alla Babbitt që projektojnë botë me pabarazi, padrejtësi, racizëm e konformitet snobist — Woody Guthrie, patriot i vërtetë amerikan, mbështet shtetin liberal-demokratik që mbron të drejtat e punëtorit; imagjinata e tij projekton njëfarë bote utopike- idilet fshatare me pronarët e tokave që kanë bereqet, lopët, pulat, banesat sociale, vallet, lojë, nënat që kujdesen për fëmijët pa ndier mungesën e asgjëje, një komunitet rural-urban të cilit jeta i shkon vaj... edhe urbanizmin e sheh të harmonizuar duke ofruar mbështetje për sindikalizmin pa e luftuar apriori kapitalizmin, por duke rindërtuar klasat dhe përmirësuar marrdhëniet midis punëdhënsit dhe të punësuarit përmes solidaritetit dhe qeverisë funksionale; vizionet e tij janë humanizëm i pastër, megjithëse artist, kantautor, me prirje të majta dhe shkrues i artikujve në gazetën komuniste amerikane “People’s World”, Woody Guthrie, nuk afrohej me ideologjinë komuniste, veçan jo me atë staliniste despote - Woody Guthrie është kantautor mjaft pragmatik, e

do zhvillimin, barazinë e shëndoshë, kapitalizmin e moderuar, që mbështetet në meritokraci, bashkimin e punëtorëve të etnive të ndryshme në skemat e mirëqenies dhe prosperitetit, strehimin, ushqimin, arsimin... Një humanist i përjetshëm që i bashkohet aradhës së artistëve të mëdhenj amerikanë progresistë–realistë kundër oficialitetit dhe skemave të rreme proto-fashiste që, de facto, janë shfrytëzim e dehumanizëm... të përshkruara mjeshtërisht në letërsi nga Sinclair Lewis. Woody Guthrie, në njërën nga lirikat e albumit “Ballads of Sacco & Vanzetti”, shkruan:

Nëse ke veshur rroba të leckosura je endacak, nëse je veshur me bluzë sateni të thonë hajdut, nëse paratë i kursen të quajnë koprrac nopran, ama nëse shpenzon pa frë mund të ndihesh i lehtësuar. Nëse punon shumë të thonë se je i përlur, nëse je shpirt i lirë, afërmendsh, s’të shohin me sy të mirë; nëse je i shëndoshë të quajnë grykës, nëse rri i dobët të marrin për mospërfillës, nëse je i hareshëm të marrin për idiot ama po të dëgjuan duke qarë, kërkojnë të ndalesh menjëherë. Nëse je i varfër s’do ta shkelë njeri derën e nëse pasurohesh zor gjen një mik për të qenë, nëse martohesh do ta shkatërrosh lumturinë tënde por nëse ngelesh beqar do të ecësh buzë varrit.

NUMRI I ARDHSHËM MË 30 SHTATOR

# HEJZA

15 Shtator, 2025

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Faqosjen dhe dizajnin:  
**Drian Shala**

Rruga e Kaçanikut nr.208, Shkup, 1000